


NASHO
JORGAQI



SHOKU

NASHO V. JORGAQI

SHOKU

(Tregime, skica, përshkrime)

1244
BIBLIOTEKA E SHTETIT
TIRANE

~~46132~~

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

SHOKU

Ai erdhi në repartin tonë pothuajse drejt nga bankat e shkollës. Kishte mbetur në vitin e dytë të fakultetit të inxhinierisë, kishte hyrë në punë gjeometër dhe pastaj e kishin thirrur nën armë. Bashkë me disa ushtarë të rinj, atë e caktuan në kompaninë time. Unë e vura re që ditën e parë kur erdhi. Binte në sy, sepse ishte i gjatë, pak i kërrusur, me një vështrim të menduar dhe i ngathët në lëvizje. E quanin Perlat, po e thërrisnin «studenti». Rrobet i rrinin pak të ngushta, këpucët gati i tërhiqte, ndërsa bustina, sa nuk i binte nga maja e kokës. Qëndronte si mënjanë dhe bënte ç'bënte ose ulej e pushonte në ndonjë vend, ose shkopsitej sa herë që largoheshin eprorët. Kush e e di se si i dukej atij, ato ditë, jeta ushtarake!

Reparti ynë ishte vendosur në mes malesh, në një vend pothuaj të shkretë, tërë gurë e shkëmbenj, ku herë pas here dëgjohej era që gjëmonte grykave dhe krisma e minave. Kjo gjë, ditët e para, sikur e trishtonte pak ushtarin e ri. Të gjithë ushtarët qeshnin e dëfrenin me shakatë e Osmanit, kuzhinierit, kurse ai qëndronte i heshtur, me buzët

gjysëm të hapura. Shokët këndonin e losnin me top, ndërsa ai lexonte gazetën. Unë e kuptoja gjendjen e tij: çdo gjë do të bënte të sajën. Ai nuk do të ndryshonte menjëherë. E dija që do të mër-zitej pak në fillim, ndofta edhe do të ankohej, po prapë përvoja më kishte mësuar se edhe këta ushtarë, që duken kështu javët e para, një ditë vihen në rrugë si tërë të tjerët. Ai nuk e kishte kollaj që të shkëputej nga jeta që kishte lënë pas, nga familja, nga ndonjë kujtim. Ai ishte tamam si ajo fëmija që largohet për herë të parë nga prindërit dhe të gjithë njerëzit i duken të huaj. Unë nuk desha ta afroja menjëherë. Ai duhej të mësonte vetë, të luftonte disa ditë me veten, pa ardhur akoma në dorën time. Kjo është një fazë përgatitore për ushtarin e ri, që bën pjesë në programin e stërvitjeve, megjithëse aty nuk është e shënuar. Prandaj unë e lashë disa ditë të qetë, në punë të tij, si të thuash, dhe e thirra vetëm pas ndonjë jave në zyrën time. Me sa më kujtohet, ato ditë kishte ndodhur edhe diçka në mes të tij dhe Rakipit, kujdestarit të kompanisë. Rakipi erdhi dhe m'u ankua për këtë dhe më tha se ai studenti, kur e kishte urdhëruar të ndërronte krevatin dhe të flinte ai poshtë dhe Zef Lleshi lart, nuk kishte pranuar. Fill pas kësaj që ndodhi unë i çova fjalë Perlatit të paraqitej në shtab.

Atë pasdreke vjeshte binte pak shi. Unë rrija në zyrën e shtabit të repartit dhe shikoja sheshin që po ndryshonte ngjyrën nga shiu që ja kishte marrë shtruar. Ushtarët ishin futur brenda, nëpër dhomat e kulturës dhe tek-tuk dukej ndonjë, duke vrapsuar. Në shesh gjëmonte muzika, që era asaj

dite e shpërndante valë-valë. Nga larg, vura re një ushtar që doli nga biblioteka e repartit dhe mori për te sheshi. Ai nuk vraponte, po ecte me hap të shpejtë. Kur arriti nga mezi i sheshit, e kuptova se ai ishte Perlati... U tërhoqa nga xhami dhe u futa më brenda që të mos më shikonte. Posa u largova, u afrova prapë, sepse më tërhoqi vëmendjen një gjest i tij: ushtar Perlati ecte dhe nderonte me dorë, sikur t'i kalonte pranë ndonjë oficer. Vura buzën në gaz. Gjëja e parë që mendova ishte kjo: ai duhet të jetë njeri i mirë. Në këto mendime, dëgjova të trokasë dera. Nuk prita ta hapë ai, po u avita dhe e hapa vetë. U gjendëm përballë njëri-tjetrit, gati fytyrë për fytyrë. Ndjeva se ai ishte i turbulluar, sepse diç ndodhi atë çast. Ai, siç duket, po matej të më paraqitej dhe unë e hapa derën papritur.

Ai u ul, po harroi të heqë bustinën. Unë bëra sikur nuk e vura re, nxora paqetën dhe ja zgjata. Fytyra e ushtarit u çel, sytë i shndritën nga një gaz i përmbajtur. Mori një cigare, nxori nga xhepi shkrepshen e tij dhe ma ndezi mua. Unë thitha cigaren dhe zura ta shikoj, duke buzëqeshur.

— E di, i them, pse ju kam thirrur, ushtar Perlati...

Unë nuk arrita ta mbaroj mendimin, se ai më ndërpreu:

— Desha vetë njëherë të vija, shoku komandant... Kujdestari i kompanisë na i ndërroi pesë herë atë ditë krevatet. Njerëz jemi, vij nga jeta civile... dhe të them të drejtën e humba durimin, e kundërshtova. Gabim. Ai e bëri më pas çështje...

Unë e lashë të flasë deri në fund, dhe pastaj vazhdova, duke e parë në sy:

— Nuk ju kam thirrur për këtë. Sigurisht, ju nuk bëtë mirë që i kundërshtuat kujdestarit të kompanisë. Unë dhe juve ju kuptoj, po dalngadalë do të mësoheni. Të bindurit është një cilësi e domosdoshme në ushtri. Po që se ju, ashtu si shumë të tjerë, nuk e keni të formuar akoma, do ta fitoni patjetër këtu, në procesin edukimit dhe të stërvitjes. Për këtë ju siguroj unë, ashtu siç ju siguroj se asnjë nuk do t'ju fyejë...

Perlati nuk m'i ndante sytë, ndërsa vetullat i qenë ulur dhe fytyra i kishte marrë një pamje serioze. Kur unë mbarova, ai nuk priti të mendohet, po më tha me një zë të qartë:

— Edhe unë, ju siguroj, shoku komandant, se ajo që ndodhi nuk do të përsëritet më.

Pastaj me qëllim, unë heshta një kohë, për t'u hedhur pastaj tek biseda, për të cilën e kisha thirrur. I thashë:

— Këto ditë studjova dokumentat tuaja. Ju keni bërë me sa kuptoj, dy vjet për inxhinieri ndërtime.

— Po, për fat të keq — tha ai vrejtur, me gjysmë zëri.

— Pse, për fat të keq? —

— Sepse po të kisha studjuar si duhet, do të kisha mbaruar dhe do të shërbeja diku si gjithë shoqëti...

— Po këtu, nuk keni mundësi të shërbeni?

— Jo, — u përgjigj ai, — unë jam njeri i dështuar. Po të kisha vlejtur, do t'i kisha mbaruar studimet...

Ai djalë kishte humbur besimin tek vetja dhe detyra ime, si komandant i tij, ishte që t'ja ktheja. U ngrita në këmbë dhe me lëvizjet e mia e zërin e lartë u mundova të gjallëroj atmosferën përçark. I thashë:

— Këtu gaboheni. Njeriu nuk duhet të humbasë besimin. Sot dështuat, nesër do të fitoni. Çështja është të keni një qëllim serioz në jetë. Atdheut mund t'i shërbeni kudo që të gjendeni, bile dhe ashtu siç jeni sot, ju do të jepni kontributin tuaj. Për këtë, bile ju kam thirrur.

Nxori paqetën e mori një cigare. Vura re që buza e poshtme i dridhej, siç i dridhej edhe cigarja në mes të dy gishtërinjve. Unë u ula përsëri kundruall tij dhe zura të bisedoj. Ai më dëgjonte kokulur. Kur mora të flas për detyrën që do t'i ngarkoja, ai ngriti kokën dhe s'e kishte për gjë të më shikonte në sy.

— Repartit tonë, — vazhdova unë — i kanë ngarkuar një detyrë të rëndësishme. Ju e kini dëgjuar gjëmimin e minave, ato bien ja, atje përtej, tek mali i Drizës. Ushtria po hap në bark të malit një tunel nga do të kalojë një rrugë. Punimet vazhdojnë me vrull nga të dy anët. Së shpejti, të dy tunelet do të bashkohen. Këto ditë do të fillojë nga puna dhe reparti ynë. Komanda kërkon ndihmën tuaj, me aq sa të dini, sigurisht. Nesër do të takohemi me inxhinier Aliun dhe ai do t'ju udhëzojë. Kjo është detyra që ju ngarkoj.

Mbaj mend që ai më falënderoi me gjysëm zëri dhe u largua. Të pasnesërmen reparti ynë filloi nga puna. Perlati ishte tashti tekniku ynë. Ai udhëzonte në punë ushtarët, merrej me matje, zgjidhte

gështje teknike. Punën e kishte të tillë që rrinte edhe jashtë, edhe në tunel. Natyrisht, kishte ndonjë që e shihte me sy të keq këtë gjë. Po mua s'më vinte mirë, se kështu mendonte edhe kujdestari i kompanisë, Rakipi. Ai vinte e më thoshte: «Shoku komandant, ushtar Perlati duhet të marrë kazmën e qysqinë, si gjithë të tjerët». Unë e vështroja dhe s'i përgjigjesha. Një herë i thashë: «Rakip, e di ç'bëjmë, merri ti ato skicat e Perlatit dhe Perlati të vijë në tunel». Ai më tha me gjysëm zëri: «Nuk e kam fjalën aty, shoku komandant, po se si më vjen ashtu, Zef Lleshi punon në ujë deri në brez, dhe ai studenti rri në diell. Fjalët e fundit të Rakipit më bënë përshtypje dhe, sepse, më ngelën në mendje. Vertet, ai i trembej punës? Unë nuk kisha asnjë fakt. Përkundrazi, ai e kryente mirë detyrën që i kisha ngarkuar. Vija re se kishte filluar ta rifitonte besimin që kishte humbur. Ishte i rregullt e punëtor, po a mjaftonte kjo? Në repartin tonë njerëzit mateshin me punën që bënin brenda në tunel, atje thellë ku lëftohej me shkëmbin, me ujët dhe errësirën. Nisa të ndryshoj mendim. E thirra ushtar Perlatin dhe e këshillova që të rrinte sa më tepër në tunel. Të punonte edhe ai me kazmë dhe qysqi. Dhe ai zuri të punojë, dhe nuk punonte keq. Po qëllonte shpesh që e thërrisnin jashtë. Rakipit prapë nuk i vinte mirë. Kur bëmë njëherë pushim, atij s'iu ndejt pa më thënë: «Sikur e do një çikë veten më shumë se ne ai studenti, shoku komandant!» Unë i thashë: «Ti nuk mendon mirë, Rakip: Ki më tepër besim tek njerëzit». Ai nuk më kundërshtoi, po isha i sigurtë se nuk kishte ndërruar mendim. U desh të ndodhte diçka. Diçka që na tronditi të gji-

thëve dhe që vetë Rakipi, për pak, u gjend buzë varrit.

Kjo ndodhi, kur tuneli ishte në përfundim e sipër. Mali i Drizës ishte çarë në të dy anët dhe po punohej për të bashkuar tunelet. Ne punonim në këtë anë dhe dëgjonim zhurmën e repartit fqinj në anën tjetër. Kujtonim se ishim shumë afër dhe se pak punë na kishte mbetur. Po s'ishte ashtu. Llogaritë, që kishte bërë inxhinieri dhe Perlati, tregonin se ngelej goxha punë për t'u bërë. Ushtarët nuk e pritën mirë këtë gjë. Ata donin ta hapnin tunelin tej e tej para afatit dhe kërkuan që të përdroreshin mina në thellësi të madhe. I pari e hodhi këtë ide Rakipi. Kjo ishte dëshira e të gjithë ushtarëve, që tok me oficerët e tyre kishin punuar, bile, do të thosha, kishin luftuar me heroizëm për muaj të tërë. Ne nuk pritëm më dhe minatorët vajtën e vendosën minat. Më kujtohet si tashti se të gjithë ishin të gëzuar se më në fund do të lidhej tuneli, po edhe pak të druajtur, se kjo ishte prova e parë që bënim dhe s'dinim si do të na dilte. I vendosëm minat rrëzë shkëmbit të fundit; ca mina të fuqishme dhe u tërhoqëm për të dalë jashtë. Shokët na prisnin me padurim. Minatorët ndezën fitilat, ndërsa ne të tjerët rrinim e prisnim në ankth. Nuk kaloi shumë dhe nga tuneli erdhi një gjëmim i mbytur dhe toka na u tund nën këmbë. Disa nga ushtarët deshën të vraponin në drejtim të hyrjes së tunelit, po unë nuk i lashë. U thirra dhe iu kanosa me gjithë mend. Nga rregullorja e punimeve xhenjere, dija se gazet e minave ishin shumë të dëmshme, prandaj urdhërova të mos hynin, pa u pastruar mirë tuneli prej tyre. Ndejtëm kështu një kohë të gja-

të në pritje, dhe pastaj Rakipi kërkoi të futet brenda. Unë në fillim ngurrova, po pas pak e lashë të shkonte. Ai mori dy ushtarë, Skënder Lenën dhe Agim Çelikun, dhe të tre hynë brenda në tunel. Dëgjuam hapat e tyre që kërcitën nëpër gurë dhe pastaj përçark zotëroi heshtja. Nuk di sa kohë qëndruam ashtu, veç kur dëgjoj zërin e Perlatit: «Shoku komandant, më lejoni të shkoj të shoh gjendjen». Unë kisha filluar të shqetësohesha. Nuk më pëlqente vonesa e tyre, prandaj kur më foli Perlati nuk e kundërshtova. Ai u nis dhe humbi si shokët në grykën e tunelit: Heshtja u bë më e rëndë tashti. Koha ecte shumë ngadalë. Asnjëherë nuk më janë rëndur sekondat sa atë ditë. Thashë se ngriva në vend, kur dëgjova një krisëm revoleje që erdhi mbytura-zi nga tuneli. Ashtu siç isha, u turra drejt grykës, por sa bëra disa hapa nëpër tunel, shoh një hije të zezë që vjen duke u lëkundur në drejtim të dritës. Mbjaj mend që më mbyti era e gazit dhe thashë se m'u muar fryma. Dëgjova zërin e mekur të Perlatit: «Kthehuni, shoku komandant, kthehuni!...» Unë u ktheva menjëherë dhe sapo dola në dritë pashe mirë Perlatin me Rakipin në krahë.

Atëhere s'e mbajta dot veten dhe u turra prapë nga errësira. Vrapova gjysëm i krrusur nëpër koridorin e errët, duke marrë frymë me zor. Kur arrita në një farë vendi, dëgjoj një rënkim të lehtë. Mbjaj vesh mirë dhe ndjej se është një nga ushtarët e mi. Duke kërkuar me sy të shqyer, gjeta Skënderin e rrëzuar për tokë dhe u përpoqa ta marr në krah. Kjo gjë më mundoi shumë, po megjithatë fillova të çapitem me këmbë të hapura. Si bëra disa hapa, u lëkunda sa andej këndeje dhe që-

ndrova në vend. Ndejta kështu një grimë, pastaj bëra përpara me zor. Më dukej sikur dikush më kishte zënë për gryke e më shtërngonte pa mëshirë. Kështu, shkova gjer në mes të rrugës. Atje m'u rëndua aq shumë vetja dhe ai që mbaja mbi supe, sa thashë se u shemb diçka që lart dhe më shtypi nën vete.

Mbaj mend vetem kur u përmenda në krevat dhe atëherë kuptova se gjendesha në spital. Hodha sytë më të majtë dhe pashë Rakipin shtrirë në krevatin fqinjë, fytyrëzbehtë, me bombolen e oksigjenit pranë. Kështu si ai ishin pak më tutje dhe Skënderi me Agimin Më të djathtë të krevatit tim njohta Perlatin, që rrinte syhapur, me duart prapa kokës.

Atë ditë në mbrëmje erdhën shokët e repartit dhe më treguan se ç'kishte ngjarë. Fatkeqësia kishte ndodhur nga gaz metani që kishte shpërthyer papritmas. Ushtarët, sa kishin marrë vesh fatkeqësinë, ishin sulur në grykën e tunelit për të shpëtuar jetën e shokëve. Ata ishin të ndërgjegjshëm, se duke shpëtuar shokun vinin në rrezik jetën e tyre, po prapë s'deshën t'ja dinin. Miqësia ushtarake në këtë betejë të heshtur ishte shfaqur me një bukuri të rrallë.

Ne, që u shtruam në spital, megjithëse vuajtëm, një ditë dolëm të shëruar. Kur u kthyem në repart, sikur kishim lindur dhe një herë. Nuk do t'u them se si na pritën shokët, sa të afërt e të lidhur ngushtë ndjeheshim tani me njëri-tjetrin. Vetëm do të them se pas kësaj që ndodhi, Rakipi me Perlatin u bënë miq për jetë. Dhe kur u bë mbledhja që na falënderuan para gjithë Brigadës, Rakipi, që dukej aq i rëndë dhe i ashpër, u përlot e tha:

— Shokë, jetën time këtej e tutje ja kam borxh ushtar Perlatit.

Perlati e vështronte kujdestarin e kompanisë me miratim dhe buzëqeshte i mallëngjyer. Rakipi ndërkaq drulhej të më shikonte në sy. Kujtonte se mos unë i kisha treguar ndonjë gjë Perlatit nga ato fjalë që ai kishte thënë për të.

Po të gjitha këto nuk kishin rëndësi para asaj që në punë e sipër, në luftë me vështirësitë, Perlati fitoi rishtas besimin e humbur, ndërsa Rakipi bëri dhe një shok të mirë...

PEJSAZHI

Është e çuditshme se si lidhen ndonjëherë gjërat. Tek shikoja një ditë një pejsazh të një mikut tim piktor, pa dashur m'u kujtua një ngjarje që ndodhi kësaj pranvere në kantierin tonë.

Në vështrimin e parë, duket sikur nuk ka asnjë lidhje në mes zanatit tonë dhe punës së piktorit, e megjithatë kur vjen rasti për të gjykuar një vepër arti, dashur pa dashur, kërkon të gjesh në art atë që ke parë dhe provuar vetë në jetë. Kështu ndodhi edhe me mua, atë ditë kur rrija e sodisja pejsazhin e mikut tim. Shikoja atë vepër dhe sillja ndër mend ato pamje të natyrës sonë që më ka rastisur të shoh.

Pejsazhi i tij paraqiste një qafë mali që hapej në mes, sikur t'i kishte rënë dikush me shpatë dhe që andej të kishin shpërthyer lule plot ngjyra. Lulet ngjiteshin gjer lart, duke përhapur në dy krahët e tabllosë një dritë të ëmbël dhe qetësuese. Kjo ishte një bukuri delikate dhe e egër njëkohësisht, bukuria e natyrës shqiptare në një ditë të kthjellët prilli, që ne njerëzit e kantierëve e kemi parë sa e sa herë, po që dora e piktorit e kishte hedhur me mjeshtëri në pëllhurë dhe e kishte përmbyllur në një kornizë. Pejsazhi aty për aty

më pëlqeu; më tërhoqën e më bënë për vete tonet e hapura të ngjyrave, ajo atmosferë plot dritë. Po nuk kaloi shumë dhe përshtypja ime sikur filloi të zbehej. Ndjeva një pakënaqësi të lehtë. Në fillim ja vura fajin syrit tim të pastërvitur, shijes sime akoma të paformuar për të ndjerë plotësisht një vepër arti. Po me sa kuptova më vonë, s'ishte vetëm kjo arësyeja. Pakënaqësia tek unë vinte duke u rritur. Dhe kjo ndodhi, sidomos, kur nisa ta gjykoj veprën e mikut tim përmes përshtypjeve e kujtimeve që kisha nga jeta ime nëpër kantiere. Syri s'më gjente qetësi dhe ashtu, i shqetësuar, diç kërkonte dhe s'e gjente gjëkund. Pikërisht në këtë çast më erdhi ndër mend ngjarja që ndodhi kësaj pranvere tek ne.

Ne punonim prej disa vjetësh për ngritjen e një hidrocentrali. Në kohën kur ndodhi ngjarja, puna në hidrocentral ishte në mbarim e sipër dhe kantierit tonë i duhej të largohej prej aty. Prisnim me ditë urdhërin që të shkonim në një vepër tjetër të pesëvjeçarit, sado që nuk na vinte mirë, sepse dëshira e të gjithëve ishte që të qëndronim deri në fund e të merrnim pjesë në inaugurim. Po për çudinë tonë, ndërsa prisnim këtë urdhër, pa pritur na thanë të qëndrojmë gjer në fund. Më thirrën mua si përgjegjës kantieri në drejtori dhe më udhëzuan për detyrën e re: punëtorët e kantierit tonë duhej të hapnin një rrugë të shkurtër që do të kalonte përmes një qafe, që quhej Qafa e Vetëtimës. Rruga duhej të përfundonte sa më parë. Unë, me të marrë detyrën e re, u ktheva në kantier dhe u fola punëtorëve. Natyrisht, ata u gëzuan dhe mezi që prisnin të fillonin nga puna. Sipas planit që kisha bërë

me inxhinier Nikon, ditën e parë do të punonte një ekskavator dhe disa nga punëtorët. Më vonë, do të hidhnim forcat e tjera. Në mbledhje caktuam punëtorët, por kur erdhi puna tek ekskavatoristi nuk e patëm kollaj. Ekskavatoristët tanë janë të gjithë çapajeva dhe unë e Nikoja e kishim vështirë të bënim dallim. Deshi fati që kjo çështje u zgjidh menjëherë në mes tyre. U ngrit Ademi, ai ekskavatoristi zeshkan dhe propozoi xha Petron, Petro Kadenë. Petrua nuk ishte i vjetër, i kishte apo s'i kishte të pesëdhjetat, po në mes të punëtorëve të rinj, ai dukej i moshuar. Kur e shikoje nuk ta mbushte syrin: Një trup vogël, me ca duar të mëdha, me vetullat kaleshe, që i mbulonin sytë e vegjël e të thellë, me një palë mustaqe të shkurtëra, të thinjura pothuajse, si dhe flokët. Mbante veshur gjithnjë një palë kominoshe të arnuara në dy shpatullat dhe bërrylet. Thashë, nuk ta mbushte syrin në të parë, po punën e tij s'e bënte njeri në kantier. Ishte fjalëpak dhe punën e bënte të saktë e të shpejtë. Prandaj më erdhi mirë që e propozuan vetë shokët.

— Do ta marrësh përsipër, o xha Petro? — i them.

Ai ngre kokën dhe, me atë zërin e tij të trashë, më përgjegjet:

— E marr, shoku drejtor, si mos e marr. Fjalë është ajo!

Shokët e tij të rinj rrahin shuplakat. Xha Petros i qeshin sytë. Unë vështroj nga punëtorët dhe para se ta mbyll mbledhjen, jap porosinë e fundit:

— Ekskavatorin ta çoni atje, nesër që pa

gdhirë. Për këtë ngarkohet Lamja që të ndihmojë me skuadrën e tij.

Të nesërmen, pasi bëra mbledhjen e mëngjezit me këshillin teknik, mora inxhinier Nikon dhe të dy së bashku u nisëm për tek vendi, ku do të hapej rruga. Qafa binte pak si larg hidrocen-tralit. Duhej të kaloje nëpër fshat, pa të arrije atje. Ishte një vend, disi, i mënjanuar nga gjithë ajo lëvizje e madhe që kish nisur prej vjetësh atyre anëve. Fshatarët, nuk di sepse, e quanin Qafa e Vetëtimave. Vendi ishte shumë i bukur e, ngado që të hidhje sytë, të mbyste gjelbërimi. Pastaj për rreth kishte burime të freskëta. Mëngjezi i bukur i asaj dite pranvere të ftonte të sodisnje natyrën e ringjallur. Po, ne, njerëzit e kantiereve, që punojmë në gjë të saj e jemi mësuar si të thuash me agimet, me diellin dhe shiun, e kemi vështirë të përqëndrohemi gjithnjë e të sodisim bukuritë që mund t'i kapë menjëherë njeriu që punon në zyrë a në studjo. Shpesh herë ne na rri mendja tek puna që na pret. Kështu dhe unë, atë ditë. Mendjen e kisha tek puna që duhej të kishte filluar. Ndaj në vend që të sodisja horizontin e pastër e të këthjellët, që humbiste në pafundësi, më mbetën sytë nga Qafa. Shoh nga larg, atje përtej, ekskavatorin e xha Petros me kokën përpjetë si një lejlek që s'leviste nga vendi. Toka sa është kafshuar pak. Punëtorët janë shpërndarë në të dy krahët e ekskavatorit. Shquaj vetëm Llazon e gjatë, që ul e ngre trupin herë pas here. Diçka të tillë bëjnë dhe të tjerët. Maqina gjigande nuk dëgjohe fare. Unë e Nikua shohim njëri tjetrin në sy dhe ngrej-më supet. C'bëjnë këta kështu? Puna duhej të kishte filluar me kohë, kurse ata akoma rrinë e

diç presin. Ç'mund të kishte ngjarë? Po, edhe sikur t'i kishte ngjarë ndonjë avari, duhej të na kishin çuar fjalë.

E pyes inxhinierin i shqetësuar:

— Më bëjnë gjë sytë mua, apo punojnë ata atje?

— As unë s'po marr vesh gjë — ma kthen Nikua — Diçka kanë ata ashtu...

E lëmë fjalën me aq dhe nxitojmë çapin. Marrim me vrap të përpjetën që na kishte ngelur dhe dalim menjëherë përballë punëtorëve. Prapë unë nuk po kuptoj gjë se ç'bëhet. Të gjithë kanë ulur kokën dhe seç kërkojnë përdhe, në mes të barit. Mos u ka humbur ndonjë vegël, mendoj, dhe janë vënë të gjithë për ta kërkuar! Ekskavatori, shyqyr, është edhe alamet maqine, po ja, që dhe për një vidë të vogël të lënka në baltë! U afrohem punëtorëve të heshtur, pa ditur nga t'ja fillojmë. Disa prej tyre na shohin, drejtojnë trupin dhe vënë buzën në gaz. Unë ndjej nofullat e mia të shtrëngohen. Kështu na është bërë zakon, ne drejtuesëve; një gjë të mos shkojë mirë dhe shqetësohemi. Dëgjoj punëtorët që më përshëndesin dhe s'më jepet t'u përgjigjem. Po, kur shoh xha Petron që më afrohet dhe më jep dorën, atëhere s'e përmbaj dot veten dhe i them me zë të rreptë:

— Ç'është kjo që po bëni, o xha Petro? Pse nuk kini filluar akoma?

Ai më buzëqesh, ndërsa sytë sikur i ndizen menjëherë prapa vetullave kaleshe dhe më thotë:

— Po punojmë, shoku drejtor, nuk po rrimë.

Ja kthej unë, jo pa habi:

— Si mor po punoni, ekskavatori po fle...

Ndërkaq punëtorët mblidhen përçark nesh. Xha Petrua gjithnjë i qetë vazhdon:

— Punë është dhe kjo që bëjmë, shoku drejtor.

— Ç'punë është kjo? — ja pres unë — Ju sikur kini dalë për piknik.

Në mes nesh për një çast ndehet një heshtje e çuditshme. Mua pothuaj më janë mjegulluar sytë.

— Është gjynah, shoku drejtor — dëgjoj xha Petron të thotë.

— Çfarë gjynahu — ndërhyj unë, që mezi mbaj zemërimin. — Edhe tokë vakëf të ishte kjo, s'kishit pse të trembeshit!

— Po vakëf është e shkuar vakëfit, shoku drejtor! Gjynah t'i prishësh me hekur.

— Cilat t'i prishësh, more xha Petro?

— Po ja këto, shoku drejtor, lulet. Nuk i shikoni!

Unë përpiqem të mbledh veten dhe sikur të përmendësha nga një dremitje e lehtë; rrudh sytë dhe shoh me vëmendje përreth. Gjithë vendi përçark është mbushur me manushaqe. Kaq vë re unë dhe mjafton kjo që ta ndjej veten ngushtë. Mbeta për një çast i nemitur.

— Xha Petrua vazhdon të arësyetojë:

— Thashë, të mos vejë dëm gjithë kjo bukuri, shoku drejtor. Manushaqja është lule e bukur, paçka se është më e druajtura nga të gjitha shoqet. S'na bëri zemra t'i biem me hekur. Thashë t'i mbledhim një herë, po pastaj në dorë e kemi. Punojmë sot një çikë më shumë se s'bëhet qameti...

Ai hesht, unë ngre sytë dhe shoh në duart e tij një tufë manushaqe të freskëta. Pastaj vë re

manushaqe nëpër duart e punëtorëve, vënë nëpër xhaketat e tyre, pranë veglave të punës, në penxheren e ekskavatorit... Kudo manushaqe më zë syri. Shoh ato dhe fytyrat e qeshura të punëtorëve dhe më duket vetja për një çast si i huaj në mes tyre. Nuk di ç'të them aty për aty. Ndjej të më dehë era e manushaqes. Një punëtor më zgjat një tufë me lule. E marr dhe s'flas. Më vjen turp nga vetja për atë që ndodhi. Megjithatë, xha Petrua përpiqet të më qetësojë. Ai akoma pandeh se unë me heshtjen time dua ta qortoj për manushaqet. Më thotë:

— Mos e prishni gjakun, shoku drejtor, ja, i mblodhëm këto këtu përpara dhe tashti do të fillojmë nga puna...

Unë për herë të parë, vë buzën në gaz dhe i them:

— Nuk ka gajle, xha Petro!

Po ai s'e dëgjon zërin tim. Në këtë kohë, Lamja ka ndezur motorin e ekskavatorit. Zhurma e maqinës mbyl të gjitha zërat. Xha Petrua drejtohet për nga ekskavatori. Punëtorët marrin veglat dhe secili fillon nga puna. Mbetem vetëm me Nikon.

— S'kam parë ndonjëherë kaq shumë manushaqe. Sikur t'i kishte mbjellë njeri me dorë. Dëgjon çfarë po të them apo jo?

Unë e kam gjithnjë mendjen tek ajo që ngjau. Nikua më vë krahun dhe të dy zëmë e ecim. I them:

— Kam dhjetë vjet që punoj nëpër kantiere, në mes të punëtorëve, natë e ditë, po kjo që ndodhi sot s'më ka ngjarë ndonjëherë. Të ma thoshte njeri, s'do t'ja besoja, po e pashë vetë dhe bindem.

Hapa një bisedë me inxhinierin që vazhdoi

pothuaj gjithë atë ditë. Ndejtëm në Qafë deri afër drekës. Në pushim bëmë një mbledhje të vogël, ku unë dhashë disa porosi lidhur me punën dhe në fund, e hodha fjalën tek manushaqet. Tërthorazi u kërkova punëtorëve falje për atë që ndodhi. Desha ta mbyll me aq. Po xha Petrua, sikur ta kishte kuptuar brengën time, u ngrit nga vendi dhe tha:

— Mos e thuaj atë fjalë. Ti ishe në të drejtën tënde, puna është punë. Po e kisha gjetkë hallin. T'i thoni Kolit, drejtorit tonë të përgjithshëm, që punëtorëve të kantierit të gjashtë ua do zemra ta pagëzojnë vetë këtë rrugë. Duam ta thërrasim «Rruga e Manushaqeve.»

Unë nuk u mendova shumë që t'i përgjigjesha. Për të larë, si të thuash, atë që bëra, i vesha vetes të drejta që s'më përkisnin dhe ua miratova propozimin aty për aty. Punëtorët u gëzuan pa masë dhe rrahën duart të kënaqur.

Tërë atë ditë dhe disa ditë më vonë, s'm'u largua nga mendja kjo. Kaluan disa kohë dhe kjo ngjarje m'u kujtua, siç u thashë në fillim, rastësisht, kur shikoja pejsazhin e mikut tim. Nuk di, sa pata të drejtë të isha i pakënaqur nga ajo që pashë. Po për një gjë jam i bindur: Po ta kishte parë miku im atë që ndodhi në Qafën e Vetëtimës, ku punonin punëtorët tanë, nuk do ta kishte lënë peisazhin e tij vetëm me qiell, tokë e lule. Me siguri do të vinte aty xha Petron, në mos atë, shokun e tij, e në mos ata vetë, pa tjetër punën e duarve të tyre. Atëhere syri im, që është mësuar gjithë këto vjet ta shohë peisazhin shqiptar gjithnjë në ndryshim, nuk do të shqetësohej, siç u shqetësua, po përkundrazi do të kënaqej.

KUSH ËSHTË?

Një vetëtimë tjetër gjarpëroi nëpër qiellin e errët dhe drita e saj verdhoshe zbuloi dhe një herë faqen e kodrës. Pastaj, gjëmuan malet me potere të madhe e sakaq toka u lëkund, sikur të kishte hyrë në luftë artileria e rëndë. Shiu që vazhdonte të binte litar e shtoi vrullin.

— Prit — thirri ai me zë të ulët dhe mbajti këmbët. — Ja, shtëpia!

Tjetri për pak u rrëzua, se aty vendi vinte tatëpjetë dhe ai desh të qëndronte njëherësh.

— Çou! — vazhdoi i pari që pandeju se shoku u rrëzua — Erdhëm, tani. Nuk të thashë se këndeje i dilet më shkurt...

Ai u çapit pa folur. Shoku e priti, i zgjati dorën dhe ashtu siç ishin, të ngarkuar, zunë përsëri të ecin. Pasi kaluan një vijë uji, rruga bënte përpjetë. Drita e vetëtimave ua tregonte tani she-shazi, shtëpinë, që ngrihej në faqe të kodrës.

Të përpjetën ata e muarën pothuaj të kapur për krahu. Këpucët e tyre të rënda mezi çanin baltën e madhe. Ujët rridhte tëposhtë si një përrua që zbret nga mali.

Kur dolën sipër në breg, të dy burrat ndaluan. Në dritën e vetëtimave ata panë fytyrat e çelura të njëri tjetrit.

— Erdhëm! — tha prapë i pari dhe mori të ecë më tutje. Shoku e ndoqi pas, gjersa u gjendën përpara një shtëpie, rrethuar me gardh. Aty shiu ja dha me të madhe. Burrat hoqën ngarkesat, që kishin në kurriz, dhe i lëshuan për tokë.

— Çfarë qameti! — foli ai që s'kishte hapur gojë. Tjetri nuk ja vuri veshin, se atë kohë po kërkonte në errësirë ballin e shtëpisë që nxinte në errësirë.

— Hajde — tha ai pas pak — se i kemi dalë nga prapa.

Ata i ranë rrotull shtëpisë dhe pasi kaluan portën prej lese, hynë në oborr. Një qen hunguroi diku në errësirë, po nuk guxoi të lehë. Nga dritarja një katror i madh drite binte në oborrin, mbushur me ujë që praronte shiun litar. Burrat, që deri atë çast kishin nxituar, tani sikur u stepën. Ata qëndronin në shi, të heshtur dhe vështronin dritën e shtëpisë.

— Ç'do të bëjmë, Xhemal? — foli gjithnjë ai i pari.

Xhemali ngriti supet:

— Ti e di, Feti, që na prure deri këtu.

— Pse, unë t'i bëj të gjitha? — u nxeh Feti.

— Hë, thirrë të dëgjojnë ata brenda!

— Thirri ti, më mirë. Nuk dëgjon si jam ngjirur.

Feti u prish në fytyrë, po shoku i tij nuk e vuri re, sadoqë e ndjeu këtë gjë. Të dy burrat rrinin të ngulur në një vend. Shiu u rridhte rrëke nëpër rroba. Era e lagur rrihte fytyrat e tyre të

mardhura. Veshët u shungullonin nga gjëmimet e shpeshta.

Brenda në shtëpi u dëgjuan zëra fëmijësh. Pas pak, u duk sikur diçka u rrëzua. Dikush qau. Burrat s'leviznin nga vendi.

— E, ç'do të bëjmë? — theu heshtjen Xhemali. — Të kthehemi më mirë te shokët.

Fetiu, në vend që të përgjigjej, bëri disa hapa përpara dhe thirri:

— O i zoti i shtëpisë!

Zhurma e potershme e bubullimës që erdhi befas e mbyti thirrjen e burrit.

— O i zoti i shtëpisë! — thirri sërish ai, duke vënë gojën në mes të shuplakave të duarve.

Në dritaren e vogël, sipër derës së shtëpisë, u ndez një dritë. Brenda u ndjenë zhurmë hapash, zëra të paqartë. Burrat u afruan. Pastaj një zë gruajë:

— Kush është?!

Të ardhurit u nemitën një çast. Në dritën e vetëtimës ata panë njëri tjetrin në sy. S'paska burra kjo shtëpi!

— Hape pak, moj motër! — thirri Fetiu dhe bëri përpara.

— Kush je ti? — u përsërit zëri i gruas, që në veshët e burrave tingëlloi pak kërcënues.

Xhemali i vajti pranë shokut e i tha me zë të ulët:

— Hajde ikim, Feti, se s'është punë kjo!

— Ti s'di ç'flet! — ja priti Fetiu, duke u kthyer nga ai. — Erdhëm deri këtu dhe të ikim. — Pastaj iu drejtua të zonjës së shtëpisë, duke e ndërruar tonin:

— Jemi dy jabanxhi që na ka zënë shiu udhës.

Një varg gjëmimesh u shkrehën njëri pas tjetrit. Pas kësaj, u ndeh heshtja dhe shushurinte vetëm zhurma e shiut. Nga shtëpia erdhi e qara e thekshme e një fëmije. Fetiu u mat të thërrasë prapë, po papritur çelësi kërciti në derë. Burrat s'levizën nga vendi. Dera u hap dhe drita ra në këmbët e tyre. Një grua e moshuar, me shami të zezë në kokë bëri ballë. Ajo vuri dorën strehë mbi sy dhe u mundua t'i shquajë të panjohurit. Në të majtë e në të djathtë të saj zgjateshin koka fëmijësh të qeshur. Burrat hodhën ngarkesat në kurriz dhe u afruan.

— Mirëmbërma, moj nënë! — thanë ata pothua me një gojë.

— Mirëmbërma! — u përgjigj gruaja, pak e ndrojtur, tek vuri re burrat e armatosur. Ata i zgjatën dorën dhe ajo ja nderi me radhë. Pastaj u largua nga dera, ndërsa fëmijët rendën brenda.

— Dëshëm të strehohemi, sa të pushojë një çikë ky shiu — tha Fetiu, tek hyri në hajatin e shtëpisë.

— Urdhëroni, posi! — thirri plaka, që u gjallërua menjëherë, kur i pa të ardhurit mirë në dritë. Ata ishin të veshur ushtarë. Ujët u rrëshqiste nëpër fytyrë. Nga rrobet binin nëpër tullat e kuqe të hajatit rrëkeza uji.

Hajati vinte i gjatë e i ngushtë, pa tavan. Si për dukeshin trarët e rinj, ku qenë varur vargje qepësh e specash të kuqe. Në fund hapeshin dy dyer, më të djathtë e më të majtë.

— Lërohuni, more djema — ja bëri plaka tek rrinte më këmbë në mes dy burrave — Hiqini palltot e hajdeni brenda. Sonte po rrjedhin qiejt. E ka kohën, vjeshtë!

Mysafirët e panjohur, sadoqë nga pamja duke-shin pothuaj njësoj, veshur ashtu me rroba ushtarake, prapë sytë e plakës i shquan mirë: njëri vinte pak i shëndoshë, fytyrë rrumbullak, me flokë të dendur, me ca sy të vegjël që lëviznin orë e çast; dhe ky ishte ai, që foli i pari dhe që sillej sikur të ishte mik i shtëpisë; kurse tjetri, që rrinte ca si mënjanë, i druajtur, me sytë lëshuar përdhe e që s'fliste, ngjante i ri, me atë trup të drejtë, i hequr në fytyrë, me ato mustaqe të holla e flokë të pakët.

Burrat morën të zhvishen, ndërsa plaka u fut diku brenda. Ata varën pushkët ndër ca ozozhda të mëdha, ku ndofta të zotët e shtëpisë vinin veglat e punës. Shkarkuan për tokë trastat, kundragazin, hoqën kapotat dhe u ulën të zgjidhin këpucët.

Kur u ngritën në këmbë, e zonja e shtëpisë u solli nga një peshqir.

— Fshihuni mirë — tha ajo dhe u priu mysafirëve përpara. — Urdhëroni, këndeje.

Ushtarët shkuan pas saj dhe hynë në dhomën e zjarrit.

— Hë, ikni që aty — u tha plaka fëmijëve, që kishin zënë vend të tre në një anë të vatrës. — Uluni, djema.

— Mos i ngit fëmijët, se ka vend për të gjithë — ja priti Feti dhe u doli të vegjëlte përpara, duke i kthyer prapë te qoshja. — Këtu, mos luani prej këndeje. Do të rrini me xhaxhin.

Të vegjëlit zunë vend atje ku ishin, duke vënë mysafirin në mes.

Zjarri kuqëlonte në vatër. Dhoma e madhe, me mure të bardhë, ishte shtruar me rrogoza e qylyma. Më të djathtë shtrilhej një krevat hekuri, kurse

në fund të dhomës gjendeshin dy sepete të vjetra, me lule të dala boje.

Xhemali kishte ndenjur në këmbë para oxhakut, i tërhequr pas një fotografie të madhe, që ishte varur sipër në një kornizë prej kashte.

— Djali? — pyeti ai plakën, që hynte e dilte orë e ças në dhomë.

— Hasani, të keqen! — psherëtiu plaka dhe qëndroi në krah të mysafirit. — U vra me monarkot në kufi.

Mysafiri e vështroi me vërejtje dhe pastaj me sytë ulur zuri vend afër vatrës, përkundrejt shokut.

— Ke tjetër veç atij? — pyeti Fetiut që merrej me fëmijët, po që e dëgjoi përgjigjen e të zonjës së shtëpisë.

— Kam, kam shqyr dhe një! — tha plaka, tek vështronte akoma djalin në fotografi — Kam të atin e këtyre fëmijëve, Kamberin. — Pastaj, duke drejtuar trupin foli me të psherëtirë: — Hasan, e shikon, të kanë ardhur shokët. Janë edhe ata ushtarë, si ishe ti!

Fëmijët shikonin nga e gjyshja të nemitur, me sy të xixëlluar, ndërsa flaka e zjarrit lodronte në fytyrat e burrave. Fetiut nuk i pëlqeu kjo heshtje që ra ashtu papritur, sikur dikush hodhi një plis dheu nga jashtë.

— Po Kamberin, ku e ke? — pyeti Fetiut me zë të lartë.

Plaka shkëputi vështrimin nga fotografia dhe u ul buzë vatrës.

— E kanë thirrur tok me nusen në luftë! — tha ajo, duke ulur kokën për t'i fryrë zjarrit.

— Në luftë!? — vuri buzën në gaz Fetiut.

— Jo në luftë, gjyshe, po në zbor! — tha djali i vogël, që rrinte në prehërin e mysafirit dhe vështronte me ca sy të pастër e kureshtarë.

Burrat qeshën në mënyrë të përmbajtur dhe bashkë me ta dhe dy vajzat e djali.

— Bravo! — ja bëri Feti, duke i fërkuar djallit kokën e qethur. — Sot s'ka luftë, por zbor. Shkon në shkollë ti?

— Shkoj! — u mburr i vogli.

— Luftë s'ka — tha plaka, duke ngritur kokën nga vatra, — po si luftë është kjo, mor djema, kur njeriu vishet e ngjishet me pishqollë, bashkohet me shokët, i bie vendit në të katër anët, hap istikame dhe stërvitet në shi e në qamet. I di partia këto punë më mirë se ne, more djema, apo s'e kam mirë?

— Jo, kush tha! — u hodh menjëherë Xhemali.

— Ashtu është. Partia thotë të përgatitemi në paqe që ta kemi më lehtë në luftë.

— Kështu, të keqen! — u kthye plaka nga Xhemali — Se jemi në gojën e ujkut...

Papritmas drita e llampës elektrike u pakësua dhe fill, pas kësaj, diku u shkreh një rrufë me të madhe. Njëra nga vajzat vuri gishtat në veshë. Plaka rrinte, sikur s'po ndodhte asgjë. Xhemali vështronte nga xhamet e errët të dritares, që ndizeshin herë pas here.

— Si të quajnë? — e pyeti Feti të voglin që u gëzohej mysafirëve të porsa ardhur.

— Hasan!

— E paske gjallë Hasanin! — tha mysafiri, që mbante djalin në prehër.

Plakës iu bë qejfi dhe tundi kokën.

— Gjallë e kam, gjallë. Po zotrote, i ke të rritur?

— Unë s'kam, jam beqar akoma, po Xhemali ka dy!

Xhemali buzëqeshi dhe miratoi me kokë. Ai desh pastaj të shpjegojë, po s'e la Feti:

— Këtë do më shumë, besoj, se vajzat.

Vajzat qeshën, duke vështruar nga e gjyshja.

— Evlati njësoj duhet. Si djali vajza sot një janë. Drita, ngreu sill një dru. Ti, Hasan, mos e bezdis xhaxhin...

— Jo, jo, s'ka gjë — tha Feti.

Vajza u ngrit e doli nga dhoma. Pas pak u çua dhe e motra.

— I kam të mbara në shkollë — tha e gjyshja.

— Ky shejtani sivjet shkoi për herë të parë.

Xhemali rrinte me sytë ngulur te zjarri, që ishte bërë shpuzë.

— Mos të dhemb gjë koka, mor bir? — e pyeti plaka.

Burri lëvizi, thua se nuk e priste këtë pyetje.

— Jo, po jam ca i lodhur — tha ai dhe pa me bisht të syrit nga shoku.

— Ka fjalë pak Xhemua — shtoi shoku e zgjati duart t'i merrte drutë vajzës që iu afrua vatrës.

— Kush e do më shumë gjyshen nga ju?

Vajza fytyrë vezake, me gërsheta të shkurtëra, vari kokën, duke buzëqeshur dhe u ul pranë gjyshes. Tjetra u ngjesh pas së motrës. Ajo vinte e imët, me flokë të drejta dhe shumë e turpshme.

Pas pak, plaka u ngrit, hapi njërën sepete dhe nxori dy gota me raki, vënë në një pjatë alumini. Burrat morën gotat, uruan dhe i kthyen me fund.

— Nga ju kemi zotrinë tuaj? — pyeti plaka, si u ul rishtas në vendin e parë.

— Nga qyteti — u përgjigj Xhemali, me vonesë.

— Ti je më e madheja? — u hodh papritur Feti, duke parë nga vajza me fytyrë vezake.

— Jo, — tha ajo e druajtur — unë vij pas Bardhës.

— I ka bërë e ëma të dyja në krye të motit — shpjegoi plaka.

— T'u rrojnë!

Plaka s'arriti t'i përgjigjet, se dy rrufe plasën njera pas tjetrës dhe shtëpia u lëkund si tërmet. Asnjëri nuk bënte zë. Dëgjohej shiu që binte me rrëshekë, duke trokitur me të fortë në dritare.

— Po ju, xhaxhi, ushtarë jeni? — tha djali, tek u kthye me fytyrë nga mysafiri që e mbante në prehër.

— Jo, diversantë! — qeshi Feti dhe bashkë me të qeshën dhe të tjerët. Ndërkaq balli i Xhemalit u rruadh dhe ai u mundua të vështrojë shokun vëngër. Po Feti as që e vuri ré.

— Ushtarë jemi, ushtarë të Republikës — i mëshoi zërit ai.

— Dhe sa ju kanë mbetur? — pyeti plaka, duke u munduar t'i vështrojë të dy burrat njëherazi.

— Ne jemi si yt bir — u hodh menjëherë Xhemali. — Na kanë thirrur në zbor.

Plaka u gjallërua e tëra dhe desh të thotë diçka. Kjo dukej nga sytë, që i morën vetiu një shkëlqim të lehtë.

— Mos e patë gjë Kamberin andej? Është me ata të fermës!

— Ne jemi në një batalion tjetër — tha Fetiu.
— Është gjithë dynjaja andej, se po bëhet lojë e madhe ushtarake.

— Këndeje rrotull do të jetë — tha Xhemali për të qetësuar plakën.

— Mos u bëj merak — arësyetoi Fetiu — Do të jetë futur dhe ai në ndonjë shtëpi.

Nëna e Kamberit ngriti kokën dhe e shikoi me çudi.

— Pse, dhe juve kështu ju shpërndanë? Ju thanë të shkoni nëpër shtëpira?

— Jo, jo, — nxitoi të përgjigjet Fetiu. — Ne ishëm me punë këndeje. Qëlloi që na zuri ky qameti dhe kthyer këtu. Shokët janë të gjithë në detyrë. Dhe ne në detyrë jemi.

Plakës iu largua ajo gjallëria e parë.

— Kështu them dhe unë — tha ajo si e menduar — S'ma merr mendja që komandantët t'ju lëshojnë kaq kollaj. Ushtria pse është ushtri. Ushitari s'pyet as për shi, as për furtunë.

Sakaq burrat u panë në sy. Fëmijët sikur u tulanën. Të mëdhenjtë morën një hije. Heshtja tani u bë më e qartë. Bubullimat qenë larguar dhe kohë më kohë shkrepëtinte dobët. Po shiu s'kishte pushuar akoma.

— Qëparë, në mëngjez këndeje, — tha plaka — kaloi ushtri e madhe...shokët tuaj do të kenë qenë...Ca ikën tutje, matanë Kanalit të Lumit, po një pjesë qëndruan ja, aty poshtë te mulliri i Lames. Më thanë se atje po hapin istikame.

Xhemali u kollit dhe lëvizi vendit, po Fetiu nuk i ngriti sytë. Ai i kishte kthyer një pjesë të kurrizit zjarrit e shikonte nga plaka.

— Fluturuan dhe aeroplanë — tha vajza, që

s'kishte hapur asnjë herë gojë, po që, porsa tha këto fjalë, u çel në fytyrë.

— Kaluan dhe tankse! — gati sa s'thirri djali i gëzuar.

— Ashtu! — u habit, duke qeshur Feti.

— Ke tanks, ti xhaxhi? — pyeti i vogli.

— Jo, unë s'kam, po ushtria jonë i ka të gjitha e nuk i mungon asgjë.

Feti fliste, kurse shokut të tij nuk i vinte mirë.

Plakës i pëlqyen fjalët e mikut.

— Ashtu është, mor bir — tha ajo dhe pastaj shtoi me zë të plotë — S'është Shqipëria si një herë. Në këmbë janë gjithë bijtë e nënave. E mbajnë barutin thatë ata!

Feti u kthye ashtu siç ishte më parë dhe, tek ndeshi vështrimin serioz të Xhemalit, i shkeli syrin. Djali i vogël e pa dhe qeshi.

— Një gotë ujë desha! — tha Feti.

Bardha u mat të ngrihej nga vendi, po e gjyshja s'e la:

— Rri ti se po shkoj unë!

Plaka doli nga dhoma. Burrat mbetën vetëm me fëmijët. Vështrimet e tyre u përpoqën rishtaz, po prapë s'po merreshin vesh.

— Sikur rreshti pak shiu — foli Xhemali.

— S'ka ndër mend të pushojë ky sonte! — Zëri i Fetiut tingëlloi i vendosur. Pastaj, ai shtoi me ngut:

— Po ti Hasan, çfarë do të bëhesh?

— Unë do të bëhem pilot! — tha djali me mburrje.

Burri, që e mbante në prehër, në vend që t'u

vinte veshin atyre që i tha i vogli, i foli shokut përkundrejt:

— Ti mos më rri sikur të janë mbytur gjemite! — Domethënë do të bëhesh pilot, bravo!

Vështrimi kureshtar i fëmijëve lëvizte sa te një burrë, te tjetri. Mysafirët rrinin sikur të ishin të zemëruar. Të vegjëlit druhashin t'i shqetësonin. Xhemali u mat të fliste, po plaka hyri me gotën e ujit në dorë.

— A pushoi ndopak shiu? — pyeti Xhemali.

E zonja e shtëpisë i zgjati gotën mysafirit dhe shikonte nga dera:

— Jo, jo, s'ka pushuar! Po do të hani një çikë?

— Faleminderit — tha Xhemali — Kemi ngrënë...

— Ka derzhava plot! — ja priti Fetiu, duke qeshur.

Xhemali u ngrit në këmbë e iu afrua dritares. Mbështolli sytë me dorë dhe u mundua të shohë jashtë. Shiu vijonte të binte si gjithnjë. Ai ngriti kokën, duke qëndruar më këmbë në mëdyshje.

Plaka e vështronte me vëmendje:

— Po qetë në detyrë, more djema, nxitoni. Të gjithë djemtë e nënave jashtë janë sonte!

— Ashtu do të bëjmë — tha i menduar Xhemali e zuri të kopsitë xhaketën ushtarake.

Në dhomë u nder sërish qetësia. Asnjë nuk fliste. Zhurma e shiut ndihej me një shushurimë të zgjatur e monotone. Fetiu kishte marrë mashën e trazonte hirin e vatrës.

Si mund të zbresim më shkurt tek ura e Baçit? — pyeti burri më këmbë.

— Dilet kollaj — tha plaka — Merrni krahun e majtë dhe mbani rrugës tatëpjetë..

Xhemali doli në hajat dhe si veshi këpucët, hyri prapë në dhomë. Shoku i tij tundte mashën dhe e ndiqte me bisht të syrit.

— Çou, Feti se u vonuam e na presin shokët! — thirri Xhemali, duke u kopsitur. — Shiu s'don të pushojë.

Plaka menjëherë u çel në fytyrë, kurse Fetiu u rrudh e tha si pa qejf:

— Shi bie edhe atje ku janë shokët. Ata e dijnë se s'po rrijmë kot!

— Shiu ka punën e tij, ne kemi tonën, — tha Xhemali duke dalë në hajat.

Plakës i qeshën sytë e me shikim nga miku që po dilte, tha:

— Ashtu, biri nënës, ashtu! Shihni detyrën ju, se hasmi këtë kohë pret. Kështu thotë nëna, por ju i dini më mirë këto punë.

Fetiu nuk deshi të ngrihet njëherë nga qoshja e ngrohtë, po kur pa që Xhemali po vishej me gjithë mend në hajat e plaka me ato fjalë zu të qëllonte larg, ngriti djalin nga prehri dhe u çua. Të vegjëlit i hapën rrugën dhe ai iu qas dritares.

— Bie, xhaxhi, bie! — tha Hasani.

Burri s'foli, po hapi gojën dhe u shtriq.

— Shko merri xhaxhit këpucët — tha ai dhe u ul mbi sepete.

Fëmijët u turrën të tre dhe kur u kthyen, i sollën jo vetëm këpucët, po dhe kapotën e plaçkat e tjera që kullonin akoma ujë.

— Xhaxhi, kur e vë maskën të zihet fryma? — pyeti djali, duke rrotulluar nëpër duar zorrën e saj prej llastiku.

Burri i huaj mbathte këpucët ngadalë e me përtesë.

— Të zihet the? Të zihet, ore çun, të zihet...

— Po nuk vdes? — pyeti vajza me fytyrë vezake.

Mysafiri ngriti kokën. Vështrimi i habitur i vajzës e detyroi ta korrigojë përgjegjen:

— Jo, jo nuk vdes... Kush tha?

Atë çast, Xhemali hyri i veshur e me pushkë në krah. Ai i dëgjoi pyetjet e fëmijëve.

— Maska — shpjegoi ai — i shërben ushtarit për të shpëtuar jetën, kur armiku helmatis ajrin.

Ai zbertheu trastën e tij, mori maskën dhe e vuri në fytyrë. Fëmijët qeshën. Hasani përplaste duart.

— Hasmi është i lig shumë — ja bëri plaka nga dera, ku rrinte mbështetur. — Ai i vret fëmijët, djeg e shkatërron, prish tokat, helmatis vendin... Ç'nuk bëri gjermani sa ishte këtu! Po ata amerikanët atje në Vietnam?

Kur u bë gati dhe Fetiu, të gjithë dolën në hajat. Plaka shkoi përpara dhe, para se miqtë të kapërcenin prakun, u futi në xhep nga një grusht arra.

— Të faleminderit — tha Xhemali, tek u fërkonte kokën fëmijëve. Na e bëj hallall që të bezdisëm ca...

Fetiu tundte kokën për të miratuar fjalët e shokut, ndërsa sytë i qenë zvogëluar.

— S'kemi ç'të bëjmë! I ka ushtria këto — tha Fetiu, kur i zgjati dorën zonjës së shtëpisë.

— Nënës i vjen keq që s'u mban dot, po ju jeni në detyrë. Derën hapur e keni, kur të doni.

Kush e di takoni andej dhe Kamberin e vini tok me të.

Ajo bëri përpara dhe çeli derën. Era e ftohtë e vjeshtës u dynd vrulltas brenda. Jashtë, në dritën që ra në oborr, shiu i dendur ngjante si një rrjetë e artë. Djali i vogël doli te praku i derës e zgjati duart.

— Hapi rrugën xhaxhit — thirri plaka — Hyni brenda se do të plevitoseni.

Po fëmijët nuk lëvizën nga vendi. Ata panë se si mysafirët i shtrënguan dorën gjyshes dhe kapërcyen një pellg uji në mes të oborrit. Plaka për t'u bërë dritë e mbajti derën hapur. Fëmijët herë pas here zgjasnin kokën të shikonin miqtë, tek largoheshin.

Burrat, si kapërcyen derën prej lese të gardhit të shtëpisë morën në të majtë rrugën tatëpjetë dhe u zhdukën në errësirën e pafund.

Në krye printe Xhemali. Ai i hidhte çapat me nxitim, ndërsa Feti u ecte sikur e shtynte njeri nga prapa. Rruga tani ishte më e vështirë. Ujët rridhte nga të gjitha anët si lumë. Vetëtimat qenë larguar dhe drita e tyre e zbehtë u ndihmonte pak. Ata ecnin me hamendje, duke u munduar të mos humbisnin drejtimin e të mos binin në ndonjë rrëzomë.

Kur zbritën poshtë faqes së kodrës, në rrugë, afër mullirit të Lames, ku qenë vendosur shokët e tyre nëpër llogore, Xhemali i ngadalësoi hapat. Prej andej vinin jonet e një kënge të fuqishme burrash.

— Akoma në pritje janë — tha Feti u — kot u nxituam...

Sidoqoftë, — ja ktheu Xhemali — ne nuk bëmë mirë që u larguam pa leje...

Fetiu vinte pas tij, duke marrë frymë rëndë, ndërsa këpucët i zhyteshin nëpër ujë e baltë.

— E ç'i gjeti shokët? Asgjë — arësyetonte si me vete Xhemali. — Më mirë të ishim lagur si të gjithë...

Befas tjetri qëndroi në vend dhe seç murruriti me zemërim.

— Të ishte për mua — u dëgjua pastaj qartë zëri i tij — kisha ndenjur dhe ca, se s'u bë qameti. Po ç'të të bëj ty!

Xhemali u kthye nga ai.

— Pse s'ndenje atëhere? Unë s'të mora me zor.

Fetiu në vend që të përgjigjej, filloi të ecë. Xhemali e ndoqi pas. Ata hidhnin hapat në heshtje, duke çarë errësirën e natës që ngrihej si perde e zezë.

— Fol, de! — thirri rishtas i pari.

Tjetri nuk u përgjegj prapë.

Ata vazhdonin të çapiteshin.

— Unë them t'i dalim nga prapa e jo nga xhadeja — ja bëri pas pak Fetiu. — Kështu nuk na shohin shokët.

— Përsëri ti më këto! — ja priti i vendosur Xhemali. — Jo, do të vemi drejt e te komandanti e t'ja themi të gjitha... T'i themi se nuk duruam dot...

— Thuaja ti, unë s'ja them... Fundi kohë pushimi ishte...

— Vërtet kohë pushimi, po ne s'kemi ardhur këndeje për shëtitje. Si duket, nuk na mjaftuan po-

rositë e komandantëve tanë. Patëm nevojë të dëgjojmë fjalët e asaj nënës atje lart.

Në zërin e Xhemalit ndjehej një notë zemërimi e dhimbjeje. Atij i bëhej sikur dikush i kishte lidhur një nyje në grykë dhe ai mezi priste të shkonte te komandanti të zgjidhte atë nyjë.

Ata çanin baltën pa folur, të rrethuar nga rrjeta e hollë e shiut. Nga ana e detit ndizesh e fikesh kohë pas kohe drita e dobët e vetëtimave. Matanë, nga xhadeja vinte uturima e një auto-kolone. Përtej shquante në errësirë mulliri i vogël.

Papritmas shkrepri në qiell një fishekzare jeshile. «Sa mirë, erdhëm në kohë» — mendoi Xhemali dhe nxitoi hapin.

Ata u qenë afruar transheve. Kënga e ushtarëve tani dëgjohej akoma më qartë. Zërat e shokëve në krahët e këngës u gjëmonin fort në vesh.

Xhemali dhe Fetiu hidhnin hapat e fundit.

BREDHI I BARDHË

1

Shoku im K. më tregon:

Ekziston ndonjëherë mendimi sikur puna jonë kryhet në një rreth të mbyllur, nga njerëz të veçantë, brenda disa caqeve të rrepta. Natyrisht, ky është një përfytyrim i gabuar, për më tepër i huaj, se karakteri i detyrës sonë ndryshon krejt nga ajo e armiqve. Tanimë është bërë një praktikë e zakonshme që punët tona nuk mund t'i kryejmë pa ndihmën e njerëzve. Dhe këtu, s'është fjala për disa njerëz, po për qindra e mijëra të tillë, që ndërgjegja qytetare i lidh e i bashkon orë e çast me ne. Është fjala për tërë popullin. Dhe populli është si ai kollosi i gjallë që nuk e duron të keqen në trup të tij, po shqetësohet dhe kundërvepron menjëherë.

Ne, sado të përgatitur të jemi, sado që të punojmë, prapë s'mund ta arrijmë atë që bëjnë qindra e mijëra njerëz veças ose tok, as me fantazinë tonë më të gjallë. Ky është çelësi i të gjithë enigmave të përditshme, me të cilat është mbushur puna jonë. Zakonisht, e nisin vetë njerëzit dhe çeshtja kalon si stafetë dorë më dorë, deri

sa i arrihet qellimit. Ne vetëm organizojmë dhe drejtojmë.

Ndodhi njëherë kështu:

2

Një mëngjez heret, punëtori Skënder L. po shkonte si zakonisht për në punë. Ecte më këmbë, nëpër rrugën që vjen paralel me bregun e liqenit. Ai punonte në një ndërmarrje jashtë qytetit dhe këtë rrugë e bënte përdita. Ecte i shkujdesur, me merakun që të arrinte në kohë. Po atë ditë, tek vështronte nga liqeni, padashur i tërhoqi vëmendjen një varkë që lëkundej lehtë mbi valët e mëngjezit. Varka ishte fare bosh, dhe, sidoqë ai qëndroi në vend dhe shikoi me kujdes, nuk i zuri syri ndonjë njeri në të. Ndërkaq, era e veriut e shtynte varkën gjithnjë e më tutje në thellësi të liqenit. Kjo pamje jo e zakonitë e bëri të mendohet. Thua ta kenë harruar pa lidhur peshkatarët? Po ai e dinte sa kujdesen peshkatarët për varkat e tyre. Të jetë shkëputur vetë? Edhe kjo s'ishte për t'u besuar: nata e kaluar kishte qenë e qetë, pa erë e dallgë. Atëhere, Skënderi nuk humbi më kohë në arësyetime, po vajti në breg, u zhvesh me të shpejtë dhe u hodh në ujë. Ishte ditë dhjetori dhe ai burrë shëndet pakët mezi e çante ujët e ftohët. Varka që larguar goxha, po kjo s'e pengoi atë ta arrijë e ta kapë. Duke notuar me një dorë, ai e shtyti varkën deri sa e afroi në breg. Pastaj, me shumë mundime e nxori nga ujët dhe e përmbysi sipër disa shkurreve, duke fshehur poshtë varkës dhe një lopatë që gjeti rë të.

Punëtori u vesh dhe mori prapë rrugën për në qytet. Fundi mungesën në punë do ta justifikonte. Atë e shqetësonte seriozisht një dyshim.

Ai erdhi drejt e në zyrën time. Ne nuk njiheshim dhe s'ka si të njiheshim. Në zyrat tona hyjnë e dalin me dhjetra njerëz të panjohur në ditë.

Ai foli shkurt, tregoi ç'i kishte ndodhur, ç'kishte bërë dhe paraqiti dyshimet e tij. Unë, si zakonisht në këto raste, e dëgjova me vëmendje, mbajta shënime të hollësishtme. Para se të largohej ai tha se ishte gati të ndihmonte prapë në rast nevojë.

Kur qytetari Skënder L. mbylli derën, unë mblodha dokumentat dhe, pa humbur kohë, u ngrita dhe vajta e i raportova shefit tim.

— Po, — më tha shefi — tani sapo na njoftoi njësitë kufitar i postës R. Gjatë kontrollit të mëngjezit është gjetur në bregun e djathtë një varkë hedhur mbi shkurre...

«Të dhënat qenkan njëlloj, mendova — Qytetari ka arritur në kohë».

Pastaj ne heshtëm, duke qëndruar ballë njëri tjetrit. Shefi vështronte nga dritarja, që binte nga ana e liqenit e herë pas here thithte cigaren. Për ne, që punonim me të, kjo pamje e tij kishte kuptim të qartë: çështja ishte shumë e rëndësishme dhe meritonte vëmendje të madhe. Në këto raste, ai, nuk dinte të mendonte gjatë. Shefi ynë vendoste në çast e në veprim e sipër lindnin dhe mendimet...

— Mirë, — foli ai, si me vete. Tani merr grupin operativ dhe shko në vend.

Grupi hypi në maqinë dhe maqina mori drejtimin nga bregu i djathtë i liqenit. Mua akoma më vërtitej në kokë pyetja: ç'mund të ishte ajo varkë e braktisur, disa qindra metra larg kufirit?

Kjo pyetje s'm'u nda gjatë tërë rrugës. Me këtë pyetje niste ky aksion i zakonshëm, me të cilin nuk di sa kohë do të merresha...

Zbritëm nga maqina dhe u drejtuam për në vendin e ngjarjes. Varkën e gjetëm mbështetur mbi disa shkurre të dendura. E kundruam me kujdes e pastaj e kthyem mbarë. Para nesh ishte një varkë e rëndomtë, e ndërtuar rishtazi, e lyer me bojë të bardhë, me përjashtim të fundit të saj që ishte në ngjyrë gri. Në të dy krahët e varkës qëndronin dy doreza, lyer dhe këto me bojë të bardhë. E kontrolluam më pas me imtësi se mos gjenim ndonjë send apo ndonjë gjurmë, po s'doli gjë. E vetmja provë materiale, veç varkës, ishte lopata. Me vështrimin e parë vumë re që ajo s'ishte lopatë e zakonshme për vozitje, po lopatë lëmi, nga ato që përdorin fshatarët, kur shijnë grurë. Qe punuar trashë dhe në dy vende, ndonjë metër larg njëra tjetrës ishte ngrënë e gërvishur.

— «Si duket, me këtë lopatë — mendova atë çast dhe e mora atë në dorë — e kanë bartur varkën deri këtu!

Shokët e grupit gjithë vëmendjen e tyre e përqëndruan në disa gjurma, që kishin mbetur në sheshin përgjat bregut. Nëpër rërën e lagur dukeshin qartë gjurma këmbësh të lhuaja e vende vende shenja të varkës, të cilën, siç dukej, e kishin

zvaritur. kishte shumë të ngjarë, nga sa tregonin gjurmat, që të panjohurit të qenë nxituar tepër në veprimet e tyre. Ne fotografuam gjurmat gjer në një shenjë vendi, se më tej ato humbnin nëpër gëmushat e shkurret, në largësi të gjolit. Kështu që na u desh të thërrisnim në ndihmë Jankën, qenin e grupit. Janka i nuhati shpejt gjurmat dhe pasi kapërceu zonën e shkurreve, doli në rrugën automobilistike. Këtu, ai u vërtit sa andej këndeje, sepse terreni ishte i fortë dhe gjurmat e të panjohurve ishin prishur nga lëvizjet e ditës. Megjithatë, qeni shkoi më tutje dhe, ne, duke vajtur pas tij u gjendëm në një qëndër të banuar. Aty ishte ofiçina e ndërmarrjes gjeologjike, fjetorja e punëtorëve, magazinat dhe disa shtëpi banimi.

Janka u suall disa herë verdallë, e pastaj, pa bërë asnjë dredhë, hyri drejt e në një shtëpi që vinte pak si veç shoqeve. Unë e njihja mirë atë shtëpi dhe hetimet e qenit më ngjallën në çast një dyshim të vjetër...

Pas kësaj, ne u kthyem, duke marrë me vete varkën e lopatën. Unë vajta në zyrë me bindjen se kisha rënë në gjurmë. Pasi mendova variante të ndryshme, u përqëndrova tek njeri prej tyre dhe me këto mendime trokita në derën e shefit. I raportova gjatë e gjërë për punën që kreu grupi. Ai, si gjithnjë, më dëgjoji pa më ndërprerë e pastaj t'ha i menduar:

— Vështirë ta pranosh atë që thua ti... S'mjaftojnë vetëm arësyetimet...

Unë luajta vendit dhe sado që isha i ri në detyrë, u përpoqa t'i mbushja mendjen:

— Ju e dini se djali i madh i kësaj familje, Agroni, është thirrur disa herë nga ne, për sjelljet e tij të këqia. Kohët e fundit është këshilluar rëndë për faktin se është kapur në zonën e kufirit.

Shefi më dëgjonte me vëmendje dhe këtë gjë e kuptova akoma më mirë, kur ra zilja e telefonit dhe ai nuk e ngriti fare dorezën.

— Ashtu është, si thua ti — tha ai i qetë — Po këto janë vetëm dyshime. Rëndësi ka ç'thonë provat materiale...

Atë çast, ndjeva që në gjoks zemra më rrahu me vrull, e duke u munduar të mos e tregoj gëzimin tim të papritur, shpjegova:

— Gjatë kontrollit personal që bëmë në shtëpi, gjetëm në teshat e Agronit njolla boje të bardhë, krejtësisht të ngjashme me bojën e bardhë të barkut të varkës.

Eprori im më vështroi në sy, me një mënyrë të tillë, sa unë aty për aty e kuptova se isha nxituar.

— Megjithatë, — tha ai, — e kemi vështirë akoma të konkludojmë. Bëni njëherë analizën kimike të bojës. Studjoni sjelljet e Agronit, pa vënë dorë mbi të. Terthorazi mbajeni në mbiqyrje.

Dola nga zyra e shefit i menduar e i pakënaqur nga puna ime. Çështja ishte më e ndërlikuar nga sa pandehja unë.

Pa humbur kohë, bëmë analizën kimike të bojës. Analiza na tregoi se boja e bardhë e teshave të Agronit kishte përbërje të ndryshme nga ajo e varkës. Veç kësaj, duke vazhduar hetimet në vënd, doli se Agroni bojën e bardhë e kishte marrë në magazinën e ndërmarrjes, ku punonte. Kjo u vërtetua dhe nga magazinieri. Me atë bojë ai kishte lyer një dollap të shtëpisë. Këto fakte të papritura, nuk di sepse më tingëlluan si një tallje për besimin naiv që kisha patur se vetëm me nihatjen e Jankës mund të ishte zgjidhur enigma.

Çështja kështu hyri prapë në errësirë. Shokët e punës më kritikuan në mbledhje për veprimet të nxituara e të pasakta. Pas kësaj, pata një bisedë të gjatë me shefin. Tani çdo gjë duhej filluar nga e para. Të dhënat nga jashtë mungonin krejtësisht. Kishim në dispozicion vetëm një varkë e një lopatë lëmi! Nga t'ja fillonim? Grupi operativ priste udhëzimet e mia. Tek e fundit vendosëm të kthehemi prapë tek vendi i ngjarjes. Vajtëm dhe e kontrolluam vendin pëllëmbë për pëllëmbë në një periferi më të gjerë. Kësaj here gjetëm një lopatë të fshehur në mes të busheve. Edhe kjo, nuk ishte lopatë varke, po lopatë furre. Për një çast na xixëlloi një shkëndijë shprese, kur diktua në dorezën e saj diçka të shënuar me laps plumbi, **po këtë nuk arritëm ta shquanim**, pasi lagështira e kishte prishur. Lopata në vendin ku u gjet, rrëfente tërthorazi se tentatorët e kishin marrë me vete deri në një farë vendi dhe pastaj, për të mos rënë në sy, e kishin fshehur.

Por vetëm kaq. Cilët ishin këta dhe ç'kishin ndër mend të bënin, mbetej gjithnjë një pyetje që kërkonte përgjegje të saktë.

Përsëri përpara kishim varkën po tani, jo me një, po me dy lopata. Sa mund të na flisnin këto me gjuhën e tyre të heshtur, kjo ishte pyetja që ngrihej para nesh. Në mungesë të burimeve të tjera, ne duhej t'i bënim ato të tregonin, të flisnin. Po para se t'ja arrinim kësaj, shkëmbyem mendime me disa peshkatarë, duke shpresuar se ndonië fjalë e tyre do të na ndihmonte, por në të vërtetë ata pohuan po ato gjëra të njohura. Thanë se varka, sapo është ndërtuar dhe se një varkë të tillë nuk ua kishite zënë syri. Atyre u erdhi shumë keq që nuk mundën të na ndihmonin dot, ndërsa mua më mbetej të vazhdoja në heshtje dialogun me vete. Ngelej sërisht varka me dy lopatat, me të cilat duhej të zgjidhnim nyjen e enigmës.

Pasi u mendova gjatë i bëra vetes këtë pyetje: Ç'dija unë për ndërtimin e varkave? Nuk dija asgjë. Atëherë u ngrita dhe shkova tek ata që ndërtojnë varka; pashë, pyeta, dëgjova dhe që atje më lindi ideja e zbërthimit të varkës. Mblodha shokët dhe u propozova:

— Sikur ta zbërthenim njeherë varkën. Kush e di, mund të zbulojmë ndonjë gjë brenda saj.

Shokët ranë dakord dhe ndërkaq filluam nga puna. E zbërthyem copë copë, duke ndarë mënjanë dërrasat nga pjesët e tjera. Tek bënim këtë, vura re se në mes të dërrasave nuk ishin vënë fije liri, ciç vepronin ndërtuesit e varkave që pashë në mëngjez, po copa të gjata leckash. Në fillim na u duk sikur nuk gjetëm asnjë gjurmë, po kur pamë që mbetëm pa gjë, atëhere e drejtuam vemendjen tek lecat.

Ç'ishin këto lecka? A mund t'i ndihmonin qëllimit tonë? Puna e parë që bëmë, i mblodhëm tok, i lamë e i pastruam dhe u munduam të shohim në se kanë ndonjë lidhje në mes tyre. Për çudinë tonë, kur i bashkuam njera me tjetrën, u sajua papritur një këmishë gruaje. Këmisha, në pjesën e përparme ishte qendisur me motive popullore, që neve aty për aty na ngjanin të njohura. Po prapë, na u duk shpejt për t'u gëzuar. Leckat i qepëm njëra me tjetrën dhe me këmishë në dorë hyra në zyrën e shefit.

Ai priste që unë t'i raportoja, ndaj kur vajta më priti me interes të veçantë:

— Hë, ç'kemi?

Unë nuk iu përgjegja nga emocionimi që më kapte befasi, po i ndera këmishën mbi tavolinë. Të them të drejtën druhesha se mos ai e quante prapë të parakohshëm gëzimin tim.

Ai hapi sytë pak i habitur.

— Ç'është kjo këmishë?

— E gjetëm në mes drراسave të varkës — i shpjegoja, duke vështruar ngultas këmishën.

— Gjynah që e paskan prishur këtë këmishë të bukur! — tha shefi me një ton, që unë s'e kuptova aty për aty, sepse për mua bukuria qëndronte gjetkë. Gjetkë qëndronte edhe për shefin tim. Po ai e tha këtë fjalë dhe pastaj pyeti, duke parë nga dritarja:

— Ç'mendon të bësh?

Unë e kisha menduar mirë përgjigjen:

— Them të gjejmë se në ç'zonë të krahinës sonë veshin këmisha me këto lloj qendizmash. Kjo do të na ndihmojë për lokalizimin e hetimeve...

Shefi më dëgjonte me vëmendje.

— Mirë e keni menduar si fillim — tha në fund

ai — po ti e di se ky aksion s'ka si kryhet me sukses, po qe se s'kërkoni ndihmën e njerëzve. Vetëm ju, s'e bëni dot. Shkoni takohuni me ta...

5

Të nesërmen vajta në një fshat buzë liqenit, duke menduar, nga sa e njihja unë etnografinë e krahinës, se këmisha me qëndizma të tilla mbajnë vetëm asaj ane. Dhe këtë gjë më mirë se gratë s'kishte kush të ma sqaronte. Hyra në një bisedë me disa gra dhe pastaj u tregova këmishën.

— S'është nga anët tona — thanë ato në një zë.
— Ne nuk qëndisim nga këto lule.

— Këto qëndizma, mor bir — shtoi një plakë — i bëjnë në fshatrat matanë kufirit...

Mua m'u duk sikur ma morën këmishën nga duart e ma hodhën në tokë, si një plackë pa vlerë. U gjenda para një dileme të re. Këmisha të bënte të mendoje tani se varka kishte mundësi të ishte ndërtuar matanë kufirit. Mos kjo varkë u takonte peshkatarëve të huaj dhe ndonjë erë e fortë e kishte këputur dhe e kishte sjellë në viset tona? Ky ishte arësytimi i parë, po arësytimet të tjera e rrëzonin poshtë: ç'ishin ato gjurmë në breg? Ç'donte ajo lopatë, fshehur në mes busheve? Në këto rrethana, hë për hë, këmisha nuk na shërbente.

U duk sikur u kthjem prapë atje ku ishim. Po besimin nuk e kishim humbur. Pa këtë besim nuk bën dot në detyrën tonë. Duhet të dilnim me doemos nga ai rreth, ku kishim hyrë. Puna jonë i shëmbëllen asaj që thoshte një natyralist i famshëm: më jepni një kockë, t'ju jap skeletin. Kështu dhe

ne, kishim përpara varkën bashkë me dy lopatat dhe me ta duhej të punonim.

— Nuk jemi fare pa mbështetje — na tha shefi në një mbledhje — Varka nuk ka rënë nga hëna!

Vërtet, nuk kishte rënë nga hëna, ishte ndër-tuar në tokë, në rrethin tonë, ndofta, në qytetin tonë. Ky ishte mendimi që më shqetësoi për disa ditë me radhë. Mora dërrasat e varkës dhe i pastrova nga boja e lëndët e huaja. Dërrasat m'u dukën se ishin bërë nga një lloj druri, po se nga çfarë druri, këtë e kisha zor ta përcaktoja. Zor e patën edhe shokët e mi ta thoshin. Këtë mund ta përcaktonin sharrxhinjtë e Pyllit të Plisës.

Kur vajta tek sharrxhinjtë, ata po bënëin pushimin e drekës. Njihesha me përgjegjësin e tyre dhe nuk hoqa keq të lhyja në muhabet. Ndezëm nga një cigare dhe fjala nxori fjalën, deri sa dolëm tek dërrasat e mia, dy nga të cilat i kisha sjellë me vete. Atyre, as që u shkoi mendja se për çfarë mund të kishin shërbyer ato dhe për ç'arësye i kisha sjellë gjer atje.

— Prej ç'druri mund të jenë këto dërrasa? — i pyeta.

— Këto?! — tha një nga punëtorët, i habitur që unë nuk e dija — Bredh, është, more shok, bredh i bardhë...

Unë tunda kokën, duke mos ja vënë veshin, habisë së tij.

— Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë — tha përgjegjësi — rritet në vende të larta malore.

— Ke shkuar ndonjëherë në fshatrat e M.? — pyeti një druvar plak — Atje do ta gjesh bredhin e bardhë. Në tjetër vend s'e gjen!

Mua atë çast m'u ngroh zemra. Sharrëxhinjtë nuk e kuptonin dhe s'kishin si ta kuptonin, gëzimin tim të fshehtë.

— Tani, po — tha shefi, kur i raportova për bisedën që bëra me sharrëxhinjtë — mund të them se e kemi futur çështjen në rrugë...

Dhe që atë natë u nisa për në fshatrat e zonës së bredhit të bardhë. Kisha në dorë një çelës që do të më ndihmonte. Harrova të them se sharrëxhinjtë më thanë gjithashtu se dërrasat qenë prerë me sharrë dore dhe se, nga forma, nuk i përmbahehin standartit shtetëror. Kjo më bëri të mendoja se kishte shumë të ngjarë që druri i dërrasave të varkës të qe prerë në pyll me leje. Prandaj, puna e parë që bëra, shtiva në dorë listën e emrave të atyre që kishin marrë leje për të prerë dru në pyllin e bredhit të bardhë. Lista ishte e gjatë, po unë s'hoqa zor t'i identifikoja njerëzit. Për këtë, më erdhën në ndihmë shokët e fshatit, të cilët më dhanë të gjitha sqarimet. Kur arrita tek numri tridhjetë e pesë i listës dhe dëgjova mendimet e shokëve për një bashkëfshatarin e tyre, thashë të qëndroja aty. Ishte kulaku Sadik V. Mendohesha të përqëndrohesha tek ky person dhe kështu veprova. Po nga hetimi që bëra nuk më doli ndonjë gjë e rëndësishme. Prapë nuk kisha qëlluar në shenjë si duhet.

6

E lashë njëherë mënjanë çështjen e dërrasave dhe u mora me lopatat. Ku mund të ishin punuar ato? Në muhabet e sipër me fshatarët u informova se lopata të tilla i bënte vetëm një mjeshtër plak nga fshati P.

Mora lopatat dhe vajta në mbrëmje te plaku. Ja tregova dhe ai, sapo i pa, e njohu njerën prej tyre.

— Këtë e kam bërë me dorën time — tha plaku — Vetëm tri lopata furre kam punuar kështu. Kjo është lopata e Sadik V. E sheh shenjën që është prishur? Ka qenë emri i tij. Sadiku është familje e madhe dhe përdor furrë në shtëpi.

Unë qesha me vete që e ndesha sërish emërin e Sadik V.

Mjeshtri plak e kuptoi se diçka e rëndësishme luante në këtë mes dhe priste fjalën time.

— A nuk çon djalin njëherë t'ja kërkojë lopatën Sadikut? — i thashë, i menduar.

— Posi, që tashti!

Kur u kthye djali nga shtëpia e Sadikut, tha:

— Lopatën xha Sadiku nuk e ka në shtëpi. Ja ka marrë hua Todi K. dhe s'ja ka kthyer.

Tani më doli një emër i ri. Duke parë listën e fshatarëve që kishin prerë dru bredhi me leje, vura re se ishte dhe ky emër. Fillova të studjoj se kush ishte Todi K. Nga studimi më doli se ai kishte qenë burgosur si agjent i U.D.B. Fshatarët më thanë se Todi nuk kishte hyrë në kooperativë e se jetonte vetëm me punën e së shoqes. Fshati e njëjtte për njeri dinak dhe tinzar. Bile, ai kishte hapur fjalë se do të shpërngulej që aty dhe do të zinte punë në qytet. Të gjitha këto flisnin në favor të dyshimeve të mia, po nuk kishte asnjë argument, fakt konkret lidhur me çështjen për të cilën kisha ardhur. Puna duhej hetuar më afër. Prandaj dërgova nipin e mjeshtrit plak në shtëpinë e Tudit. Ai shkoi dhe, sipas porosisë që i dhashë, i kërkoi lopatën e xha Sadikut.

— Ik, more djalë, se e ke gabim! Ç'më duhet mua lopata e furrës.

Nyja e enigmës sa vinte e po zgjidhej. Për këtë ndihmuan vetë fshatarët. Unë u bëra i shtëpisë në fshat. Njerëzit e thjeshtë kanë nuhatje të çuditshme. Ata vetë vinin e më jepnin të dhëna të ndryshme. Një fshatar erdhi e më tha se në gardhin, që rrethonte shtëpinë e Todit, kishte parë gjurmë boje të bardhë. Dhe me të vërtetë, unë i pashë vetë me sytë e mi njollat e bardha të bojës. Një tjetër më tregoi me hollësi se para disa ditësh i kishte zënë syri, duke u kthyer për në shtëpi, Todin të lagur në gjysmën e trupit, sado që atë ditë nuk kishte rënë shi. Interesant se si syrit të popullit nuk i shpëton asgjë; ai i mban në mbikqyrje të vazhdueshme të gjithë ata që kanë shpërdoruar njëherë ose duan të shpërdorjnë besimin e tij.

Tani çdo gjë u bë e qartë. Shkuam në shtëpinë e Todi K. dhe trokitëm në portë. Trokitëm disa herë, po të zotët e shtëpisë për një kohë nuk u ndjenë të gjallë. Vetëm kur trokitëm fort e thirrëm atëhere doli e shoqja.

— Todin doni? — pyeti ajo, duke u munduar të na vononte.

— Todin duam, po hapu — i tha njëri nga fshatarët dhe desh të futet brenda, po gruaja dinake i doli përpara...

— Ai po hidhet nga muri, prapa shtëpisë...

— Mos u mërzit se ka kush e pret dhe andej — tha Ganiu, një nga shokët tanë dhe hyri në korridor. Gruaja u mundua prapë të luajë rolin e saj, po më kot. **Todin e kapëm** në dhomën e vogël, tek po digjte në zjarr dokumentat e fundit...

Dhe bashkë me të, kapëm edhe agjentin e huaj, i cili me ndihmën e Todit kishte përgatitur varkën për t'u hedhur matanë kufirit...

7

Kur shkova e i raportova shefit, ai u ngrit në këmbë dhe më rroku në qafë. Ne qëndronim përballë njëri-tjetrit dhe sytë na ndrisnin nga një gëzim i përmbajtur.

— Të lumtë! — tha ai dhe, si heshti një hop, shtoi: — Ju lumtë të gjithëve, i lumtë atij punëtorit, u lumtë sharrxhinjve, grave, fshtarëve dhe, tok me ta edhe ty që e udhëhoqe këtë aksion të vështirë. Çështja, siç e di ka rëndësi të madhe. Todi K. bashkë me Ethem R. ishin agjentë të rregullt të UDB-së dhe kërkoheshin nga qendra e tyre me këmbëngulje. Operacioni i tyre pra, dështoi, plotësisht.

Kur u ndava nga shefi, shkova të flija. Gjithë ajo tendosje nervore, ai shqetësim i vazhdueshëm, më kishte lodhur. Dhe këtë e ndjeja, tani kur të gjitha telashet i kisha lënë prapa.

Kjo është detyra jonë, që duket sikur kryhet nga një rreth i mbyllur njerëzish, po që në të vërtetë është vepër e të gjithëve, e vetë popullit.

HAPAT E TIJ

Ata dolën bashkë prej repartit dhe morën rrugën për nga lumi. Mbasi kaluan urën me dërrasa dhe ranë në Fushën e Drerit, Ahmeti e shpejtoi hapin. Ai e dinte se mëngjezeve në xhade kalonin maqinat e fermës. Po ushtari që e shoqëronte vazhdoi të ecë me hapin e tij të parë. Ahmeti e vuri re këtë gjë, mbasi në mes tyre, dalëngadalë u krijua një distancë e madhe dhe atij nuk i erdhi mirë. S'është gjë e hijshme për dy ushtarakë të një reparti të ecnin larg nga njëri tjetri, qoftë edhe vetëm në mes të fushës, siç ishin ata të dy. Po Ahmeti e kishte të vështirë ta urdhëronte përsëri ushtarin. Më mirë ta coptonte me dhëmbë thuprën që mbante në dorë, se sa t'i tërhiqte atij vërejtjen sërish. Fundja ai pas tij po vinte. Kështu, ata kaluan gjithë Fushën e Drerit.

Kur arritën në xhade, Ahmeti e hodhi thuprën në hendek dhe filloi të rregullohet: shkundi rrobat, kopsiti një pullë të xhaketës, nxori leckën nga xhepi dhe fshiu çizmet. Pastaj, me vetullat mbledhur, u kthye nga vartësi. Ushtari, atë kohë sapo qe ulur mbi një gur kilometrik, disa hapa larg tij

dhe rrinte lirshëm, siç rri zakonisht njeriu në udhëtim e sipër. Komçet e xhaketës i kishte lënë zbërthyer, bustinën e kishte hequr nga koka dhe e kishte varur në rrip të uniformës. Dukej i tërhequr në mendime, me një pamje të lodhur.

Oficeri u kollit disa herë me të fortë. Ushtar Agroni u ngrit në këmbë dhe u largua nga guri. Vështrimi i tij i hutuar, në vend që të kthehej nga oficeri, u drejtua nga reparti që shtrihej përtej lumit. Kësaj here, Ahmeti, e quajti të arësyeshme të urdhëronte:

— Kopsitu!

Zëri i prerë i Ahmetit tingëlloi qortonjës. Ushtari nuk u kopsit menjëherë, po shkundi më parë rrobat dhe u ul të shtrëngojë lidhësen e njërës këpucë. Fytyrën e eprorit e mbuloi hija, vetullat pothuajse iu bashkuan. Përsëri urdhëri nuk iu zbatua si duhet. Zakonisht Ahmeti fjalët i kishte të pakta. Gjithë marrëdhënjet e tij me ushtarët ishin përmbledhur në urdhërat. Kolegët e tij, thoshin si me shaka, se Ahmeti e tepëronte aq shumë në këtë gjë, sa nuk dinte të fliste me vartësit dhe do të kish më shumë qejf të fliste me veten, se sa të shtrohej e të bisedonte shoqërisht me ta. Komandanti, e në mënyrë të veçantë komisari i repartit, sado që e çmonin për serjozitetin dhe këmbënguljen në punë, e kritikonin që mbante largësi me ushtarët, i thoshin që të mos kishte «frikë» prej tyre, bile e këshillonin që të mësonte nga ta. Ahmeti, nuk e kundërshtonte këtë, dhe në radhë të parë, sepse kjo do të shkelte principet e tij, po përbrenda ndjente se nuk ishte i një mendje. Ai kishte detyrën e tij, ushtarët kishin të tyren. Po të trazohej me ta,

siç thuhej, do të ngatërroheshin detyrat, do të zhdukej ai kufi që përcaktonte rregullorja e do të bëheshin të gjithë si këmbët e dhisë. Atëhere, pse t'i nxirrte telashe vetes në rrugë të tjera, kur në rregullore çdo gjë ishte thënë qartë. Në rregullore, bie fjala, thuhej se për shkelje urdhëri, oficeri kishte të drejtë të merrte masa ndaj vartësit. Sigurisht, arësytonte pastaj Ahmeti, masa varej nga lloji i gabimit apo i fajit. Dhe këtë gjë, ai, si oficer me përvojë, dinte ta përcaktonte. Kështu Ahmeti kishte dënuar ushtar Agronin me tri ditë arrest, i bindur se kishte vepruar drejt. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe: Komanda kishte dhënë urdhër të prerë që ushtarët të mos hynin në fjetore gjatë ditës; për më tepër, edhe një ushtar tjetër ishte paralajmëruar për shkelje urdhëri dhe tani, siç mendoj Ahmeti, duhej marrë një masë që të vinin mend të tjerët. Në këtë mënyrë kishte menduar Ahmeti para dy ditësh, kur kishte qenë oficer dite. Ai kishte hyrë në fjetore dhe kishte gjetur shtrirë, përmbys në krevat, ushtar Agronin. Nuk e kishte vënë re se ç'po bënte, po menjëherë e kishte tundur për supesh dhe e kishte pyetur në se ishte i sëmurë. Ushtari nuk i qe përgjegjur në kohë, bile qe ngritur më nge, pa marrë parasysh se para kujt ndodhej dhe kishte bërë të dalë, me një mospërfillje të çuditshme, thua se gjithë këshillat e komandës të ishin të kota. Veç kësaj, Ahmetin e kishte nevrikosur dhe një copë letër që mbante ushtari në dorë. Kur kishte filluar t'i fliste, ai s'kishte pritur të mbaronte, po ishte larguar pa pritur, duke lënë eprorin vetëm në fjetore. Oficeri nuk e kishte bërë çështje atë kohë, po më pas, kur ishte mbledhur toga e Agronit, kishte vajtur atje, e kishte qortuar para shokëve dhe e kishte dënuar.

Po, e kishte dënuar. Ushtar Agroni nuk kishte folur fare, kishte ulur sytë dhe ishte nisur të zbatonte urdhërin.

Kur kishte shkuar te oficeri i rojes të nesërmen dhe i kishte treguar pse kishte vajtur, ai kishte buqeshur. Pastaj, oficeri e kishte pyetur:

— Je anëtar i Bashkimit të rinisë ti?

— Si urdhëron, jam!

— Atëhere, thuaja shokëve atë që bëre dhe le re ta gjykojnë ata.

Ushtar Agroni ishte kthyer pastaj te oficer Ahmeti dhe i kishte thënë ato fjalë që kishte dëgjuar nga oficeri i rojes. Ahmetit nuk i kish ardhur hiç mirë për mënyrën se si kishte vepruar kolegu i tij, po megjithatë nuk e kishte dhënë veten para ushtarit. «Pse, nuk e di unë, organizatën e rinisë!», kishte menduar dhe aty për aty kishte urdhëruar për të dytën herë, duke u munduar të mbajë gjakftohësinë:

— Shko, kryeje dënimin në repartin 3200.

Për çudi dhe Agroni kish ruajtur gjakftohësinë. Ai kishte dëgjuar për natyrën e prerë të oficer Ahmetit. E kishte nderuar dhe ishte nisur në repartin fqinj, që ndodhej përtej lumit. Po dhe atje nuk e kishin mbajtur. Kur ishte kthyer, i kishte raportuar:

— Shoku komandant, urdhëri juaj nuk u zbatua! Oficeri i rojes i repartit 3200 më porositi t'ju them se edhe në repartin e tyre vendi i arrestit është hequr.

Ushtar Agroni nuk i kishte treguar oficer Ahmetit se oficeri i rojes atje kishte qeshur me të madhe dhe i kishte thënë: «Thuaj oficer Ahmetit ta shohë urdhërin me syrin politik!»

Agroni kishte ndenjtur pastaj gatitu para epro-
rit, pa ditur se ç'udhë do të merrte çështja e tij. Po
dhe Ahmeti ishte gjendur pa prituri në hall. Asnjë-
herë gjatë kohës që shërbente nuk i kishte ndodhur
një gjë e tillë. Të dënonte një ushtar në bazë të
rregullores dhe të mos çohet urdhëri në vend! Ai
dinte që kohët e fundit që biseduar të hiqeshin
vendarrestët, mbasi s'ishte nevoja të përdroreshin
kur ndërjegjja e ushtarëve ishte rritur, po kjo nuk
përjashtonte që në raste të rralla, të merresh dhe
ndonjë masë e tillë për t'iu bërë mësim të tjerëve.

Pas atyre që dëgjoi, Ahmeti nuk kishte guxuar
ta shihte vartësin në sy. Shikimi i ushtarit, sepse i
dukej tallës. Atëhere, si t'ja bënte? Ta anulonte ur-
dhërin, kur e kishte marrë vesh i gjithë reparti? Apo
të pohonte se kishte dhënë një urdhër pa vend?

Ai nuk e kishte quajtur të arësyeshme të skja-
rohej me ushtarin dhe aty për aty e kishte gjetur me
vend të urdhëronte:

— Mirë, do të vish me mua në qytet!

Ushtar Agroni kishte ngritur supet, pa kuptuar
tani se ç'po ndodhte në mes tyre. Dësh njëherë të
shpjegohej, t'i thoshte që ta falte për atë që kishte
bërë, po oficeri kishte shtuar me një nervozizëm
të çuditshëm: — Do ta skjarojmë atje çështjen.
Shko, tani!

Pa dashur, Ahmeti kishte ngritur sytë dhe ush-
tari ishte munduar të lexojë në vështrimin e tij:
komandanti ishte prekur në sedër!

Dhe ja, tani, për faj të tij ata ishin nisur për
në qytet. Ushtar Agronit i vinte turp, po i vinte dhe
inat. Prandaj, kur ai e urdhëroi të kopsitej, atij nuk
i erdhi hiç mirë. Dësh njëherë t'i thoshte:

«Shoku komandant, e dini si është puna...»

Dhe do ta bënte këtë, po të mos i qe mbledhur ai lëmshi në grykë që i lidhi gjuhën. Prandaj, në vend që të shpjegohej, ai zuri të kopsitej e të rregullojë uniformën.

Ahmeti kishte dalë në mes të xhadesë dhe me dorën strehë mbi ballë shikonte nga rruga që humbiste në fushën e pafund. Koha kalonte dhe as një makinë nuk lëvizte. Ushtari rrinte pak mënjane, pa ditur ç'të bënte, të ulej prapë, apo të qëndronte në këmbë. Ishte dhe i lodhur, pasi gjithë natën pothuaj kishte bërë gjumë të keq. Po sikur ta qorton-te përsëri oficeri, ç'i mbetej atëhere?

Ushtari ndejti në këmbë gjersa erdhi një makinë. Ndërkaq Ahmeti kishte ngritur dorën dhe shoferi, kur i kishte parë që ishin ushtarakë, e kishte ndaluar dhe ata, pa fjalë, kishin hipur lart. Vendet përpara nuk qenë të lira, kurse karrocERIA e zbuluar e kamionit ishte fare bosh.

Ata kishin zënë nga një cep në karroceri, duke mbajtur një dorë në spondet e tjetrën në kapele. Rruga ishte e pashtuar, tërë gropa dhe kjo e shoshiste makinën, duke e lëkundur me vrull, sa andej-këndej. Era u binte përballë dhe dy udhëtarët në karroceri, sado që mbroheshin, duke ulur kokën pas kabinës, prapë ajo i rrihte me forcë. Për pak, era desh ja mori bustinën Agronit, por Ahmeti e kapi e i bëri me shenjë që ta mbante në dorë.

Udhëtimi që në fillim dukej i vështirë. Bile kur lanë më të djathtë Fushën e Drerit, shoferi ja shkeli gazet. Kamjoni tani ecte përpara me të katra, ndërsa lëkundjet bëheshin aq të forta, sa ndodhte që komandanti me ushtarin kohë më kohë gjendeshin fare pranë njëri tjetrit. Po kjo zgjaste vetëm një hop, sepse ata, sapo merrnin veten, me-

njëherë ktheheshin atje ku ishin, duke u munduar të kapen fort, herë pas dërrasave të kabinës, herë pas spondeve.

Një herë, Ahmeti u përplas keq mbi ushtarin. Kjo e shqetësoi komandantin dhe aty për aty e vështrroi vartësin me kujdes se mos kishte pësuar gjëkafshë. Agroni e kuptoi dhe buzëqeshi lehtë. Pas kësaj, Ahmeti u largua rishtas për në vendin e tij, po nuk kaloi shumë dhe erdhi një lëkundje tjetër e madhe, aqë sa, Agroni u ndodh në gjoksin e oficerit. Ushtari kujtoi se e goditi rëndë komandantin dhe desh të largohet në çast, po s'arriti dot. Lëkundje të tjera pasuan njëra tjetrën me vrull të madh, sa ushtari mbeti një kohë pranë epërorit. Ata rrinin ngjitur, bile komandanti me një dorë mbahej te spondi, me tjetrën shtrëngonte për supash ushtarin. Agroni, i hutuar, nuk e shikonte dorën e tij, po e ndjente se ajo ishte dora e komandantit. Për lherë të parë, iu bë sikur po shpërndahej ajo mjegull që ishte nderë në mes tyre. Pasi rreshtën ca lëkundjet, Ahmeti u ngrit më këmbë dhe e ndihmoi Agronin të vejë në vendin e parë. Ushtari e kuptoi qëllimin e komandantit dhe ashtu vetiu një e përqethur e lehtë ja purpuli shtatin. Ai nuk arriti ta marrë veten, se ndodhi që ata u bashkuan sërish. Bile kësaj herë, ata qëndruan gjatë afër njëri tjetrit. Tani Ahmeti e Agroni sikur u mësuan pranë shoshoqit. Rrinin ashtu pranë e pranë, duke ndjerë frymëmarjen e butë të njëri tjetrit dhe u vinte çudi, sepse, asnjëri nuk i kishte qëlluar ta shikonte shokun nga kaqë afër. Zakonisht, ata shiheshin nëpër repart, në klasë, në poligon, në mensë. Po edhe kur kishin të bënë bashkë, ushtar Agroni shkonte e paraqitej, duke që-

ndruar disa hapa larg. Në këto raste, Ahmeti kishte mundësi t'i shihte mirë fytyrat e ushtarëve, po ai shpesh herë e kishte mendjen tek urdhërat që jepte dhe raportimet që i bënin. Kurse tani, e kishte ushtarin fare pranë vetes, i dëgjonte frymëmarrjen, e vështronte nga afër. Me trupin e lartë e shpatullat e gjera ai gati sa nuk e mbulonte Agronin e hollë e shtatmesatar që dukej sikur kishte gjetur qetësi pranë tij. Ai e kundronte nga afër vartësin dhe provonte një përshtypje të çuditshme. Kishte gati një vit e ca që e njihte ushtar Agronin, kurse tek e sodiste ashtu, i dukej një fytyrë krejt e re. Po, po, e re, me ato tipare të buta, me atë vështrim të druajtur e me ato rrudha të lehta, faqeve të porsa dirsura. Nga larg, të gjithë ushtarët duken njësoj, veshur me uniformën e gjelbër, po kur i shikon për së afërmi s'janë ashtu, dallojnë mirë nga njeri tjetri. Kjo gjë nuk i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend Ahmetit me një forcë të tillë shqetësuese si sot. Ndofta e kishte fajin kamioni që herë e nanuriste, herë e lëkundte. Megjithatë, po t'i thosh dikush në mëngjez se do të ngjante kjo që po ndodhte, ai do të qeshte, do t'i dukej bile si një fyerje për dinjitetin ushtarak. Po tani, ai arësyetonte i qetë, për më tepër nisi të mendojë pak si ndryshe për detyrën e tij.

Lëkundjet sa vinin rralloheshin, po Ahmeti dhe Agroni sikur kishin harruar të ktheheshin në vendet e para. Ushtari rrinte me sy të kapsallitur, i shqetësuar pak se mos i rëndohej komandantit, kurse komandantin e kishin mbuluar mendimet dhe, pa dashur, i faniteshin në kokë përfytyrime të ndryshme. I bëhej sikur ky ishte një udhëtim, gati si në kohë lufte, një udhëtim drejt frontit me

ushtarët e tij. Sipër kamionit tani nuk ishte vetëm Agroni, po dhe ushtarë të tjerë. Nga larg, vinin gjëmimet e para të luftës. Agroni i gjendej pranë, me helmetën në kokë dhe pushkën në mes gjunjëve. Të tjerë, ashtu si Agroni, qëndronin në të dy anët e karrocërisë, me nofullat shtrënguar, me sytë shigjetë, të gatshëm për t'iu sulur armikut, nën komandën e tij. Ata ishin gati të jepnin jetën për komandantin e tyre, po dhe ai po ta lypte nevoja, nuk do ta kursente për asnjërin prej tyre. Sepse oficer Ahmeti e di mirë se ata të gjithë bashkë janë vëllezër, vëllezër klase. Detyra që kryente secili nuk e pengonte aspak të kuptohen e të bashkohen kundër armikut, s'ka gjë që njeri është ushtar e tjetri oficer. Përfytyrimi, sa vinte e bëhej më i gjallë. Maqina vijonte rrugën e saj. Sytë e oficerit mbetën një çast te ushtari. Gjithë pamja e tij tregonte se ai e ndjente veten të qetë pranë komandantit. Kjo e preku padashur Ahmetin dhe mendime qortuese i buluan në kokë. «E kujt i duhet kjo distancë?» «Mua?, jo,» — ja bëri oficeri me vete — «Po as kolegëve të mi, as Paskalit, as Hasanit, asnjërit... Po kujt i duhet?» Ahmeti u mendua pak dhe pastaj tha me vete: «Armikut! Po, po, atij i duhet. Ai kërkon të na shohë të ndarë nga ushtarët, të luaj për njëri tjetrin»...

Pas këtij arësytimi, komandanti për herë të parë, filloi ta gjykojë dënimin që i kish dhënë Agronit. «Në qoftë se do ta kisha kuptuar kështu më parë — arësytetoi me vete — nuk do ta kisha dënuar!» Po tani ai e kishte dënuar, bile për këtë shkak kishin marrë dhe rrugën. Ahmeti ra në një hall të madh. Të kthehej prapsht, me siguri do të bëhej qesharak. Vetë ushtar Agroni do të habitej, ndofta

do të qeshte, e pastaj do t'ja tregonte gjithë sho-
këve. Do ta mernin vesh kolegët. Do të krijohej
patjetër një situatë e ngatërruar. «Si mund të luhej
kështu me autoritetin — mendonte Ahmeti — që
është gjë e vyer në ushtri!» Po atëhere, ç'mund të
bënte? Oficeri nuk arriti t'u japë udhë arësyeti-
meve të veta. Atë kohë maqina zuri të zbresë një
të tatëpjetë me vrull dhe ai u shkëput mendimesh.
Kapi Agronin për dore dhe u mbajt fort. Kur lë-
kundjet u paksuan, komandanti i hoqi dorën prej
tij dhe për herë të parë e pyeti:

— Ç'ke kështu që je i nxehtë?

Ushtari nuk e kuptoi menjëherë pyetjen. Dëgjoi
vetëm disa tinguj të zgjatur që i shungulluan në
vesh.

— Urdhëroni?

— Thash, je i nxehtë — ja bëri Ahmeti, duke
i thirrur afër veshit — ç'ke?

— Jam ftohur pak, shoku komandant!

Agroni, nuk i tha të vërtetën, po dhe për t'u
shpjeguar nuk kishte si të shpjegohesh atë çast.
Nuk ishte rasti t'i thosh se kishte ndenjtur pa
gjumë gjithë natën, për një arësye që e dinte ve-
tëm ai. Pastaj dhe Agroni ishte njeri me sedër dhe
me që punët ishin ngatërruar ashtu, ai nuk desh
të ndillte mëshirën e eprorit.

— Eja, këtu! — thirri Ahmeti — Eja, mos të
zërë era atje.

Ahmeti u tërhoq pak më tutje dhe i liroi ven-
din ushtarit. Agroni lëvizi menjëherë, sikur të
zbatonte një urdhër, pa menduar fare për gjestin
e komandantit. Vetëm kur ndjeu se era aty ku po
rrinte, nuk para e trazonte, atëhere e kuptoi që-
llimin e asaj që kishte bërë eprori i tij. Dhe i erdhi

mirë, shumë mirë. Zemra filloi t'i rrahë me vrell. Iu zgjua një ndjenjë e ëmbël, ndonëse pak kontraktore. Një ndjenjë si ajo që provon njeriu, kur takohet larg shtëpisë me një të afërm të tij, me të cilin ka qënë zemëruar.

Kur maqina doli në rrugën e shtruar, ata u larguan nga njëri-tjetri dhe secili, ashtu si në fillim, zuri një cep të karrocërisë. Për pak, do të arriheshin në qytet, po komandanti akoma nuk kishte vendosur se ç'do të bënte me ushtarin. Përsëri iu sulën mendimet. Si do t'i bëhej hallit? Ahmeti ktheu sytë nga ai. Fytyra e Agronit ndillte qetësi e besim. Komandantin kjo gjë e turbulloi pak. Ahmeti u çua në këmbë dhe atë çast ndjeu sikur u lehtësua nga pesha e mendimeve. Pas tij, u ngrit dhe Agroni. Ushtari u mat disa herë të fliste, pastaj me një buzëqeshje të zbehtë, tha:

— Po arrijmë, shoku komandant!

Oficeri nuk u përgjegj, po tundi kokën, ndërsa sytë ja mbuluan përgjysmë qepallat.

Kur maqina kaloi para një kantieri ndërtimi, Agroni anoi pak kokën nga eprori dhe foli prapë.

— Mbaroi edhe kjo uzinë, shoku komandant! Ta kisha pranë shtëpisë, do të hyja këtu, kur të lirohesh.

Ahmeti u zu ngushtë. Ishte e dyta herë që ushtari po i fliste dhe atij nuk i qe bërë t'i përgjegjej.

— Po ti ç'punë bën?

— Jam tornitor, shoku komandant!

Ahmeti kishte dëgjuar që ai ishte tornitor, po prapë e pyeti, se mos atij i vinte mendja që ai po mendonte për të. Po ai për të mendonte, një

mendim i rrihte si çekan në kokë: si t'ja bënte me urdhërin, me dënimin që kishte dhënë? Mirë me vete dinte të arësytonte, po atij si do t'ja thoshte? S'është kollaj t'ja thuash ushtarit një gabim a një faj tëndin si epror. Po pasojat e tjera? Çdo të thoshin ushtarët? Shokët, me siguri, shkak donin për të qeshur.

Komisarit të repartit me këtë rast do t'i shtohet edhe një argument më shumë, për kritikën që i kishte bërë në mbledhje me oficerat. Ata nuk e merrnin me mend se ç'kishte ndodhur me të gjatë rrugës. Vërtet shumë shokë të tij e kanë metodë pune afrimin me ushtarët, por për Ahmetin kjo nuk është gjë aq e kollajtë.

Maqina ndaloi para agjensisë së transportit dhe oficeri me ushtarin zbritën.

Ahmeti nuk di të thotë në se e përshëndeti apo jo shoferin, a e rregulloi uniformën, siç bënte zakonisht, sa herë hynte në qytet. As nuk i kujtohet se çfarë i tha ushtarit, kur zbritën dhe filluan të ecin nëpër trotuarin, anës ndërtesave të larta.

Ata bënë një copë rrugë në heshtje. Dukej sikur sodisnin qytetin e përtërirë në atë ditë pranvere, po në të vërtetë të dy ishin të shqetësuar. Ja, tani bulevardi do të mbaronte dhe do të gjendeshin në kryqëzimin e rrugëve. Atje do të merrej vesh nga do të shkonin. Do të vinin në garnizon apo në ndonjë vend tjetër. Këtë nuk e dinte as Ahmeti vetë. Ata ecnin me hap të lirë nëpër trotuar dhe dëgjonin zhurmën e këpucëve të tyre të rënda, thua se nuk i tërhiqte asgjë për-qark.

— Shoku komandant, ka mundësi t'i bëj një telegram shtëpisë?

Zëri i Agronit doli pak i zvargur, po në veshin e komandantit gjëmoi si këmbanë. Ai pandehte se mos e pyeste: «Ku do të vemi?» dhe, kur ushtari i kërkoi lejë të shkonte deri në postelegrafë, ai ndjeu një lehtësim të madh dhe menjëherë e miratoi me kokë.

Ushtari mori të ngjitë të përpjetën e bregores, ku gjendej postelegrafa, kurse Ahmeti vajti u ul mbi një stol në të hyrë të lulishtes së madhe të qytetit. Ndejti aty dhe priti me shpresë se, ndofta, vonesa e tij do ta ndihmonte të merrte një vendim të urtë. Ç'kishte ndodhur ashtu: si ishin nisur dhe si kishin arritur! Qenë nisur gati të zemëruar, duke ecur nëpër fushën e Drerit, njëri pas tjetrit dhe qenë gjendur, papritur e pakujtuar, shokë. Po, shokë! Se vetëm një shok mund të presë shokun, ashtu si po e priste ai ushtarin e tij.

Agroni e gjeti komandantin tek rrinte në stol, i menduar, me sytë për tokë. Ushtari kishte ardhur pothuaj me vrap. Nuk dësh ta vononte komandantin. Kush e di se ç'punë e prisnin. Po Ahmeti e pa dhe nuk foli asgjë. Vetëm lëvizi më tutje dhe i bëri vend ushtarit.

Ata rrinin tani të dy ulur në stol. Nga rruga vinte zhurma e maqinave, ndiheshin hapat e njerëzve, zërat e fëmijëve. Të dy ushtarakët qëndronin në heshtje, sikur t'u kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi. Asnjëri nuk fliste. Ngelën kështu një copë herë. Pastaj u dëgjua që ra ora e qytetit.

Agroni ngriti kokën të shihte orën, sepse kujtoi se ra aty afër, po sahati ishte larg, prapa

pishave, atje tej, në mes ndërtesave të larta. Desh të thoshte njëherë: «Mos u vonuam, shoku komandant!». Po mënyra se si rrinte ai, e bëri të stepet. Vështrimi i tij rrëfente se atë diçka e mundonte.

— Si i ke nga shtëpia? — pyeti oficeri.

— Kam nënën sëmure, shoku komandant!

Ahmeti u kthye nga ushtari.

— Ç'ka nëna?

Agroni ngriti kokën dhe u përpoq ta shohë eprorin në sy, sepse nuk desh kurrsesi t'i ndillte mëshirë. Po komandanti i mbante sytë ulur...

— Vëllai më shkruante se dyshojnë, shoku komandant...

— Për çfarë dyshojnë?

— Dyshojnë për një sëmundje të keqe...

Ahmetit i vajti mendja tek skena e ditës së djeshme, kur ushtar Agroni kishte hyrë në fjetore dhe lexonte letrën e vëllait, fshehurazi shokëve. Pastaj solli ndër mend sjelljen e tij. Ç'kishte bërë ai si epror? e kishte vënë re me kujdes se ç'po bënte ushtari? E kishte pyetur se ç'e kishte shtyrë të hynte në fjetore pa lejë! Jo! Ai kishte thirrur, e kishte qortuar, vetëm kaq, e nga ky çast kishte filluar gjithë kjo peripeci...

— Po telegramin, pse e dërgove?

Agronit nuk i vinte mirë t'i përgjigjej kësaj pyetje. Sytë i nguli tek një trëndafil i bardhë që sapo kishte çelur karshi stolit, ku ishin ulur.

E ç'ti thoshte komandantit? Ata ishin nisur për tjetër gjë nga reparti. Ushtar Agroni nuk donte në asnjë mënyrë t'i ngatërronte detyrat me çështje personale, aq më tepër në rrethanat që ishin krijuar. Pra, nuk kishte ç'ti thosh koman-

dantit. Shikonte trandafilin e bardhë, me mendjen gjetkë dhe nuk përgjegjej.

— Fol, mor djalë, pse e dërgove telegramin?

— Po si të them, shoku komandant... e dërgova se ashtu është puna...

— Si është puna?

— Më kërkonte vëllai i madh...

— Për çfarë të kërkonte?

.....

— Më dëgjon, ç'të them: si është puna?

— Po ja... Më thoshte se mos veja për të parë nënën, prandaj i bëra telegram.

— E çfarë i shkrove?

— I thashë nuk mund të vij, se më kanë ngarkuar me një detyrë...

Agroni nxorri shaminë nga xhepi dhe fshiu ballin.

Ahmeti u ngrit nga stoli dhe si të shqiptonte një urdhër, tha:

— Shko, prapësoje telegramin!

— S'ka gjë, shoku komandant!

— Shko, po të them.

Ahmeti qëndronte në këmbë. Agroni nga hutimi rrinte akoma ulur.

— E pat kjo punë, shoku komandant!

— Çou, dëgjo urdhërin...

Ushtari nuk dinte si ta kundërshtonte më epororin. U ngrit dhe me vrap shkoi përsëri në postelegrafë.

Kur u kthye e gjeti komandantin që priste në trotuar.

— Ju kishit një punë në garnizon... — tha ushtari.

— Kisha punë, po tani nuk kam më! ja bëri oficer Ahmeti.

— Pse, shoku komandant, shkojmë?
— Atë e di unë. Po hajde ecim se mos gjejmë ndonjë makinë...

Ahmeti mori të eci, kurse Agroni qëndroi në vend i kapur nga një ngashërim i papritur. Ai ktheu kokën dhe iu afrua ushtarit:

— Ç'ke Agron?
— Të më falni, shoku komandant, ju mundova kot gjer këtu!

— Kot, the? S'ishte kot, jo. Të dy mësuam sot, po më shumë mësova unë. Hajde tani, se jemi në mes të rrugës. Kemi kohë të bisedojmë.

Ata dolën në rrugën nga kishin ardhur dhe zunë të ecnin krah njëri tjetrit. Kur iu afrua agjensisë së transportit, Ahmeti ngadalësoi hapat e tha:

— Ti rri këtu se mos gjen ndonjë makinë për shtëpi. Unë po dal te ura të ik për në repart me ato të fermës.

Agroni nuk mundi të thotë asnjë fjalë, se Ahmeti i dha dorën dhe për herë të parë e mori në grykë.

— Nënës të shkuara. Ju bëj të fala të gjithëve nga unë.

Komandanti u shkëput nga ushtari i tij dhe zuri të ecë më tej. Agroni mbeti aty në mes të bulevardit, gati i shtangur, me një lëmsh në gjoks, pa qenë në gjendje të lëvizë as para, as prapa. Rrinte ashtu dhe, sado që jeta lëvizte përqark me zhurmë, ai i dallonte hapat e tij. Ushtar Agroni i njihte mirë ato hapa. Ato binin në tokë me një ritëm të rregullt e me ngulm. Hapa të tillë, që jehonin me forcë e vendosmëri, mund të ishin vetëm hapa të komandant Ahmetit.

NË MES TË TË GJALLËVE

Nënës Katerina Bego

Udhëtonim me kamionin e ekspeditës sonë nga malësia për në qytet. Isha unë, inxhinier Gaqua dhe Hasani, shoferi. Ata të dy rrinin përpara, kurse unë, si më i ri, kisha zënë vend prapa në karrocëri. Rrija gjysëm i shtrirë, sipër ca thasëve të mbushur, që kishte hedhur aty magazinieri ynë. Nuk di, po këtë udhëtim e kisha marrë pa qejf. Kjo vinte, ndofta, nga që kohët e fundit kisha udhëtuar shumë dhe rruga që do të bënim ishte e largët. Pastaj, isha i detyruar të udhëtoja pothuajse vetëm, në një ditë të freskët vjeshte, me mendjen gjithnjë te puna që kisha lënë përgjysëm.

Ishim nisur që pagdhirë dhe dielli na zuri në udhë e sipër. Rruga kalonte nëpër shtigje malesh e pyjesh, zbriste në fusha e lugina, që unë i kisha përshkuar kush e di sa herë. I njihja këto vende mirë, i dija me emër grykat e qafat, kisha qëndruar pothuaj në çdo fshat e nuk më bënin më përshlyetje pamjet, që dukeshin dhe zhdukeshin para

syve të mi. Maqina ecte me të shpejtë dhe rruga humbiste nën rrota. Unë, s'kisha ç'të bëja, dhe kohë pas kohe shikoja nga dritarja e pasme e kabines. Shikoja herë hundën e gjelbër të maqinës, që çante përpara, herë Hasanin tek shtërngonte fort timonin, me një bisht cigareje në këndin e buzëve; herë inxhinier Gaqon kokëulur, që lexonte një libër të trashë. Po papritur ndodhte që harrohesha dhe, kur përmendesha, më dülte përpara xhamit vetja. Atëhere shikoja fytyrën time të lodhur e të vrrarë nga pagjumësia, mustaqet e holla, kasketën e zezë të rrasur deri në vetullat.

Hasani e ngiste maqinën me të madhe dhe këtë e ndjeja nga era që më fishkullonte egër në vesh. Para xhamit uleshin e ngriheshin duar fshatarësh, që prisnin në rrugë dhe fill pas tyre dukej kurrizi i dorës stërmadhe të Hasanit. Kjo do të thoshte se maqina jonë nuk ndalonte gjëkund. Atëhere fillova të mërzitem. Më vinte t'i thërrisja Hasanit që ta ndalonte maqinën dhe të merrte ndonjë udhëtar. Të kisha të paktën një shok rrruge. Më siguri, nuk do ta ndjeja aqë të gjatë rrugën. Po me sa shihej, rasti më kishte dënuar atë ditë të udhëtoja fill vetëm. Hasani, as që kishte ndër mend të qëndronte e të merrte njeri. Si ai dhe inxhinieri donin të arrinin sa më parë në qytet. Inxhinier Gaqua kishte një mbledhje të rëndësishme dhe kërkonte patjetër të arrinte në kohë. Hasani, por sa që fejuar dhe kishte mbushur muajin këtyre maleve, pa zbritur në fushë. Kështu që unë pak nga pak e humba shpresën. Atëhere, ç'të bëja? Ndava mendje të fle dhe mbështeta kokën tek thasët që kisha përçark. Nuk di sa fjeta, veç kur u

zgjova papritur. Ndjeva frenat e forta që stopuan rrotat e pasme dhe trupi më shkoi i tëri përpara. Hapa menjëherë sytë dhe u ngrita përgjysëm. Rruga gjarpëronte para meje e shkretë, bri një kodre shkëmbore. Dëgjova të përplasjet vetëm ëdera e kabinës. Hasani i zbriti dhe mori nga prapa. Pashë që tundi dorën e djathtë lart dhe pastaj dëgjova që thirri:

— Hajde, Teto, hajde!

Padashur, u bëra kureshtar. U çova flakërim në këmbë dhe vështrova rrugën që kishim lënë prapa. Një fshatar me bustinë ushtarake në kokë dhe me një bohçe në duar vinte në drejtim tonë. Pas tij ecte nxitimthi një grua, që s'ja shquaja dot fytyrën. Të dy të panjohurit u afruan dhe i dhanë dorën Hasanit. Hasani buzëqeshte tërë përzemërsi, tamam si ai i zoti i shtëpisë që del e i pret miqtë te pragu i derës. Gruaja ishte një plakë e imët nga fytyra dhe trupi, me shtat çuditërisht të drejtë, veshur si qytetare, me shami të zezë hedhur kokës. Ai, një burrë i ri, i gjatë, me rroba shajaku, me një palë mustaqe të hijshme, që të kuitonte komisarët e luftës. Unë rrija më këmbë, sipër në karroceri, dhe vështroja që andej i heshur. Fshatari, që mezi merrte frymë nga të rendurit, tha:

— Do e marrësh një çikë, o shoku shofer, Tetë Gjenën gjer në qytet?

Hasani, në vend që t'i përgjigjej, nxori paqetën dhe ja zgjati përpara. I panjohuri u hutua. Shoferi ktheu kokën nga unë dhe më shkeli synë:

— Na ndize njëherë, pa për Tetë Gjenën mos u bëj merak.

— Hëë, të falemnderit, o byrazer, — ja bëri i panjohuri, — se helbete, grua e shkuar e nuk ka takat të ecë.

Fytyra e fshatarit tani u çel, dhe sytë e gëzuar i lëviznin sa nga shoferi, sa nga gruaja. Por plaka tek rrinte mes dy burrave të gjatë, sikur s'e vinte re gëzimin e fshatarit. Shikimi i saj i qe ngulur shoferit. Mua më dukej sikur e kishte huttuar bujaria e tij e papritur, po kjo nuk zgjati shumë, sepse plaka, pasi e kundroi mirë Hasanin, u kthye nga ai, dhe gati sa s'thirri:

— Mos je Hasani i Mahmudesë ti, mor bir? Po fol de, të shkretën, fol. Unë thashë se kush është ky? Ti qenke Hasani! Po e di që s'të njoha fare?...

Hasani qëndronte tani kokëulur, si një fëmijë e druajtur, ndërsa plaka zuri të flasë lirisht. I tha se kishte dalë në xhade që menatë dhe tërë mëngjezin nuk qe dukur një maqinë për be. Pastaj shtoi me keqardhje:

— E lashë dhe Veliun pa punë, pa lere të tjerat.

Fshatari ja priti menjëherë:

— Mos e thuaj atë fjalë, Teto, po thuaj shqyrr që na u gjet ky shoku që e njifke dhe të njifka, se do të mbeteshim këtu gjithë ditën. Kështu e ka kjo e flamosura rrugë, veç kamionave të ekspeditës zor se kalojnë të tjera. Jemi larg nga qyteti, o burazer...

U hap një bisedë e shpejtë për rrugët e maqinat dhe pastaj Hasani u kthye nga plaka. Unë gjithnjë rrija majë kamjonit dhe dëgjoja:

— Po ti, Teto, ç'do këndeje maleve? Mirë ne, na e kërkon puna.

— Kam Kolin këndeja, mor bir! — ja ktheu plaka, duke parë nga fshatari.

— Kolin?! — pyeti i habitur Hasani, duke lënë pa thithur cigaren. — Pse këndeja e ke akoma? Nuk e ke prurë në qytet?

Tetë Gjena vështroi prapë fshatarin. Shikimi i saj diçka desh të thoshte, po unë nuk kuptova gjë.

— Këndeje, e kam, këndeje, — tha ajo e menduar. — Po s'ma lënë këta të fshatit ta marr. Ja, Veliu, kryetari, e ka në dorë. Po të dojë ai, e bie afër!

Hasani ngriti sytë i habitur nga unë. Unë, pa dashur, ngrita supat. Nuk mora vesh se ç'pati ai që më shikoi ashtu!

— Koli s'është vetëm i yti, Teto — dëgjova të thotë ai burri që e quanin Veli. — Është edhe i fshatit.

— Ashtu, mor bir, ashtu është, si thua ti. Po tashti u plaka dhe dua ta kemi afër.

Ndërkaq unë, pa dashur, tek rrija ulur, në bisht të karrocërisë, zura të arësyetoj me hamendje. Dëgjoja dhe me zemër i jepja të drejtë plakës. Ajo, thoshja me mendjen time, do të qe nëna e ndonjë mësuesi, që punonte prej vitesh këtyre anëve, dhe fshati s'desh t'ja lëshonte. Plaka, që ndofta e kishte të vetëm atë djalë, kishte ardhur, si duket, t'i lutej kryetarit të këshillit që ta merrte të birin në qytet. Dhe me sa dëgjoja, Veliu nuk donte t'ja linte dhe kjo, për shkak, mendoja unë atë çast, sepse shkolla i shkante mbarë dhe kryetarit nuk ja kish qejfi t'i nxirrte vetes telashe duke marrë një mësues të ri. Po, megjithatë, plaka nuk

hiqte dorë nga e saja dhe vinte kohë më kohë e i lutej Veliut.

Ja, dëgjoj kryetarin që i thotë, me një buzëqeshje që mua më duket si artificiale:

— Mirë, teto, s'ta prishim qejfin. Po ne u mësuaam me të. Bile, po më pyete mua, ai tek ne e ka vendin...

Plaka nuk flet. Papritur bëhet një heshtje e rëndë. Unë këtë e ndjej mirë, sado që unë jam lart, e ata poshtë në xhade. Asnjërit, me sa duket, nuk i jepte të flasë. Nuk flet as Hasani, për çudi. Atëhere matem unë t'i them fshatarit: «O shoku kryetar, mos e mundo a derbardhë këtë plakë të mirë. Lërja djalin!» Dua ta bëj këtë, po zëri i inxhinier Gaqos nuk më lë. Ai i thërret Hasanit dhe heshtja e rëndë prishet menjëherë.

— Erdha, inxhinier, erdha!

Hasani merr t'i afrohet kabinës, po atë kohë inxhinieri zbret me librin nën sqetull dhe përsëhendet me kokë të panjohurit. Dëgjoj Hasanin, që thotë me zë të ulët:

— Inxhinier, po shkon ti prapa dhe plaka të vijë përpara?

Gaqua tund kokën, pa thënë asnjë fjalë. Unë mendoj: «Çudi, e pashë edhe Hasanin njëherë të vihet në telashe për pasagjerët».

— E, byrazer, ta hipim tani teton? — pyet fshatari, që rri si i ngulur në një vend bashkë me plakën.

— Tetë Gjena do të hipi përpara — thotë Hasani me zë të lartë e të prerë.

— Përpara the?! — habitet fshatari dhe shikon menjëherë nga inxhinieri. Gaqua në këtë kohë është larguar ca nga maqina dhe kundron vendin

përqark. Plaka rrin si e hutuar dhe kur Hasani e fton përpara në kabinë, ajo ja pret me zë të lartë:

— Jo, të keqen, hyp prapa unë. Lëre djalin atje, se po mëson. Behar është sot, nuk ka gajle!

Gaqua dëgjon fjalët e plakës dhe kthehet nga ne:

— Nënë, urdhëro përpara, të lutem...

— Jo, jo, shiko punën ti. Nëna e ka vendin prapa bukuri.

Hasani afrohet ta marrë prej krahu, po ajo zgjat duart e saj të shkurtëra nga karrocëria, si një fëmijë dhe i lutet fshatarit:

— Veli, më ngre një çikë, mor bir.

Në këtë kohë, padashur futem dhe unë në valle. Po nuk di ç'të bëj: anën e kujt të marr? Për mua s'ka rëndësi se kush do të më vijë sipër. Njësoj është, si ajo plakë, që s'e njoh fare, si inxhinier Gaqua, që rrugës s'e ke për muhabet. Ai ka shok vetëm librin.

Them:

— Teto, shkoni më mirë përpara.

Po ajo, ndërkaq ka zgjatur duart drejt meje dhe me njëren këmbë mbështetur tek rrota, qëndron gati havadan. Atëhere unë zihem ngushtë. E kap menjëherë për duarsh dhe tek e tërheq më duket sikur plakës i kërcet shtati i hollë e delikat. Po ajo s'don t'ja dijë; i jep trupit lart dhe veç kur gjendet ulur mbi thasë. Të tre burrat poshtë shikojnë nga ne, pa bërë zë. Plaka thotë e kënaqur:

— Mos më ngani, tashti. S'ka ku të vejë më mirë. Hasan, nise!

Hasani nuk përgjigjet, po futet në kabinë. Inxhinier Gaqua para se të hypë, i thotë plakës:

— Nënë, s'e bëtë mirë kështu.

Fshatari na jep dorën të gjithëve, kurse Tetë Gjenën ngjitet lart dhe e përqafton.

— Udhë e mbarë dhe mirë ardhësh, Teto!

Plaka kthehet mbarë nga ai dhe fillon t'i japë porosi, me një ton familjar, që mua prapë më tërheq vëmendjen.

— More vesh, dërgoma me domosdo nusen javën tjetër, përndryshe nuk të shkel më në shtëpi.

Unë sërish dëgjoj dhe sikur ngatërrohem më keq. Aty për aty filloj të arësyetoj: Kur Tetoja paska kaq afërsi me kryetarin, si nuk ja lëshon të birin ai?!

Hasani nuk ndjehet më, veç kur përplas derën e kabinës.

Kur maqina merr udhë, fshatari qëndron në vend dhe tund në ajër një shkop të gjatë. Plaka mbetet me sy nga ai, gjer sa kamioni ynë futet në një kthesë dhe Veliu humbet prapa kodrës. Dalëngadalë në fytyrën e saj gazi i lehtë vjen e shuhet, ndërsa rrudhat i shtohen. Pastaj plaka kthehet e tëra nga unë dhe, duke më vështruar përmes syzeve të saj, më thotë:

— Të shtërngova dhe ty, mor bir!

Unë buzëqesh, po s'më jepet t'i përgjigjem. Kamjoni prapa është fare bosh. Marr me mend gëzimin e plakës, që ka pritur me orë të tëra. Ndërkaq, ngre ca thasë dhe i bëj plakës një vend afër meje. Ajo, si zë vend mirë dhe rregullon shaminë në kokë, papritur merr frymë thellë. Era përqaftuese jehon me një kumbim të çuditshëm. Nga fytyra i zhduket ajo gjallëria e parë. Këtë e vë re mirë, se ajo është kundruall meje, me kokën

gjithnjë lart. Të them të drejtën, nuk kam parë plakë në moshën e saj që të mbajë kokën ashtu lartë si ajo. Sytë i kanë mbetur si të ngrira, nga ana e malit të Leshanit. S'di, po mua më shkon mendja përnjëherë tek i biri. Ndofta, ai punon në ndonjë nga ato fshatrat atje përtej, në mes maleve, prej të cilëve ne po largohemi gjithnjë e më shumë. Atëhere, sepse më dhimbset ajo plakë e mirë.

Mendoj, sa gjë e madhe është dashuria e nënës.

Po ndërsa më vërtiten në kokë këto mendime, maqina jonë i ka rënë përçark brezit të malit të Sukut dhe po kalon nëpër Luginën e Luleve. Ne akoma nuk kemi shkëmbyer ndonjë fjalë. Mua më vjen keq ta trazoj, tek rri ashtu e menduar. Hasanin përpara lëviz me të dy duart timonin dhe, herë pas here kthen kokën nga ne.

Unë rri i munduar, kur era më bie në vesh fjalë të tjera:

— Me Hasanin e ke punën dhe ti, mor bir?

Unë i afrohem:

— Po, me Hasanin. Kërkojmë mademe këtyre maleve.

Ajo ngre zërin dhe unë dëgjoj qartë.

— Punë të zorçme kini, po me shëndet njeriu i kalon të gjitha...

I them:

— Të zorçme pak, se bredhim maleve, po është e bukur...

Plaka sikur e lë muhabetin me kaq. Pas një grimë here veshi më kap kalimthi një psherëtimë të lehtë, që mezi e shquaj nga era. Pastaj ajo thotë:

— Kështu ka bredhur dhe ai imi, më këmbë, këtyre anëve.

— Pse, ke ndonjë djalë këndeje? — e pyes me kast për t'u dhënë fund dyshimeve që më janë grumbulluar.

— Kam Kolin, mor bir, djalin e madh!

— Ai që kini tek Veliu?

— E kush tjetër! I kanë rënë këmbët nëpër këta gurë!

Me sa duket, djali i saj nuk qenka mësues, si pandehja unë. Do të ketë punuar edhe ai me ndonjë ekspeditë, sepse ekspeditat tona kanë vite që sillen këtyre anëve.

— Me cilën ekspeditë ka punuar? — i them.

— Me atë të Llazit... — më përgjigjet ajo, pa u menduar fare.

Përnjëherë unë sjell ndër mend me radhë shokët e qendrës sonë gjeologjike dhe më kujtohet inxhinier Llazi.

— Mos ka qenë me Llazi Koçin? — e pyes.

— Jo, jo, me Llazi Shukun, është vrarë, dimrin e madh.

Prapë ngatërrohem dhe nuk po merram vesh. Ajo flet për një Llazi, që është vrarë, unë për Llazin tonë, inxhinierin e ekspeditës së tretë.

Përpiqem të sqarohem. Kujtoj se e ka fajin era, që s'po kuptohemi dhe e pyes me zë të lartë

— Ç'punë bënte Koli këndeje, teto?

— Partizan, mor bir, ç'punë mund të bënte ai asokohe këndeje!

Unë hap sytë dhe i them i habitur:

— Partizan! Po ashtu thoni, se nuk po ju kuptoja.

— Po nëna ta tha. Ka qenë me çetën e Lla-

zit. Një Llaz ka pasur atëhere këtyre maleve. Ai ishte kumandant me nam!

— Po tashi ku e ke djalin?

— E ku ta kem tjetër, në Lezhan, tek Veliu.

Zëri i plakës më tingëllon i zvergur, po megjithatë nuk ja vë veshin kësaj gjëje. Nis e mendoj sërish për fatin e birit të saj.

— «Çudi» — ja bëj me vete, po ndërkaq më i çuditshëm po më duket vështrimi i saj prapa syzeve që vetëtimë, sikur t'i ketë rënë një rreze dielli. Stepem një çast dhe i them vetëm kaq:

— Si i paska qëlluar të punojë kënde, edhe gjatë luftës edhe tashti?

— Po mbeti, mor bir, që atëhere kur hyri Partia dhe nuk e mora që s'e mora. Ç'ti bëja fshatit!

Unë lëkundem tani në mes keqardhjes dhe habisë. I them:

— Shumë larg e kini djalin. Mundoheni deri këtu...

— Po ç'të bëj, më mundon malli, pa s'e merrja gjithë këtë udhë...

. E pyes:

— Po pse nuk vjen djali më shpesh në shtëpi? Ajo çaplon sytë dhe lëviz nga vendi:

— Cili djalë?

Unë prapë, pa të keq, them:

— Djali juaj, Koli, që kini në Lezhan?

Plaka kafshon gishtat dhe ja bën me zë të lartë:

— Po ai ka vdekur, mor bir!

— Ka vdekur?! — ja pres unë me zë të lartë.

— Po! — ja bën pastaj nëna e atë. Dhe hesht,

sikur të ketë thënë një gjë të zakonshme, kurse unë rri me gojë të hapur, duke e vështruar i habitur.

— Po që kur kështu?

— Ohu... u bënë mote plot që m'u rrëzua e s'u ngrit më, trimi i nënës... Ja fala partisë, se kjo parti me djemtë e nënave mbahet e përparon..

...Koli, atëhere, vërtetë u vra, po bëri borxhli një fshat të tërë. Ishte kumandar i një tabori me partizanë dhe sëra ja solli që të shpëtonte Lezhanin nga gjermani. Tabori i tij, dhe ai tok me ta, nuk e lanë gjermanin të hynte në fshat. Shpëtoi fshati, shpëtuan fëmijët e gratë. Në Lezhan ai ishte bërë i shtëpisë. E njifnin dhe fëmija. Kjo mesele ka shumë vjet të shkquara. Si zbritën atëhere çunat nga malet dhe zunë t'i mblidhnin një nga një tërë jetëshkurtërit, erdhën këta të Lezhanit në shtëpi dhe ma kërkuan. Më thanë se ti e ke djalë, po edhe ne djalë e kemi. Ai ka bërë shumë për ne, prandaj të na e japësh, pa derman. Do ta mbajmë tok me djemtë e fshatit, më thanë. Unë u mendova dhe thashë me atë timen: Arbëri këtu, Arbëri atje, njësoj është. Po ku ja dinë më shumë, ku më ka çuni më shumë nder? U mendova dhe s'e bëra të gjatë. Mbajeni, u qoftë falë — u thashë dhe s'e ngava më. Fundi, në dhe të vatanit është.

Më duket, tek flet ashtu, sikur po më ngushëllon ajo mua, në vend që ta ngushulloj unë atë. Zëri i saj pa 'asnjë luhatje, ai vështrim vetëtitës i syve, ajo qetësi e madhërishme, sikur e shndërrojnë Teto Gjenën në mendjen time në njeri tjetër. Harroj tashti se ajo është plaka e panjohur, që hipi rastësisht në kamjonin tonë...

SKICA

NDERLIDHËSI

Tërë natën ra shi me rrëshekë. Në mëngjes, poligoni i tankistëve u gjend i përmbytur. Gjithë ajo punë e bërë për një muaj rresht ishte zhdukur nën ujë. Fusha e sistemuar për bukuri qe shndërruar tani në një pellg të pafund.

Kur erdhën në mëngjes ushtarët, në çastin e parë u hutuan. Atë mbrëmje reparti i tyre do të bënte qitje në errësirë. Po pamja e mjeruar e poligonit e vinte në pikëpyetje stërvitjen. Megjithatë, pas këtij hutimi të çastit, ushtarët e morën veten menjëherë. Nuk kaloi shumë dhe ata filluan nga puna. Shiu tani kishte pushuar. Zuri të fryjë një erë e ftohtë, që i largoi retë. Qielli u hap. Ushtarët me lopata e kova për gjithë ditën e detyruan ujin ta lejë fushën. Dalëngadalë poligoni nisi të marrë fytyrë. Çdo gjë u kthye në gjendjen e mëparshme.

Në sfondin e gjelbërt të fushës tani dalloheshin qartë shenjat e situatës, vijat e kanalet, sistemi elektrik, strehimet... Poligoni ishte gati të priste repartin.

Në mbrëmje zhurma e rëndë e tankeve jehoi

nëpër fushën e gjerë. U dëgjuan urdhërat e sinjalet e komandantëve. Ushtarët zunë me radhë postet e tyre luftarake. Me urdhër të komandantit të tij, vrapoi në strehim dhe ndërlihdësi Shpëtim Zyberi. Ai qe ngarkuar me një detyrë të rëndësishme e delikate. Strehimi i ndërlihdjes gjendej pranë tabelës së qitjes, nën vendin ku binin predhat. Ai kishte për detyrë të ndriçonte objektivin e të jepte përfundimet e goditjeve.

Shpëtimi mori dorezën e telefonit në dorë dhe në dritën e një llambushke vështroi vendin për-qark. Ujët tani ishte zbrazur nga strehimi, po ushtari e ndjente lagështirën në trup. Këtë ndjeu vetëm në fillim, se pastaj e tërhoqi puna. Filloi qitja. Vendi shungullonte nga jehona e armëve të fuqishme. Strehimi kërciste lehtë, po ndërlihdësi s'desh t'ja dinte fare: çdo hije druajtje e frike ishte e huaj për të. Ai u përgjegjej në kohë urdhërave, raportonte me përpikmëri përfundimet dhe tek rrinte me dorezë në dorë, u gëzohej goditjeve në shenjë që bënin shokët. Kjo ndjehej sidomos në zërin e tij, që herë ligjëronte e herë buçiste në hapësirën e ngushtë të strehimit. Dukej, sikur çdo gjë do të vinte mbarë. Po nuk kaloi shumë, kur befasi ndjeu t'i lagen këmbët. Për një çast, kujtoi se mos ujët buronte nga toka, por kur uli kokën dhe pa me kujdes, vuri re se ujët vinte nga jashtë. Mendoi se mos kishte filluar prapë shiu. Po mbi strehim xixëllonin yjet. Ushtari nuk pati kohë të hetojë më gjatë. Ai vijoi të japë e të marrë me aparatën, gjersa ujët i hyri brenda në këpucë. Hodhi sytë poshtë dhe pa që sheshi i vogël i strehimit kishte humbur nën ujin e turbullt. Tani për

ushtarin u bë e qartë: përroi i vogël, që rridhte disa metra më tutje, ishte fryrë e kishte dalë nga shtrati... Kjo u duk akoma më mirë, kur ujët mori të ngjitej më lart e arriti deri në gjunjët e ushtarit... E Shpëtimi, tek blsedonte në aparat, nuk jepte të kuptonin asgjë nga ç'po ndodhte. Ai vijonte të raportonte, të merrte urdhëra... Po ujët sa vinte e rridhte gjithnjë. Strehimi dukej sikur zvo-gëlohej.

Ushtari mendoi njëherë të njoftonte komandantin. A nuk ishte kjo një situatë e jashtëzakonshme? Po shpejt ai ndërroi mendje: pse t'i vinte në telashe të tjerët, pse të pezullohej qitja, qoftë dhe për një kohë! Shokët ishin stërvitur me muaj të tëra, gjithë ditën kishin zbrazur ujët e fushës, kurse ai s'mund të duronte për disa orë këmbët në ujë!

Atëhere Shpëtimi përmbloodhi veten, duke u munduar të largojë çdo arësyetim, që mund ta shtynte për të njoftuar komandantin... Tabelat jashtë strehimit goditeshin nga shokët pamëshirë. Po ujët brenda gurgullonte pandërprerje. Ushtarit i shkonin të ngjethura në shtat. Gjysma e trupit tani ishte kredhur në ujin e ftohtë të dimrit. E megjithatë, ai vijonte të kryente detyrën: komandanti atje përtej i dëgjonte të plota raportimet e ushtar Shpëtimimit. E ky këndeji, tek shihte predhat që binin aq bukur në objektiv, gjallërohej e dalëngadalë zuri ta ndjejë, si të thuash, veten të qetë, zhytur në ujë.

Për një kohë ushtari e largoi mendjen nga rreziku që i kanosej. Detyra e tij, prej së cilës varej fati i qitjes, e kishte rrëmbyer të tërin.

Ndërkaq niveli i ujit ngjitej me vrull. Shpëtimi e vështronte këtë gjë me gjakftohtësi. Ai tani ishte i ndërgjegjshëm se tek rrinte ashtu nën ujë, zbatonte urdhërin e komandantit. I shkante mendja te partizanët, kujtonte porosinë e komandantit që ushtari i popullit duhet të stërvitet në kondita të njëllojta me ato të luftës dhe mendonte: Po sikur të ishte luftë, a do ta njoftonte komandantin për atë që po ndodhte?

Shpëtimi çdo gjë e kishte të qartë dhe me besim e këmbëngulje kryente detyrën. S'ka gjë, që ujët e ftohtë i shtërngonte trupin, si në një darë të mprehtë. Edhe pse buzët i dridheshin, ai arrinte të raportonte në rregull, pa lënë asgjë mangut...

Po ujët ngrihej gjithënjë e më lartë. Syri i stërvitur i ushtarit vuri re se sipërfaqja e turbullt po i afrohej pak nga pak rrjetit elektrik të strehimit. Po tani? Mundet që teli të jetë diku i zveshur dhe atëhere gjithë ajo masë uji kthehet e bëhet përçues i vdekjes. Gjendja e ndërlihdësit u vështirësua tepër. Ai shtërngonte dhëmbët, ndërsa në ballë i shtoheshin rrudhat. Kontrollloi me të shpejtë rrjetin e telave. Masa e ujit, si një pllakë e madhe vinte e zhvendosej gjithnjë e më lart. Po sikur të prekte diku me korentin? Ushtar Shpëtimi vendosi ta provonte e t'i bënte ballë vetë burrërisht situatës. Detyra është detyrë për ushtarin. Urdhëri i komandantit duhet zbatuar deri në fund. Ai ishte në postin e tij luftarak dhe ndërlihdësi e dinte se në luftë, pa urdhërin e komandantit nuk mund të lëvizësh nga pozicioni. Prandaj ai me ndërgjegje të plotë nuk luajti nga strehimi. Ujët filloi të ngjitej në gjoksin e ushtarit e pastaj gra-

dualisht dhe rrjeti i telit humbi nën të. Ky ishte një cast i rëndë. Djersë të ftohta mbuluan ballin e ushtarit, sikur ta dinte që më parë se do t'i kalonte afër shigjeta e zjarrtë e rrufesë. Ndërkaq, për asnjë llop, ndërlidhja nuk u shkëput. Jashtë strehimit gjëmonin armët e tankeve, goditeshin tabelat, jehonte teli i telefonit... Kurse ai brenda, i zhytur në ujë gjer në grykë, me duart e ngri-tura lart, duke mbajtur aparatën e dorezën vazh-donte punën...

Kështu Shpëtimi punoi për gjashtë orë rrjesht. Kur mbaroi qitja, në hyrjen e strehimit ush-tari shquajti fytyrën e dashur të komandantit. Oficeri kishte shtangur në vend me vështrim të habitur përpara. Po kjo gjendje ndërroi menjë-herë, kur ushtari me zë të plotë, pa asnjë luhatje, raportoi për detyrën e kryer. Komandanti pastaj i dha dorën dhe Shpëtimi me aparatën në njerën dorë, doli jashtë. Ata u rrokën në qafë, ndërsa fusha jehonte nga zhurma e fuqishme e tankeve.

NË POZICION

Stërvi-tja vazhdonte prej disa ditësh. Reparti ishte shpërndarë nëpër pozicione, të ngritura në vende të vështira. Kudo për-qark shtriheshin male të thepisura, hapeshin hane të shkreta, binin në sy gryka e rrëpira të panumërta. Po ushtarët nuk donin t'ja dinin për asgjë. Ata lëviznin e vepronin lart e poshtë, si në vende të shkelura, kush e di sa herë. Ngjitnin armë të rënda, kryenin veprime të ndërlikuara, ndesheshin me «armikun», pa marrë parasysh asgjë, si në rrethana të vërteta lufte.

Vetëm sipër, në bark të malit, në një guvë të fshehur, që zotëronte tërë teatrin e veprimeve të repartit, qëndronte kërrusur mbi një tavolinë të vogël lëvizshme ushtar Lulëzim Jashari. Në këtë tunel natyral ishte vendosur vend-qëndrimi i shtabit. Oficerët e shtabit hynin e dilnin, bënin mbledhje, merrnin e jepnin urdhëra, ndërsa ushtari Lulëzimi kokulur punonte me ngulm. Ai ishte thirrur aty të përgatiste dokumentat e shtabit. Mendimi taktik i komandantëve shndërrohej nga

dora e tij në skica, skema, urdhëra. Ai fiksonte në hartën topografike, që shtrihej mbi tavolinë, forcat e repartit, pozicionet e reja, lëvizjet, vendet ku do të ndesheshin me «armikun». Ai ndiqte shpirtërisht gjithë veprimet e repartit. Ashtu si shokët, edhe ai luftonte me vështirësitë, me lodhjen, me pagjumësinë. Një disenjator tjetër do ta kishte zor të punonte në kushtet që punonte ushtari ynë. Mbi një tavolinë të vogël, të shtrembër, që lëvizte orë e çast, ai vizatonte e shkruante, pa penel, me një pendë të zakonshme. Jashtë binte shi dhe brenda hynte ujët dhe era. Ushtari i vinte shpatullat erës dhe nuk e linte t'i trazonte dokumentat. Herë pas here, duart nga të ftohtit e lodhja e humbësinin shkathhtësinë e zakonshme. Atëherë ai i fërkonte njëra me tjetrën, lëvizte pak dhe vijonte detyrën. Dhe detyra e tij ishte delikate. Ajo kërkonte mprehtësi, vëmendje, përpikmëri, kujdes. Një vijë e shtrembër, një njollë pengonte stërvitjen, loste me fatin e saj. Prandaj puna e tij nuk binte më poshtë nga ajo e shokëve që ndesheshin me «armikun». Edhe ai këtu luftonte me armët e veta. Kishte net e ditë të tëra që qëndronte në postin e tij, pa rreshtur një çast, pa dalë nga «pozicioni». Ai e dinte se edhe posti i tij luftarak bënte pjesë në tërë atë shpërndarje forcash të repartit për «luftë».

Komandanti i repartit kishte lidhje më shumë nga të tjerët me Lulëzimin. Ai merrte e jepte me të vazhdimisht, e udhëzonte, i ngarkonte detyra të reja, merrte në dorëzim punët e kryera. Po erdhi një çast që ai vuri re se ushtari mezi qëndronte në këmbë, dora i dridhej, koka herë pas here i varej në gjoks.

Komandanti i vajti pranë dhe i vuri dorën në ballë.

— Ti ç'ke kështu, Lulëzim?

— Asgjë, shoku komandant! — ja priti ushtari, duke u munduar të mos e shohë në sy.

— A ke ngrënë në rregull?

— Po, shoku komandant!

— A ke fjetur ndopak?

— Po, shoku komandant!

Komandanti i shikonte gjithë dyshim. Dhe vërtetë, pamja e ushtarit tregonte qartë.

— Ju s'thoni të drejtën, ushtar Lulëzimi! — foli oficeri i zemëruar.

Ushtari uli kokën, ndërsa zëri i komandantit gjëmoi rreptë:

— Shkoni pushoni, ndryshe do t'ju vë para përgjegjësisë.

Ushtar Lulëzimi u hodhi një sy dokumentave mbi tavolinë dhe, kundër dëshirës, u nis të zbatojë urdhërin e komandantit. Ai kishte dyzet e tetë orë pa ngrënë e pa mbyllur sy!

NË MES FLAKËVE

Roja lëvizte poshtë e lart në sheshin e vogël të nënrepartit. Kishte kaluar mezi i natës dhe gjithë shokët atë kohë flinin në bujtinë. Që larg, vinte zhurma ritmike e një motorri. Diku, atje përtej, naftëtarët hapnin një pus të ri. Tutje në xhade kalonin herë pas here maqina.

Poshtë nënrepartit, dritat e shtëpive të naftëtarëve kishin kohë që ishin shuar. Lagjja ishte kredhur pothuaj e tëra në errësirë. Vetëm tek tuk shquanin dritat e rrugës, që kalonte në mes shtëpive të punëtorëve.

Roja lëvizte, ecë e jak, sipër në bregore dhe vështronte herë pas here pamjen, që i hapej para syve. Syt e tij, të lodhur në errësirë, sikur preheshin në atë brez drite që rrethonte lagjen e punëtorëve. Ai dëgjonte zhurmat e natës, ndiqte lëvizjet e maqinave, përfytyronte punën që kryenin atje përtej naftëtarët. Po tek lëvizte nëpër sheshin, para bujtinës, vëmendjen e rojes e tërhoqi një dritë e vockël që dridhej sipër çatisë së një shtëpie. Thua të ishte dritare e ndezur mbi çati?! Po drita sa vinte

e zmadhohej. Në fillim, ajo ishte e verdhë, pastaj erdhi e u skuq. Kur, pa pritur, një gjuhë flake flakëroi, u luhat sa andej këndeje nëpër errësirë. «Zjarr! — mendoj roja, — Zjarr në shtëpinë e ndonjë naftëtari!» Ç'të bënte? Komandanti nuk ndodhej në repart. Shokët flinin. Flaka tani dallohej mirë. Po për çudi, asnjë zhurmë, asnjë lëvizje atje përposht. Roja nuk priti më të mendohet. Shtrengoi armën në krah dhe vrapoi për në bujtinë. Kur hapi derën, për një çast, ai u step nga qetësia e thellë e bujtinës. Të gjithë flinin të shkujdesur. Po rreziku që i kanosej shtëpisë së punëtorit, atje poshtë, ishte i madh.

— Zjarr, shokë! — thirri roja nga pragu i derës dhe hapi dritën. Ushtarët çelën sytë e u ngritën rëmbimthi në këmbë. I pari u ngrit shefi i truprojës, që zëvendësonte dhe komandantin e nënrepartit. Të gjithë filluan të vishen me të shpejtë.

— Ku ka rënë zjarri, Qamil? — pyeti shefi i trupprojës.

— Poshtë, në lagje!

— O burra, shpejt, shokë — urdhëroi shefi, duke dalë jashtë me vrap. Qamili iu afrua ushtar Patriut, i dorëzoi shërbimin, që i binte sipas radhës, dhe kapërceu prakun e bujtinës me një frymë.

Flaka e shtëpisë ishte ngritur lart në qiell dhe drita e saj zbulonte çatitë e shtëpive të tjera.

Qamili zbriti me të rendur të tatëpjetën, ndërsa prapa dëgjoi hapat e dëndura të shokëve. Ata po vinin me vrap pas tij. Me të dalë në rrugën kryesore, shtëpia dukej fare afër. Flaka sipër saj lëpihej në qiell si një gjuhë e zjarrtë. Rruga ishte e shkretë. Të parët po arrinin për ndihmë ushtarët. Ata e

rrethuan menjëherë shtëpinë. Shefi i truprojes ndau detyrat dhe dha alarmin në lagje. Njerëzit u zgjuan menjëherë e vërshuan nga të gjitha anët.

Një turmë e madhe u grumbullua para shtëpisë, me kova uji, me kazma e lopata. Dëgjoheshin bëiseda të shkepura me zë të lartë:

— I shkreti Hasan, nuk di gjë!

— Të shkojë ndonjë ta thërrasë atje në punë, se ka turnin e natës.

— Shikoni se mos është brenda e shoqja!

— Po, po, Hasbia ka gjumin e rëndë!

Qamili tek vinte e vinte duke sjellë ujë tok me shokët, befas dëgjoji nga brenda një thirrje si piskamë, që u përqethi shtatin të gjithëve. Zonja e shtëpisë papritmas u bë e gjallë! Ushtar Qamili e la kovën dhe u sul brenda në shtëpi. Kapërceu hajatin e vogël dhe, duke u dredhuar flakëve, lhyri në korridor. Hapi njëren derë e duke luftuar me tymin, vuri re se brenda s'kishte njeri. Pastaj me të shpejtë shtyti tjetrën, po një lëmsh i zjarrtë sa nuk i dogji fytyrën. Sakaq, zëri i fortë i një gruaje i buçiti në vesh. Atëhere ushtari s'pyeti më, po u sul mbi flakë dhe veç kur u gjend para një krevati mbi të cilin qëndronte kruspull një grua e re. U hodh mbi të, e rrëmbeu vrik dhe e ngriti në krah. pastaj mori të dalë, po një flakadan u shkëput që sipër dhe ra një hap para tij. Atëhere ushtari u turr në drejtim të dritares. Po dhe andej ishte e kotë. Dritarja digjej me shpejtësi. Dera ishte rrethuar nga zjarri i flakëve; e me gjithatë ushtari s'deshi t'ja dijë. Mori vrull, e kapërxeu e me gruan në krah, doli në koridor. Zjarri si ujët e një përroi të kuq vërshonte nga të gjitha anët. Ai ndjente

që i përcëllonte fytyra, i digjnin sytë, po prapë ecte me guxim përpara, duke gjarpëruar nëpër flakë, duke i bërë dredha zjarrit, sa andej këndeje.

Kur doli jashtë, turma e rrethoi menjëherë dhe ai ndjeu mbi trup ujët e ftohtë që i hodhën shokët. Gruaja rënkonte, po atë kohë kishte ardhur ndihma e shpejtë dhe dikush ja mori ushtarit nga krahët. Pastaj, ai u fut në mes të shokëve dhe vazhdoi punën për të mundur zjarrin.

Kur zjarri arriti të shuhet pjesërisht dhe njerëzia u qetësuan, të gjithë pyesnin:

— Kush ishte ai ushtari që shpëtoi gruan e naftëtarit? Po asnjë nuk dinte të përgjegjej.

Ushtarët, pasi kishin kryer detyrën, qenë ngjitur në nënrepart. Megjithatë, populli e mori vesh se një ushtar kishte vënë jetën në rrezik për të shpëtuar gruan e një punëtori.

Vetëm ushtarët e nënrepartit e dinin se ai, që kreu atë akt të lartë, ishte shoku i tyre, ushtari Qamil Meta.

KRISMA

Papritmas në repart jehoi një krismë arme. Atë kohë mbi qytetin e vogël ushtarak po binte mbrëmja. Disa ushtarë, që u gjendën në shesh, sapo dëgjuan krismën, rendën me të shpejtë. Ata morën më të djathtë të sheshit dhe u zhdukën pas disa ndërtesave, që vinin radhë njëra pas tjetrës. Tamam, para vend-mbushjes së armëve, ishin mbledhur një grup ushtarësh. Në mes tyre qëndronte me armë në dorë, kokulur, ushtar Shabani.

— Ti ç'pate, kështu? — e pyeti Shefqeti, që mezi mernte frymë nga të rendurit.

Ushtari me pushkë ngriti sytë e turbulluar, po nuk u përgjegj. Vështrimi i tij mezi u qëndronte syve qortues të shokëve. Në mes tyre u nder aty për aty një heshtje e rëndë.

— Ti ku e kishe mendjen? — thirri, me zë të lartë një tjetër që rrinte prapa shokëve.

— Unë po e... mbushja — pëshpëriti ushtari me pushkë — dhe veç... kur u shkreh... .

— T'u shkreh të koka, t'u shkreh të! — foli një ushtar, duke u larguar i zemëruar nga turma. Disa ushtarë vunë buzën në gaz, ndonjë qeshi me zë, po prapë atmosfera mbeti e rëndë.

— Po ti, a i di rregullat? — pyeti prapë Shefqeti.

— Po t'i dinte, nuk alarmonte repartin! — u hodh një tjetër.

Ushtari me pushkë nuk hapi më gojë. Pastaj erdhi komandanti i togës. Ai i mori armën Shabanit dhe ja dorëzoi ushtar Arqilesë.

— Ju nuk do të bëni shërbim sonte! — tha komandanti, duke iu drejtuar ushtar Shabanit.

Shabani uli kokën dhe qëndroi ashtu, gjersa turma e ushtarëve u shpërnda. Atë natë, ai po-thuajse nuk fjeti. Të nesërmen u mbledh organizata e rinisë. Të rinjtë e kësaj organizate nuk kishin biseduar ndonjëherë për një çështje të tillë. Zakonisht me këto gjëra ishte marrë komandanti, kurse tani ata do të vendosnin vetë për fatin e shokut të tyre.

Ushtarët biseduan gjatë. Pse i ndodhi Shabanit kjo gjë? A është e hijshme për një ushtar t'i shkrehet arma në dorë? Po sikur të kishte pasur afër njeri e ta kishte vrarë? Po në luftë, ç'pasoja mund të kishte një shkrehje arme pa kuptim?

Kjo ishte një mbledhje serioze, tronditëse. Ushtarët flisnin qetazi, po në ballin e tyre lexohej një mendim i rëndësishëm. Komisari e komandanti rrinin mënjanë e dëgjonin. Atyre u jehonin në vesh mendimet e ushtarëve:

— Shabani nuk e ka përvetësuar armën. Ai akoma nuk është bërë zot i saj...

— Shabani duhet të mësojë rregulloren, të stërvitet vazhdimisht...

— Kur nuk e zotëron armën, si mund të jetë i aftë Shabani për të kryer detyrat?

Pastaj u ngrit Shefqeti e tha:

— Propozoj që Shabanit për një muaj të mos i besohet shërbimi i postë-rojes. Shërbimin e tij do ta bëjmë ne. Ai të mësojë rregulloren e të stërvitet vetë me armë.

Të rinjtë i miratuan fjalët e shokut të tyre. Ato i quajtën të arësyeshme dhe komisar i me komandantin. Ato i pranoi si të drejta edhe vetë Shabani, kur u ngrit e bëri autokritikë.

Por kur mbaroi mbledhja dhe u gjend vetëm, ushtarit i rënduan akoma më shumë në ndërgjegje fjalët e shokëve: Si mund të quhesh ushtar, kur të heqin të drejtën e armës, kur nuk të besojnë detyrën e post-rojes? Kjo ishte njësoj si të mos të të marrin në luftë, për shkak se je frikacak, i pazoti...

Shabani kishte zbritur në ushtri nga një fshat i krahinave të veriut, njerëzit e të cilit kishin jetuar gjithnjë me armë në dorë. Po sikur ta merrnin vesh ata për këtë gjë që ndodhi? Në mendjen e Shabanit u sulën sa e sa mendime qortuese, të cilave ai mezi u jepte udhë. Nga një anë, atij i dukej vetja i tepërt në repart, i padenjë për të qenë shok me efektivin e baterisë, kurse, nga ana tjetër, gjithnjë e më shumë e bënte për vete mendimi se kjo gjendje mund të kapërcehej vetëm me punë këmbëngulëse. Ndokush do të mendonte si mikroborgjez: ja, Shabani për një muaj do të binte rehat, nuk do ta shqetësonte njeri natën, nuk do të bënte më roje në të ftohtë, tek rrihte shiu e frynte erë, sipër atje në kodër.

Po Shabani nuk mendonte kështu. Ai u bind dalngadalë se ajo që ndodhi ishte një gabim, prapa

të cilit fshiheshin një tok mungesash, fshihej pakujdesija e vëmendja e pamjaftueshme në detyrë. Ai vërtet nuk i kishte mësuar si duhet rregulloret e nuk e zotëronte akoma armën.

Pas këtyre mendimeve, ai iu vu punës, me ngulm, çdo ditë, bile dhe natën, kur shokët pushonin. Lexonte, stërvitej, prapë lexonte e stërvitej. Shefqeti, që për një çast në mbledhje i qe dukur i huaj, tani i rrinte pranë dhe e ndihmonte hap pas hapi. Kështu, nuk kaluan as dy javë dhe Shabani kërkoi nga komanda që ta merrnin në provë. Komanda pranoi dhe Shabani faqe shokëve iu përgjegj pyetjeve, demostroi veprimet me armë, gjersa të gjithë u bindën se ai i kishte përvetësuar njohuritë dhe shprehitë e armës.

Shabanit qysh atë natë i besuan armën dhe ai shkoi sipër në kodër të kryente detyrën e postërojes. Tek ndjente krenarinë e ushtarit në postin luftarak, atij i silleshin në kokë akoma fjalët e komisarit:

«Njerëz që nuk gabojnë nuk ka. Ai që gabon dhe lufton ndershëmrisht për të ndrequr gabimet, meriton besimin e shokëve e të popullit».

MBI KRESHTAT E DALLGËVE

Bocman Dauti, një detar i vjetër, më tregon:

«Shkonim me dragaminë nga Ujë e Zi për në Kepin e Lartë. Atje ishte një bateri jona, vendosur në një vend të thatë, dhe ne në disa ditë një herë vinim e u çonim ujë shokëve. Kjo që do t'ju tregoj ka ndodhur kësaj vere. Ju e dini ç'thatësirë bëri verën që shkoi. U nisëm me det të mirë, po në rrugë e sipër deti u trazua keq. Dragaminën e kishim ngarkuar me fuçia uji. I kishim vendosur në kic, si zakonisht. Kur zuri deti, gjithë ekuipazhi u vu në lëvizje. Na dulhej t'i ruanim fuçiat të mos binin, ndryshe shokët, atje, do të mbeteshin pa ujë. Dragamina jonë ishte e vogël, për më tepër e vjetër, nga ato të transportit. Mendoni sa vësh-tirë e kishim. Deti sa vinte e tërbohej, nuk di sa ballë vajti ashtu... Gjithë ekuipazhi luftonte me dallgët, duke qëndruar në postet e shërbimit. Unë jepja urdhëra me zë të lartë, sa në një anë në tjetrën. Kishim bërë gjysmën e rrugës, kështu keq e takeq, kur ndodhi ajo që ndodhi. Tri fuçia i shpëtuan syrit tonë dhe na ranë në det. Merreni me mend si mbeta unë atë çast! Thashë njëherë

të organizoja punën për shpëtimin e fuçiave, po tek rrija në timoneri dhe shihja përpara detin që shfrynte me zemërim, m'u kthye mendja. Mendova për jetën e marinarëve. Ç'ishin ato fuçia para jetës së tyre! Në dreq të venin ato, shëndoshë vetë. Nesër u çonim të tjera! Po ndërsa gjyqtoja kështu me veten, vijmë më thonë se dy marinarë qenë hedhur në det. «Kush more është hedhur në det?» — pyes i tronditur. — «Vasili me Aliun» — më thonë. I jap një marinari timonin dhe me vrap dal në bort. Ç'të shikoj? Unë detar i vjetër jam, po atë që më panë sytë atë ditë nuk do ta harroj për tërë jetën. Dy marinarët e mi përlesheshin me dallgët dhe s'ja kishin për pesë fare. Dallga, sa dragamina vetë, ngrihej lartë bashkë me dy djemtë dhe ata qëndronin sipër saj, sikur të ishin kapur pas leleve të një kali gjigand. Kur pashë guximin e tyre m'u forcua zemra dhe fillova të jap komandë. Dallgët i rrëmbenin fuçiat dhe i largonin nga anija, po Vasili me Aliun, u vinin gjoksin përpara dhe s'i linin të shkonin më tej. Ata herë qëndronin mbi ujë, herë zhyteshin diku thellë e zhdukeshin për një çast nga sytë tanë. Unë bërtisja me sa fuqi që kisha: «Kujdes! Djathtas! Majtas! Mos u largoni, mos u largoni!» Pastaj dhashë urdhër: «Hidhni litarët...» Marinarët hodhën litarët dhe ata i kapën. Tashti ata e kishin më lehtë, po prapë rreziku ishte i madh. Ne që lartë shikonim Aliun dhe Vasilin si përpiqeshin t'i lidhnin fuçiat me litar. Kur lidhën fuçinë e parë, ne gjithë gëzim tërhoqëm litarët dhe e vendosëm mbi kic. Këtë gjë e përsëritëm dhe dy herë të tjera. Pastaj i hodhëm li-

tarët për Aliun dhe Vasilin. Po ndërsa marinaret u gëzoheshin fuçiave, unë s'ja u ndaja svtë atyre të dyve që lëftonin në det. Vija re se ishin lodhur, aq sa mezi kapnin litarët. Atëhere mua më zuri një frikë e papritur, isha gati të hidhesha e t'i ndihmoja. Thashë se më ikën të dy, sidomos Vasili, që vinte i pakët nga shëndeti. Vetëm kur i pashë që hodhën njëren këmbë mbi bort, më erdhi zemra në vend... Më vinte t'i përqafoja dhe në të vërtetë i përqafova, po s'më erdhi mirë që u hodhën në det pa urdhërin tim. Ne jemi ushtarakë, aq më tepër detarë...

U thashë: «Bravo ju qoftë, po tjetër herë mos e përsërisni këtë». Po Aliu, megjithëse ishte i raskapitur e mezi fliste, ma priti aty për aty: S'mund t'i linim shokët pa ujë, shoku bocman. Ata na presin!».

Kur arritëm në breg, shokët e baterisë kishin dalë të na prisnin. E dinin që do të vinim dhe genë bërë shumë merak. Harruan ujët dhe mendonin për jetën tonë. «Ishim gati të pinim ujë të kripur, vetëm ju të arrinit shëndoshë e mirë», — më tha komandanti i baterisë, Skënderi, kur u ulëm në sterc.

DJALI I KOMANDANTIT

Në një takim me marinarët e anijes N. vura re në mes tyre dhe një djalë tetë vjeç. Kur mbaroi mbledhja, pyeta Ramadanin:

— Ç'ishte ai fëmija në mbledhje?

— Ai është djali i komandantit — m'u përgjegj marinari... — I ka vdekur e ëma.

Ndërkëq, hymë të dy në kabinën time. Mua s'më hiqej nga mendja fytyra e fëmijës, me ata sy shpuzë, që s'ua dallova dot ngjyrën, po që më shikonin me një vështrim të patrembur. Mendoja për fatkeqësinë e djalit të vogël, që kishte mbetur pa nënë. Mendoja dhe për të atin, që kishte ngehur me një fëmijë jetim. Komandanti është burrë i ri, nuk di a i ka kaluar të tridhjetat. E pyes Ramadanin:

— Fëmija, si duket, vjen e sheh shpesh të atin?

— Jo — më thotë Ramadani, — ai banon këtu me të. E kemi bërë djalin e anijes.

— Pse, s'ka njerëz të tjerë komandanti?

— Ka, po i ka në fshat. Kur i vdiq e shoqja, ai u vra shumë. Ne s'dinim si ta ndihmonim dhe

i thamë ta linte fëmijën këtu, deri sa të mbaronte viti shkollor. Edhe ai, si duket, s'kishte qejf ta dërgonte në fshat. Donte ta kishte pranë, se nga familja ai djalë i kishte mbetur.

— Po gruan ku e mbante, në fshat apo këtu?

— Këtu, këtu!

— Në anije?

— Jo, jo! — qeshi marinari dhe sikur u prish ajo atmosferë e rëndë që ishte krijuar pa dashur — Ai e ka dhe sot shtëpinë e ngritur, po kur i vdiq ajo, si duket iu zvodh shtëpia. Rrinte gjithë kohën në anije dhe punonte. Kishte nevojë për njerëz. Ne e kuptuam dhe i thamë të vinte të banonte ca kohë në anije. Ai nuk na tha gjë, po një natë fjeti këtu dhe që atëhere ngeli. Djalin në fillim e solli disa herë, pastaj nuk desh ta mbante në anije. E linte tek një fqinjë. Ne marinarët iu lutëm. Bëri çmos dhe komisari. I thanë të gjithë: «Lëre, lëre, gjersa të mbarojë vitin shkollor. Ne jemi gjithë këta, mos kini gajle». Më në fund, ai e la. E pa dhe ai që ne e kishim me zemër. Pastaj ekuipazhi ynë ka dy mësues, njëri bile ka qenë dhe drejtor shkolle. Është Agimi, ai marinari i gjatë. Tashti u bënë disa muaj që fëmija jeton në mes nesh. Në fillim, kush e kush ta përkëdhelte më shumë. Kjo gjë s'i pëlqeu komandantit dhe na qortoi. Po dhe ne s'kishim faj. Ai na kujton familjen. Secili ka lënë në shtëpi një vëlla a një nip të vogël. Tashti e ka marrë në kujdes Agimi. Ai e pregatit për në shkollë, i kontrollon detyrat, ndjek regjimin e punës. Në të tjerët nuk e ngasim. E dimë se kur është i lirë dhe në atë kohë e marrim, lozim e bëjmë shakara.

Është i zgjuar dhe e ka gjuhën brisk. E çfarë nuk thotë e çfarë s'pyet, po vetëm të ëmën s'e përmend. I ati i qëndron mbi kokë dhe nuk e lë të llastohet.

Për vitin e ri shtimë të gjithë nga diçka dhe i blemë një dhuratë të vogël, dhuratë ushtarësh. Komandanti atë natë ra të flerë shpejt dhe djalina e la neve. Ishte hera e parë që shkante të binte pa të. Ndofta, donte të ishte vetëm. Kush e di, e mundonin kujtimet! Ne ndenjëm me Fatosin e vogël, luajtëm dhe bëmë shakara. Pastaj e vumë për të fjetur tek krevati i Sadikut, që kishte shkuar me leje.

Tashti dhe pak mbeti. Komandanti na tha se do të kthehet në shtëpi. Ju e kuptoni se ç'boshllëk të madh do të na lërë ai fëmijë, kur të iki nga anija. Ne u mësuaam keq me të. Është fëmijë shumë i mirë. E vutë re me sa vëmendje ju ndiqte kur flisnit. Të gjitha i kupton. Provojeni po të doni!

PORTRETI I NJË DETARI

Zakonisht kur njihesh me ndonjë detar të dalluar, pandeh se ai gjithë jetën mund të ketë qenë i lidhur me detin. Mendon se mund të ketë lindur në ndonjë qytet bregdetar ose është marrë me not që përsëvogli. Dhe të duket e çuditshme, kur dëgjon nga një detar se ai për të parën herë ka parë det me sy, vetëm atëhere, kur ka ardhur në radhët e ushtrisë. Kështu i ka ndodhur dhe Ligorit, njërit prej palombarëve të Flotës sonë. Para tre vjetësh, ai jetonte në fshatin Rrëmbec të Korçës, merrej me bujqësi. Zbriste në qytet sa herë ja desh puna, bridhte nëpër fshatrat e krahinës, kishte qenë gjer në Pogradec dhe kishte parë liqenin e bukur. Më tutje nuk kishte pasur rast të shkonte.

Po një ditë dhe Ligorin e thirrën ushtar dhe për çudi e caktuan në marinë. Kooperativisti i ri zbriti nga Rrëmbeci, bëri gjithë atë rrugë nëpër male, gryka e fusha, kapërceu lumenj dhe erdhi e qëndroi buzë detit. Kur e pa nga larg, i bëri përshtypje madhësia e tij, pamja pa anë e fund, ajo kaltërsi e bukur që të lbyrte sytë. Pa da-

shur, Ligori, i mallëngjyer, rrinte e shikonte dhe nuk kishte të ngopur. Ai u çapit drejt bregut dhe atje u ul dhe e preku ujët me dorë. Valët vinin e përplaseshin te këmbët e detarit të ri, disa pika uji i lagën rrobat, i ranë në buzë dhe ai ndjeu për herë të parë njelmësinë e ujit të detit. Pa prituri mbledhi buzët, se si i erdhi ashtu tek provonte atë ujë. Sot, kur e kujton këtë çast, i vjen për të qeshur. Po ky që gëzimi dhe turbullimi i parë që i shkaktoi deti. Pastaj filloi për Ligorin jeta e detarit.

Deti nuk të pranon kollaj, duhet të përgatitesh, pa të bësh jetën e tij. Për muaj të tërë detari i ri bëri stërvitje; filluan kështu gëzimet dhe shqetësimet. Ai punonte me këmbëngulje për t'u bërë detar i vërtetë: mësonte ligjet e detarisë, njihej me mjetet e lundrimit, stërvitej në det të hapët. Dalëngadalë ai fitoi besimin në forcat e veta. Çdo punë kërkon vullnet, dashuri, durim. Këto cilësi ai i kishte fituar që kur punonte në brigadën e tij, në fshat. Këto i vlejten dhe në detyrën e re. Ai filloi të shquhej në mes të shokëve. Eprorët e çmonin dhe e sillnin si shembull. Kjo e gëzonte Ligorin, po ai ishte i pakënaqur nga vetja. Detari i ri mendonte se nuk kishte bërë asgjë të veçantë, veç detyrës që i kishte ngarkuar atdheu.

Ligori ishte përgatitur në shkollë për palombar. Kur mbaroi, e caktuan të shërbente në një anije palombarë. Ai tani e njihte detin jo vetëm nga jashtë, po dhe nga brenda. Palombari rrëmbecas ishte në gjendje t'i hynte detit në thellësi, të punonte atje poshtë në mënyrë krejt normale. Në stërvitje apo i ngarkuar me detyra të caktuara,

ai kishte zbuluar mina të vëna nga «armiku», kishte nxjerrë spiranca të rëna, kishte hyrë nëpër labirintet e anijeve të mbytura. Të gjitha këto, të duken fantastike, kur mendon se ç'ishte Ligori para disa kohësh. Ai tani ishte bërë detar i vërtetë, kishte mësuar të fshehtat e detarisë, ishte kalitur, trupi i qe bërë më i fortë, fytyra i qe ashpërsuar nga era dhe kripa, po tiparet i kishin mbetur po ato: i gjatë, trupdrejtë, me flokë të verdha kaçurela, me sy të kaltër... I tillë është dhe sot palombari Ligor Shishmeni. Po në jetën e tij kanë ndodhur ndryshime: atij i është ngarkuar një detyrë e rëndësishme. I kanë besuar të mirëmbajë një anije. Po, një anije të tërë luftarake. Prapë kjo gjë duket e çuditshme: si mund ta mbajë një njeri një anije? Po kur njihesh nga afër me Ligorin, atëhere bindesh se një njeri si Ligori mund ta mirëmbajë një anije, siç është palombarja e flotiljes sonë.

Përfytyroni një anije metalike, e shtrirë mbi det sa gjatë e gjerë, me urë komandimi në mes, me kabina e kubrike, me motorra e aparate të panumërta. Ajo është një fabrikë e tërë mbi ujë, që kërkon shërbim të përditshëm dhe këtë e bën detari Ligor Shishmeni.

Armiku më i madh i jetës së anijes është ndryshku. Ai hyn në anije pa u dukur dhe vepron në mënyrë të pabesë. Detari i vërtetë duhet të qëndrojë gjithnjë gati për ta luftuar në të gjitha mënyrat dhe në çdo kohë këtë armik të rrezikshëm. Ligori e bën këtë luftë përditë. Puna e tij fillon që kur gdhin e deri sa ngriset. Ajo është një punë që kërkon vullnetin dhe dashurinë e

një ushtari, njohuritë e një tekniku dhe kujdesin e një amviseje nikoqire. Mjetet e Ligorit janë fshesa, radaca, pecet. Ai i bën çdo ditë anijes pastrim të përgjithshëm, fshin kabinat dhe kubrikët, pastron bashin dhe kiçin, fshin kuvertën dhe bordet. Këtë e kryen me kujdes, nuk le asgjë të huaj mbi anije, sepse të lësh qoftë edhe disa bezhdila, kjo do të thotë t'i japësh fushë të lirë «armikut» të vrepojë. Pastaj fillon lufta me ndryshkun drejtpërdrejt; Ligori kruan me durim ndryshkun, kudo që është shfaqur, se ai shfaqet papandehur, pavarësisht se mund ta kesh pastruar një ditë më parë. Pasi e kruan me kujdes, e lyen me bojë dhe anija merr pamje. Kështu gjithë dita Ligorit i kalon me punë: herë fshin me leckë kuvertën e anijes, herë lyen me bojë rrathët e iluminatorëve e shkallët, herë grasaton motorët, e pastron aparatet. Ai nuk di të pushojë, bile edhe kur e thërrasin shokët e anijeve fqinje, s'ua vë veshin, pret të mbarojë punë dhe pastaj shkon të bisedojë me ta a të pushojë në kohë të caktuara.

Anija palombare shkëlqen e vetëtin nga larg. Kur ngjit shkallët për të hyrë brenda, të vjen keq të shkelësh sipër saj. Po Ligori të jep dorën për zemërsisht dhe të fton të hysh në anije. Të bën për vete pamja e tij e qeshur, thjeshtësia e tij dhe, tek e sheh anijen rreth e qark si nuse me tela, padashur e admiron këtë të ri të mrekullueshëm.

Ligori e ndjen vetminë e tij, kur deti trazohet keq. Në këto raste, ai shqetësohet pa masë. Anija, vërtetë është e akostuar, e lidhur me cima dhe e mbrojtur anash me jastikë gome, po në raste

të jashtëzakonshme, kur deti tërbohet, ajo ka rrezik të përplasët pas shoqeve të saj, ose të shkëputet dhe të dalë në tokë. Çaste të tilla e rrezikojnë jetën e anijes. Bile, një natë Ligori e pati punën pisk. Sapo kishte rënë të flinte, kur deti u trazua. Zuri të fryjë erë, dallgët filluan të rriten e të shpeshohen. Detari u zgjua dhe, ashtu siç ishte, doli në bash dhe vuri re se si anija lëkundej sa andej këndej. Cimat dhe kavot tendoseshin, dukej sikur një dorë e padukshme donte ta shkëpuste anijen nga bregu. Ligori mori masa, po ishte e kotë. Atëhere ai u kërkoi ndihmë shokëve të anijeve të tjera. Atë natë ai luftoi tok me shokët kundër dallgëve dhe stuhisë me një trimëri të pashoqe dhe në radhët e para, atje ku ishte rreziku më i madh, qëndronte Ligori, i zoti i shtëpisë. Të nesërmen, kur doli dielli, Ligori u gëzua kur pa se anija palombare nuk kishte pësuar gjë.

NË DET, NËPËR FURTUNË

Në mëngjez, kur anija luftarake u shkëput nga bregu, koha ishte e mirë dhe deti i qetë. Disa rë vetmitare, që endeshin nëpër qiell dhe ajo erë e ftohtë që frynte, nuk arrinin ta trazonin mendimin e detarëve që lundrimi do të qe i mbarë. Dhe vërtet, i tillë qe për disa mile. Një lundrim pa shqetësime, me lëkundje të zakonshme, me erën në favor, siç thonë detarët. Deti i kaltër vetëtinte nën rrezet e diellit, ndërsa përreth cijasnin pulëbardhat. Anija çante përpara, duke marrë me vete vazhden e shkumës së bardhë. Po papritur radisti i dorëzoi komandantit një njoftim pak të çuditshëm: «Koha shpejt do të priset. Do të ketë furtunë!»

Komandanti i anijes, Kamber Avdia, qëndronte në urën e komandimit dhe vështronte detin e qiellin. Ndjente se natyra fshehtazi po ndryshonte me shpejtësi të madhe. Përposht, deti kishte filluar të shqetësohej. Këtë ai e kuptonte nga lëkundjet e anijes. Era e kishte ndërruar drejtimin. Detari i vjetër i njihte mirë këto teka të natyrës në det të hapur. Diçka e rëndësishme po ndodhte. Dhe nuk kaloi shumë, kur horizonti në të katër anët

u mbyll nga retë. Deti, sikur të ndjehej ngushtë, erdh ë u ngrit më lart. Lëkundjet u shtuan. Dallgët u rritën. Era u bë më e fortë. Anija tani nuk e kishte të lehtë të çante përpara. Bashi i saj luftonte me dallgët e fuqishme, ndërsa gjithë anija lëkundej me forcë nga poshtë lartë. Ndonjë valë guximtare kalonte bordin dhe shpërndahej nëpër kuvertë.

Detarët qëndronin nëpër postet luftarake. Vështrimi i tyre herë pas here kthehej nga komandanti. Ai rrinte te ura e komandimit, i heshtur e i menduar. Ati i takonte e drejta të vendoste se çdo të bënin. Anija ishte në fillim të udhëtimit. Mund dhe të ktheheshin. Në rast furtune, kthimi në vendin e nisjes është një gjë normale. Po për detarët e vërtetë, edhe lundrimi në mes të furtunës, prapë është një gjë krejt e natyrshme. Bile komandanti i anijes luftarake këtë gjë e priste. Ai e kishte të ri ekuipazhin, detarët sapo kishin ardhur në anijen e tij dhe qenë të pa sprovuar në det të vështirë.

— Po afrohet furtuna, shoku komandant. Ç'do të bëjmë? — pyeti zëvendëskomandanti i anijes, tek vështronte detin e trazuar.

— Do të vazhdojmë udhëtimin deri në fund — iu përgjegj Kamberi i qetë dhe i vendosur. — Furtuna ka punën e saj, ne kemi tonën. Pse, si thua ti, të kthehemi?

— Jo, kush tha!! — ja bëri zëvendësi, që ishte i ri në detyrë dhe që s'donte kurrsesi të ngjallte dyshime, që u trembej vështirësive.

— Dëgjo këtu — thirri komandanti në mes erës që kishte filluar të ulurinte mbi dyrek. — Të gjithë detarët të qëndrojnë në vende ku s'ka

rrezik. Të sigurohen me të shpejtë materialet e lëvizshme.

Zëvendësi nderoi dhe zbriti me të shpejtë shkallët e urës. Pas pak, nëpër anije u dëgjuan sinjale e të thirrura. Detarët vraponin duke lëvizur me kujdes, sa në një anë në tjetrën. Ata mirrin masat e fundit për t'i bërë ballë furtunës që po afrohej. Anija çante dallgët me dhjetë mila në orë, kurse era sa vinte e shtonte shpejtësinë. Dallgët tani kalonin nëpër bash dhe valët e thërmuara spërkatnin detarët, që rrinin nëpër postet luftarake. Po ata, as që donin t'ja dinin: secili kryente detyrën e tij i qetë. Këtë e vinte re komandanti, tek lëvizte poshtë e lart nëpër anije.

U dëgjuaj zëri i bocmanit:

— Shoku komandant, djathtas, distanca dy mile. 45 gradë. një objekt!

Kamberi ktheu kokën nga e djathta dhe vështroi. Deti i errësuar buçiste, ngrihej e ulej parresh-tur e një gjë e zezë valavitej nëpër dallgë dhe nuk shquhej se ç'qe. Komandanti dha sinjalin e alarmit dhe urdhëroi të ndërrohet kursi. Tani anija lëvizte ngadalë në drejtim të objektit të panjohur. Të gjithë vrojtonin me kujdes. Mund të ishte dhe ndonjë minë. Po kur u afruan, objekti doli i qartë para syve të detarëve. Ai kishte një madhësi gati sa një e katërta e anijes. Ishte i tëri metalik, gjatosh dhe shumë i lëvizur... Komandanti, mbasi shquajti mirë objektin, urdhëroi që anija të ndalet. Ajo tani do të rrinte në mes të detit të stuhishëm me motor shuar. Bile pa spirancë, sepse thellësia ishte e madhe. Komandanti, me këtë gjë, donte ta vinte ekuipazhin para një prove të re. Situata të tilla i

kalisin detarët e rinj. Ai bisedoi me ndihmësat e tij dhe së bashku vendosën që objekti të lidhej pas anijes. Deti ndërkaq tërbohej përçark. Era grindej nëpër anije. Retë sikur t'i kishin tërhequr valët, ishin ulur poshtë. Furtuna sa vinte bëhej më e pushtetshme. Po ai grusht njerëzish në mes atij deti të çmendur as që desh t'ia dinte. Detarët e mbledhur në kuvertën e hapur dëgjonin në mes ulurimës së erës, zërin e fuqishëm të komandantit:

— Kush del vullnetar të shkojë të lidhë objektin?

Duart e fuqishme të detarëve të rinj u ngritën lart të gjitha njëherësh. Komandantit i rrahu zemra fort. Ai duhej tani ta zgjidhte vetë grupin, që do të shkonte të kryente detyrën e vështirë.

Pak-pak, në lanxhen*) që po zbriste hipi një grup detarësh me bocmanin Sherif Balliu në krye. Ata u ulën ngadalë mbi detin e shkumbëzuar dhe filluan me anë të remave të lundrojnë për nga objekti. Gjithë ekuipazhi ndiqte fatin e shokëve. Varka ngrihej majë dallgëve, pastaj humbiste diku thellë dhe veç kur dukej përtej, gjithnjë e më e vogël. Komandanti nga ura e komandimit vrojtonte dhe jepte urdhëra me porto-voçe.***) Varka po i afrohej objektit, po detarëve guximtarë u kanosej një rrezik i ri. Detyra e tyre ishte të lidhnin objektin me kavo***), por lidhja ishte shumë e vështirë. Tërë ajo masë metalike lëkundej e përplasej sa andej këndeje, si një kafshë stërmadhe e tërbuar.

*) Varkë. Varka të tilla mbajnë anijet me vete.

**) Një lloj hinge për të rritur volumin e zërit.

***) Litar çeliku që përdoret nëpër anije.

Detarët i vinin përçark dhe mundoheshin të gjenin çastin e vendin për t'i hedhur litarin e çeliktë. Kjo punë kërkonte jo vetëm guxim e shkathtësi, po dhe mprehtësi prej detari. Duheshin llogaritur mirë lëkundjet e objektit, mënyrat e lëvizjes së tij, forca goditëse e dallgëve, ndryshe ai do të binte mbi lanxhe dhe do t'i vinte detarët përfund. Kjo ishte një betejë e vërtetë, me një armik shumë më të fuqishëm, të egër e të pabesë. Ata kishin marrë me vete mjete shpëtimi. Bocmani ishte detar i vjetër. Anija, për çdo rast, u vinte pas, po këto, megjithatë, nuk i pakësonin vështirësitë e mëdha. Detarët hodhën kavon, po ajo nuk kapi, rrëshqiti sipër objektit dhe ra në ujë. Detar Petriti e tërhoqi kavon dhe e hodhi prapë me forcë. Një dallgë e fryrë u shemb mbi lanxhe dhe detarët për një çast u çoroditën. Ujët mbushi lanxhën. Njerëzit ranë mbi njëri tjetrin dhe për pak desh u përplasën mbi objektin metalik. Komandanti në anije u shqetësua, po grupi i detarëve e mori veten shpejt.

Buçiti zëri i mprehtë i bocmanit dhe, pas pak, thirrjet e gëzuara të detarëve, që era u jipte një kumbim të zgjatur. Kavoja u lidh! Komandanti mori frymë i lehtësuar. Lanxha filloi të vozisë për t'u kthyer në anije. Ndërkaq detarët e morën kavon dhe e lidhën pas kicët. Varka u ngrit nga ujët dhe të pesë guximtarët u ngjitën në bord.

U duk sikur rreziku kaloi. Anija mund të vazhonte lundrimin më tutje. Po para se të vijonte rrugën, ajo duhej të bënte kthesën, për të dalë me bash në kursin e caktuar. Dhe filloi të bëjë kthesën, po ky çast që i rrezikshëm për fatin e detarëve. Për pak, anija sa s'u përmbys. Përmes lëkundjesh

të mëdha, ajo u anua gjer në 35 gradë. Po detarët, duke zbatuar me përpikmëri urdhërat e komandantit, pa përfillur vështirësitë, e nxorën anijen nga gjendja e rrezikshme dhe ajo doli në kursin e caktuar. Çdo gjë u bë në heshtje, pa zhurmë. Njerëzit ishin të përqëndruar dhe në tension të vazhdueshëm. Komandantit, ndonëse situatat e rrezikshme e shqetësonin, prapë i vinte mirë që detarët e rinj po i kalonin mbarë sprovat e rënda.

Pasi morën prapë udhë, gjendja u normalizua. Anija luftarake çante dallgët përpara, duke tërhequr pas objektin. Ekuipazhi bëri një mbledhje të shpejtë. Komandanti Kamber Avdija falënderoi detarët Petrit Alluni, Xheladin Cjapi, Gjergj Shkurti, Mihallaq Kolvani dhe veçanërisht, bocmanin veteran Sherif Balliun.

— Ju — tha komandanti — kini vepruar si revolucionarë. Ju lumtë!

Deti ushtoi nga thirrja e fuqishme:

— I shërbejmë Republikës Popullore të Shqipërisë.

Pastaj detarët u shpërndanë nëpër postet e tyre. Sakaq komandantit i erdhi një radiogram. Bregu njoftonte se koha do të prishej më keq, ndaj anija duhet të shtonte shpejtësinë. Po a mund të ecte anija më shpejt? Kjo nuk mund të arrihej, sepse objekti prapa saj ishte i rëndë dhe një shpejtësi më e madhe do ta shkëpuste nga anija. Komandanti vendosi të mos e ndryshojë shpejtësinë. Anija vazhdonte rrugën drejt jugut. Po deti sa vinte vështirësohej më shumë. Dallgët ngriheshin si kodra dhe përplaseshin mbi anije. Shpesh bashi humbiste nga sytë e detarëve. Këtu shkumëzonte nga

valët e potershme. Era godiste me forcë si një rrjetë e padukshme. Shpejtësia e saj ishte rritur në kulm. Retë vinin e uleshin poshtë, aq sa deti dhe qielli ishin bashkuar në një. Nga të gjitha anët nxinte dhe dëgjoheshin ulurima me gjëmime. Deti kishte arritur shtatë ballë. Nata po zbriste me vrap. Kishte mbetur akoma dhe gjysma e rrugës. Në fytyrat e njerëzve dukej lodhja dhe mundimi — po asnjë nga detarët nuk ankohej. Asnjë nuk kërkonte të shtrihej në shtrat. Secili rrinte në postin e tij, lart në timon apo poshtë te motorrat, pranë radios apo sipër në vendin e vrojtimit. Fytyra burrërore e komandantit u jepte kurajo të gjithëve.

— Objekti u shkëput! Objekti u shkëput! — buçiti befas nëpër furtunë zëri i vrojtuesit. — Alarm në anije. Gjithë ekuipazhi u vu prapë në lëvizje. Ç'do të bënin tani? Objekti po largohej gjithnjë e më shumë në detin e stuhishëm.

Komandanti i ka të qarta detyrat. Ai jep me-njëherë urdhër që anija të lëvizë nga e djathta. Errësira e madhe ngrihej si një perde e zezë. Objekti tani nuk dukej gjëkund. Në anije u ndezën pro-zhektorët e fuqishëm. Drita e tyre zuri të kontro-llojë detin përfaq, duke rrëshqitur nëpër sipër-faqen e dallgëzuar. Lufta në mes dritës e dallgëve vazhdoi një kohë, deri sa shkëlqeu një kënd i objektit. Atëhere anija nisi të afrohet, ndërsa drita e saj mbikqyrte atë masë të harbuar çeliku. Ndër-kaq detarët zunë të zbrisnin sërish lanxhen në det. Kjo punë tani ishte shumë e vështirë. Lëkun-djet qenë aq të mëdha, sa lanxha mund të shka-tërronte bordin e anijes. Megjithatë, detarët, pas shumë mundimesh e lëshuan lanxhen në det. I

prirë nga bocmani, ekuipazhi i vogël filloi të vozitë. Drita e fuqishme ndriçonte herë lanxhen, herë objektin e hazdisur. Vozitja dukej sikur ishte e pamundur. Nuk të linin dallgët të çaje përpara. Nuk të linte as era e fortë. Megjithatë detarët i binin detit të tërbuar mespërmes. Dhe këtë e bënin jo me rrema, po me krahët e me gjoksin e tyre. Ata s'donin t'ja dinin për asgjë. Përlesheshin me dallgët dhe erën e zemëruar, me bindje se do të fitonin. Një qëllim fisnik i bënte revolucionarët e rinj të mos zbrapseshin para asnjë vështirësie. Anija për çdo rast u vinte prapa me kë. Po kjo i ngrinte dallgët akoma më shumë. Disa herë varka u mbush me ujë. Po ndërsa të tjerët vozisnin, dy nga detarët zbraznin ujët. Kësaj here ata iu afruan objektit nën dritën e prozhektorit. Herë-herë dritën e zinin dallgët dhe atëhere rreziku i përplasjes bëhej i pashmangshëm. Lanxha i shkante afër objektit, po detarët trima, duke i vërtitur rremat me shkathësi të madhe, dinin të manovronin dhe t'u shpëtonin goditjeve. Ata kishin marrë me vete disa shufra të gjata hekuri dhe me ndihmën e tyre krijonin largësinë e nevojshme, për t'iu shmangur përplasjes. Në luftë e sipër, bocmani Sherif Balliu u plagos, por ai nuk e dha veten, vazhdoi përpjekjet tok me shokët. Lufta tani ishte shumë e ashpër. Po njeriu ynë i mrekullueshëm dinte të ngrihej sipër dallgëve: i nxirrte gjoksin furtunës, përleshej me errësirën nënshtronte teknikën dhe dilte ngadhnyes mbi të gjitha. Kjo ishte një pamje heroike, që të mallëngjente e të bënte të ndjehe-she krenar që ata ishin shokë të tu, ushtarë të atdheut tënd.

Pas shumë përpjekjesh vetmohuese, kavoja e re u lidh përsëri pas objektit. Varka e ktheu drejtimin për në anije. Po era e fortë largonte anijen prej saj. Kodra dallgësh i ndanin ato nga njëra-tjetra. Ekuipazhit të vogël përsëri iu desh të manovrojë, të rrëshqasë sipër valëve të tërbuara dhe mezi të arrijë t'i afrohet anijes. Po sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, ngjitja në anije u shndërrua anë një betejë të vërtetë, Detarët me gjoks e me dhëmbë e ngritën lanxhen lart, pa i shkaktuar anijes as edhe një goditje.

Në bordin e anijes, nën dritën e prozhektorëve, ndërsa dallgët përplaseshin përfaq dhe era ulurinte e marrosur, detarët fitimtarë përfaqonin njëri-tjetrin. Komandanti i anijes, tek i shikonte, mezi i bënte ballë mallëngjimit. Detarët e rinj e kishin kaluar provën me sukses. Me njerëz të tillë, ai s'kishte detyrë që t'i ngarkonte atdheu e të mos e kryente.

Motorat u ndezën dhe zhurma e tyre jehoi e fuqishme. Anija u kthye në kursin e mëparshëm. Timonieri, me urdhër të komandantit, e drejtoi atë për nga baza e caktuar.

Pas tetëmbëdhjetë orësh lundrimi nëpër furtunë, duke kryer një detyrë të rëndësishme, në kushte shumë të vështira, anija luftarake u lidh në breg.

«BETEJË» NË DET

Anija jonë luftarake N. u shkëput nga bregu dhe mori udhë për në det të hapur. Unë kam qëndruar sipër, në urën e komandimit, ku syri më përfshin gjithë anijen dhe panoramën përqark. Pregatitjet e nisjes tani kanë marrë fund dhe secili detar gjendet në postin e tij luftarak. Anija çan hijerëndë përpara, ndërsa zhurma e fuqishme e motorave jehon sipër valëve. Nga megafonat herë pas here dëgjohen urdhërat e oficerëve. Flamuri valavitet lart në dyrek. Poshtë, në kuvertë, detarët lëvizin sipas urdhërave të komandantit të anijes. Zëri i komandantit, Heroit të Popullit Spiro Kote, buçet nëpër megafonet e anijes i plotë e i prerë. Ai ka qëndruar sipër, në urën e komandimit dhe që andej drejton anijet dhe veprimet e ekuipazhit. Për një çast, harroj se ku gjendem dhe vështroj Spiron. I veshur me gashup, me kapelen ngjeshur në kokë, shpatullgjerë e fytyrë zeshkët, me një pamje të qetë e vështrim të menduar, ai të kujton detarët e vërtetë për të cilët jeta nuk ka kuptim pa detin. Shoh Spiron, heroin e marinës sonë, dhe sepse më kujtohet rruga e Flotës Luftarake. Ai u lind dhe

u rrit bashkë me flotën. Afër njëzet vjet përpara, kur Spirua kreu atë akt të pashembullt, flota jonë luftarake ishte akoma në shpërgëj. Ne kishim atëhere gjithë-gjithë 2-3 motoskafe, të zëna trofe armiqve. Në një nga këto motoskafe, ku Spirua kryente shërbimin, ndodhi ajo që tani dihet nga të gjithë: tre trathtarë, të maskuar, e morën anijen dhe deshën të arratisen. Marinari trim, shkoi me armiqtë deri në mes të detit dhe pastaj, me një zotësi e trimëri të rrallë, i bëri pluhur e hi planet e armiqve dhe e ktheu anijen në atdhe. Atëhere Republika jonë sapo kishte mbushur motin dhe gjesti i lartë i ushtarit të popullit ishte një shprehje e gjallë e vendosmërisë së njerëzve tanë për ta ruajtur si sytë e ballit Republikën e re.

Këto më kujtohen, tek shoh Spiron që komandon tashti anijen luftarake. Dikur ai bëri një odise të gjatë për ta kthyer motoskafin në atdhe, sepse atëhere nuk dinte asgjë nga të fshehtat e detarisë, kurse sot ai ka në dorë fatin e një anije nga më modernet, të pajisur me një teknikë të lartë luftarake, e mbi të gjitha drejton dhe pregatit dhjetra detarë të rinj, ushtarë të mbrojtjes së atdheut.

Ekui-pazhi ynë ka dalë sot në det të hapur, i ngarkuar me detyra luftarake të rëndësishme. Detyrat i drejton komandanti. Ai tashti është i përqëndruar, jep urdhëra, merr të dhëna nga vrojtuesit e sinjalistët, komandon timonierin. Anija ka ndërërruar drejtim dhe ka marrë më të djathtë. Deti shtrihet para nesh sa gjatë e gjerë, me një kaltërsi që të lbyr sytë. Bregu tani po i humbet trajtat e veta dhe vështrimi s'të kap veç një kordon të lakuar, që sa vjen e mjegullohet. Pulëbardhat kanë

mbetur larg dhe ne jemi vetëm në tërë atë det, pa anë e fund.

Papritur përçark meje, sipër e poshtë, djathtas e majtas, buçasin zilet. Unë hap sytë dhe vë vesh. Në kuvertë shihet lëvizje e madhe. Në megafonet dëgjohen urdhëra të prera.

— Alarm!

Kthej kokën dhe ndeshem me fytyrën e qeshur të Paskalit, komisarit të anijes.

— Tani — thotë ai — nis detyra jonë luftarake...

Zilet kanë pushuar, ndërsa detarët kryejnë detyrën e re. Zëvendës komandanti, Lutfi Gjika, një djalosh lab, i shkathët e i prerë për ushtarak, ka dalë në urën e komandimit dhe u përsërit detyrat detarëve, të përhapur nëpër kuvertën e anijes. Për një çast bëhet heshtje. Dëgjohet vetëm buçima e motorave. Shoh se ngelem vetëm në urën e komandimit. Gjithë komanda e anijes më është zhdukur sysh. Vetëm detari Stavri Doko, një hap larg meje, qëndron mbi timon dhe vështron përpara me vëmendje. Mua se si më duket vetja, tek ngelem ashtu. Po unë ç'të bëj tani? Të mbaj shënime?!

Dëgjoj që prapa një zë.

Është Myfiti, një nga oficerët e anijes, që ka dalë nga kabina e tij dhe kërkon të më bëjë shoqëri.

E pyes: — Ku janë shokët?

— Janë mbledhur të gjykojnë situatën e krijuar. Sipas detyrës së dhënë anija jonë është ngarkuar të patrullojë. Imagjinoni se jemi në gjendje lufte. Është diktuar një «anije armike». Ç'duhet bërë tani? Këtë do ta vendosin.

Ndërkaq, bien përsëri zilet. Dëgjohen rishtas

zëra, urdhëra e komanda nga megafonet. Tashti, lëvizjet nëpër kuvertë janë më të shpejta. Ekuipazhi vepron me një saktësi të çuditshme. Detarët kanë zënë vend pranë armëve. Fytyrat e tyre janë bërë të rrepta e kjo tregon se ata e jetojnë thellë gjen-djen e krijuar. Për ta s'kanë rëndësi as lëkundjet e shpeshta të anijes, as era e fortë. Detarët dëgjojnë urdhërat dhe sipas varianteve të dhëna vepronë, duke lëvizur me shpejtësi sa në një anë në tjetrën. Situata luftarake ka arritur kulmin e saj. Spirua ka dalë sipër, në urën e komandimit. Pas tij shoh të shpërndahen nëpër anije gjithë oficerët. Vendimi është marrë: «armiku të qëllohet». Gjithë ekuipazhi është në gatishmëri. Dëgjoen urdhërat e Lutfiut. Teknika luftarake vihet në lëvizje. Kuverta e anijes menjëherë kthehet në një vijë fronti. Fillon beteja detare. Lufta në det ka jetë të shkurtër. Në këto beteja fiton ai që vepron më shpejt dhe di të godasë me saktësi. Dhe detarët tanë tregojnë se janë zotër të armëve edhe mbi dallgët e detit. Ata qëllojnë, qëllojnë pa rreshtur deri sa e «asgjësojnë» armikun.

— Zjarr në bash! — jehon zëri i komandan-tit të anijes.

Stërvitja kalon tani në një fazë tjetër.

Jepet një variant i ri luftarak. Kjo do të thotë se një predhë e «armikut» ka rënë në bashin e anijes. Në këtë kohë, detarët, me mjete të ndryshme hidhen në luftë për të shuar zjarrin. Atmosfera është shumë e nderë: anija ka rrezik të mbytet! Mendimi i parë që të vjen, tek sheh detarët e rinj, që «luftojnë» të drejtuar nga oficerët e tyre, është ky: me të tillë njerëz të mrekullue-

shëm mbrojtja e atdheut tonë është e siguruar!

Përsëri dëgjoj të bien zile. Detarët bëjnë lëvizje të reja. Një barkë e madhe përgatitet të lëshohet në det.

— Ç'është ajo barkë? — pyes me kureshtje.

— Shkojnë të çminojnë minat që ka vënë «armiku», — tregon oficer Faiku.

— Po shkoj dhe unë — i them dhe zbrës shkallët me të shpejtë.

Që sipër, nga ura e komandimit, buçet urdhëri i nisjes. Secili është ngarkuar me detyra të caktuara dhe kjo vozitje nuk është një shetitje nëpër det... Ne jemi nisur me misjon...

... Kemi zbritur në menci dhe presim të hamë darkë. Dita ka qenë e mbushur plot me ngjarje. Kompozitori Koço Uçi, me të cilin jemi bashkë, ka marrë kitarën dhe i bie. Fytyrat e oficerëve kanë marrë një pamje që ta kënda t'i vështrosh.

Deti, me sa duket, ka filluar të trazohet dhe këtë e ndjej nga lëkundjet e shpeshta. Mungon komandanti, Spirua, po dhe ai pas pak vjen. Sipas zakonit detar, vendi në krye të tavolinës i takon atij. Ai ulet dhe vështron nga unë me sy të qeshur:

— Do të kemi det sonte!

Detarëve kjo fjalë s'u bën përshtypje. Unë e Koçua shihemi në sy, po prapë nuk e bëjmë veten. Në këtë çast, kuzhinjeri na ka sjellë gjellën përpara.

... Vërtet, atë natë pati një det të rëndë. Po kjo nuk e shqetësoi ekuipazhin e anijes sonë. Përkundrazi, trazimet e detit qenë një stërvitje e re, me një armik tjetër, që i ndihmon armikut të vërtetë.

Kur u gdhi, natyra ishte qetësuar. Gjithë ai përbindësh, që shfreu e buçiti tërë natën e natës, tani qe zhdukur, sikur ta kishte përpirë deti. Qielli dhe deti i kaltër i buzëqeshnin njëri-tjetrit. Anija jonë lëkundej në ujrat e qeta të Adriatikut, ndër-sa toka jonë amtare fshihej prapa mjegullës bar-dhëllore.

Gjithë këto i shihja nga ura e komandimit. Rrija aty dhe ndjeja në shpirt një gëzim e krenari të thellë. Sodisja anijen tonë luftarake, njerëzit tanë të mrekullueshëm, që ishin zot të saj, admiroja bukurinë e forcës sonë të pamposhtur dhe përsëri më vinte mendja tek Spiroja, tek heroi ynë. Mendoja atë dhe për një çast më dukej se çdo detari ynë do të bëhej hero, po ta kërkonte mbrojtja e atdheut tonë socialist.

MONOLOGU I NJË LUFTËTARI

Kur shkova atë ditë në Shtab, gjeta plot shokë, që prisnin para zyrës së Degës politike. Disa rrinin ulur, disa bisedonin më këmbë, ndonjë qëndronte si mënjanë. Unë përshëndeta me kokë dhe iu afrova Alekos dhe Rizait. Pyeta se kush ishte brenda dhe pastaj nxora paqetën dhe ndeza një cigare.

— Si shumë u vonua ky Aliu! — tha Rizai.

— E ku i mbushet koka atij! — ja priti Alekua. — Të ka qëlluar të tërheqësh ndonjë material nga depua e Aliut? Ta bie shpirtin në majë të hundës. Nuk besoj të ketë burokrat më të madh në ushtri se Aliu ynë!

Unë qesha dhe me veten time u dhashë hak të dy shokëve. Përreth ishte qetësi. Njerëzit bisedonin pa zë. Në xhamat e dritareve të korridorit trokiste shiu i mërzitshëm i shkurtit. Kjo, sikur e bënte pak të rëndë pritjen. Befas kapiten Veliu ja mori ultazi një kënge labçe. Unë kundroja shokët.

U hap dera dhe doli Aliu.

— Të hyjë kapter Shefqeti... — dëgjova të

thotë ai, dhe ndërkaq vura re se ishte pak i tron-
ditur. Bëra çudi me veten, po s'pata kohë ta men-
doja thellë këtë gjë. E fundi, ç'kishte kjo, për të
menduar thellë? Po të kisha kohë, do t'i kisha thënë
Aliut, mu faqe shokëvet:

— Të rruashin thinjat, o Ali! Të kam ditur
më shumë se ç'je. Të kam pandehur burrë, po
burrat s'janë si ti!

Dëgjova zërin e tij që iu përgjegj një fjale, që
i tha kapiten Veliu:

— Kam hallin e gruas, shoku kapiten. Ajo,
dhe topin e karadakut t'i vësh, nuk luan nga
qyteti...

Me kumbimin e zërit të Aliut në vesh, hyra në
zyrë dhe u gjenda përballë tre burrave: shefit të
degës politike, komandantit tim dhe një shoku
tjetër, që nuk e njihja. Ata vërtet ishin tre burra,
po mua atë çast m'u bë një njeri. Ky njeri, që
ishte shok yni, kishte marrë përsipër të bisedonte
me ne, shokët e tij për një çështje të vështirë e
delikate. Gjersa Aliu doli që aty, me sy të për-
lotur, kjo do të thoshte se shokët që gjendeshin
përballë meje kishin marrë përsipër një detyrë të
rëndë. Ata më dhanë dorën dhe më thanë të ulem,
pa ja vënë veshin fare nderimit tim ushtarak.
Unë shikoja komandantin tim dhe ai më vështronte
me ca sy të qeshur, që dhe tashti i kam përpara.
Shefi i Degës mori fjalën i pari dhe tha:

— E kupton, Shefqet, përse të kemi thirrur?

Unë vura buzën në gaz dhe ja prita, pa të keq:

— Ne, ushtarakët, gjithnjë të thirrur jemi,
shoku kolonel. Nuk presim thirrje çdo ditë!

— Partia — foli komandanti im — na bën

thirrje të gjithëve, ushtri e popull, të shkojmë në fshat. Fshati ynë, me gjithë përparimet që ka arritur, prapë ka mbetur pas nga qyteti. Duhet ta ndihmojmë të gjithë...

Ndërsa ai fliste, mua m'u kujtua kapter Aliu dhe e mblodha menjëherë veten. Thashë me mendjen time: ky që po më shpjegon kështu, pandeh se mos dhe unë kam kokën e Aliut. Ja preva fjalën në mes:

— Të më falësh, shoku komandant që po ju ndërpres. Unë desha të thosha diçka që në fillim, në mënyrë që të merremi vesh më mirë. Ju që më kini thirrur këtu përpara, përfaqësoni partinë dhe komandën. Ju e keni thënë fjalën tuaj me kohë. Tani fjalën e kemi ne, apo e kam keq?

— Po, shok! — ja bëri ai shoku që nuk e njihja, — nuk e ke keq. Ne jemi mbledhur pikërisht, për të dëgjuar fjalën tuaj...

— Atëhere më dëgjoni — ja prita unë menjëherë, i shtyrë nga mendimet që më buçisnin në kokë. — Unë dëshiroj që, para se të dal prej këndeje, t'i them ato që mendoj e që ndjej. Është kollaj të thuash «po» ose «jo» dhe pastaj të ikësh me zemër të thyer a të grindesh me veten. Jo, shokë, unë të gjitha do t'i them këtu para partisë dhe, pasi t'i kem thënë, s'ka zot të më lëkundë nga e imja.

— Ju e dini se kush jam unë, komandanti më njeh mirë, shokët më njohin, kuadri i ka dokumentat e mia të plota. Unë, pra, jam shoku juaj, jam një luftëtar, si gjithë të tjerët. Duke u gjëndur përballë jush, para se t'i përgjigjem thirrjes që bën partia, dua të tregoj diçka për jetën time: Kush isha unë e kush jam. Të më falni që do t'i

bie gjatë, për të dalë atje, ku dua të dal. Ju s'e dini mirë se kush isha unë para dhjetë vjetëve; ç'bëja atëhere dhe ç'dëshiroja. Ju dini vetëm kaq: që jam fshatar, nga aksh fshat, po ju s'e dini ndofta se, për të zbritur e për t'u ngjitur gjer atje në fshatin tim, dikur duhej të bëja një ditë e një natë rrugë nga qyteti. Atje nuk e njihnin as biçikletën e maqinën e lëre pastaj trenin. Ju mund ta merrni me mend se shkolla së pari, në fshat tonë, u hap pas çlirimit, që njeriu më i ditur i fshatit ishte hoxha. Po ju nuk e dini se shumica e burrave të fshatit tonë vdisnin nga dora e hasmit dhe fanatizmi na kishte verbuar. Ju s'e dini që unë, gjersa u bëra 13 vjeç, nuk kisha zbritur kurrë në qytet dhe s'kisha lexuar asnjë libër, veç Abetares. E pra, jeta ime ndryshoi, kur më thirrën ushtar. Zbrita me rrobe shajaku, me qeleshe në kokë, me një shami në qafë, që ma kishte dhënë nëna, dhe pashë botë, si i thonë fjalës. Hyra në ushtri dhe aty fillova nga e para. Merrni me mend: mësova si duhet ecur, bëra shkollë, u njoha me njerëz më të mirë se vetja, m'u hapën sytë. Kur u ktheva në fshat për herë të parë fshati m'u duk i vogël. E jo vetëm kaq, po dhe i prapambetur. E pse të mos e them! Ndryshe jetoja në repart e ndryshe në shtëpi. Sigurisht në fshat gjeja dashurinë dhe mallin për prindërit, për farë e fisin, për shoqërinë e vjetër, për tokën... Po më shumë më tërhiqte reparti; më dukej sikur bota atje ishte më e madhe, sikur çdo gjë, që ëndërroja dhe dëshëroja në jetë, do ta arrija në ushtri. Fshati, se si më dukej ashtu, vërtet i bukur, dhe i tillë është me gjithë mend, ngritur në një luginë të bleruar, midis dy

maleve të larta, i pasur me drurë e me ujra, me bagëti e shpezë, që të ka lezet shpirti, — po i rrethuar me maja malesh; mua më ngjante sikur ato e ndanin fshatin nga jeta e madhe që zjente nëpër katër anët e vendit tonë. Dhe një ditë vendosa: atdheu kërkonte të qëndroja në ushtri. Komanda më bëri thirrje dhe unë ndenja si nënoficer i karrierës. Vëllezërit i kisha në fshat; tashti ata ishin rritur dhe s'ishte e thënë të rrija dhe unë atje. Babait nuk para i pëlqente që unë të largohesha nga vatra e shtëpisë: «Ç'të keqe kam pasur unë që s'undava nga fshati!» — thoshte ai. Po unë nuk e dëgjova atë. Tashti kisha shokë, që më donin si vëllezër. Pse të mos ecja dhe unë përpara, si gjithë njerëzit, që u jep dorën partia. Ju, shoku komandant, keni qenë vetë i pari, që më thate: «Qëndro në ushtri, se atdheu ka nevojë për punën tëndë». Dhe unë ndenja. Ndenja, jo vetëm pse e ndjenja veten gjithnjë ushtar me mend e me zemër, por edhe sepse tashti isha bërë komunist. Domethënë se tashti mund të kontribuoja më shumë: më ishin ngarkuar detyra të reja, kisha filluar shkollën e mesme, isha ngritur në përgjegjësi. Dhe ju e dini se punët nuk më kanë shkuar keq. Kam pasur gëzim në detyrë. Ju e dini dhe jetën time personale: duke qenë në radhët e ushtrisë u martova e u bëra me fëmijë, me shtëpi. Pa dashur, unë e gruaja filluam ta hiqnim veten si qytetarë. Këtë e vija re, sidomos kur më vinin nga fshati pleqtë e vëllezërit. Shikoja se kishim bërë ndryshime. Të tjera zakone dhe të tjera mendime kishim unë dhe ime shoqe. Jeta këndeje kishte bërë të sajën më shpejt, se sa do ta bënte në fshat.

Po prapë në shpirt ne kemi mbetur fshatarë. Sa herë na merr malli për fshatin! Qejfi na e ka të dëgjojmë zilen e bagëtivet! Në vjeshtë e në pranverë, sa herë lërohen arat, mua ma do zemra të thith erën e tokës. Pastaj, si mua dhe gruas na e ka qejfi të kemi në shtëpi ndonjë bagëti a një tufë pulash. Pra, qytetarë jemi me pashaportë, po në shpirt prapë kemi ngelur fshatarë. Nuk tharrohet kollaj balta e fshatit!

Sa herë kam marrë lejen e zakonshme, jam kthyer në shtëpi. Më ka tërhequr malli për njerëzit dhe vendin. Mallin, thonë, nuk e tret as dheu. Po veç kësaj ndjenje, gjer tashti zor se mund të më ketë lidhur gjë tjetër me vendlindjen. Më dukej sikur unë kisha punët e mia dhe fshati të tijat. I takonte Ademit, Saliut dhe shokëve të mij të tjerë, që drejtonin kooperativën, të merreshin me përparimin dhe rregullimin e fshatit. Unë mjafton të veja t'i vizitoja një herë në vit, ku një drekë, ku një darkë, nëpër dasma e xhenazera, se, helbe-te, jetë i thonë kësaj. Më pëlqente të rrija me kostumin më të mirë, me çizme të llustruara, bile vija, me raste, dhe atë dekoratë që kam. Kështu si unë, mbahej edhe gruaja. Lere pastaj fëmijët, që e mbanin pak hundën lart në mes vërsnikëve të tyre. Ndonjëherë, kur më kapte veshi ndonjë fjalë a romuz që hidhej për ne, të ardhurit nga qyteti, nuk më vinte mirë. Kjo më bënte të mendohesha. Po kush e kishte fajin për ndryshimet që kishim bërë? Ne, apo ata? Fshati, sigurisht kishte ndërruar. Nuk ishte ai, që kisha lënë unë dhjetë vjet të shkuara. Njerëzit nuk rronin si atëhere. Qe ngritur kooperativa, qe hapur shkolla shtatë

vjeçare, fshati lidhej tashti me rrugë automobilistike, kishte vatër kulture, një ndihmës mjek... Por prapë unë vija nga qyteti dhe fshati, megjithatë, më dukej fshat. Ju e kuptoni se ç'dua të them...

Po nga ana tjetër, s'do t'ju thoja gjithë të vërtetën, po të mos ju tregoja dhe diçka me rëndësi. Ka pasur raste që unë kam menduar seriozisht për fshatin tim dhe, jo vetëm kam menduar. Ju e dini, shoku komandant, që vetë detyra ime në repart më ka bërë të lidhem me teknikën. Studjoja elektricitetin me kapiten Spiron dhe më shkonte mendja tek fshati, që rronte me kandil. Doja që dhe fshati ynë të kishte dritë elektrike, si shumë fshatra të tjera të vendit. Dhe një ditë i shkova kapiten Spiros në ofiçinë dhe bisedova me të. Spirua, si inxhinier që është, më pyeti për vendin, për lumin që zbret sipër fshatit dhe pastaj më tha se do ta studjonte çështjen. Vetë komanda e ndihmoi inxhinierin dhe bashkë me të vajtëm në vend. Biseduam me shokët e mi atje dhe ja bëmë dermanin, gjetëm një dinamo të mirë. Ca me fondet e kooperativës, ca me ndihmën e repartit, fshati ynë u bë me dritë elektrike. Kjo që ndihma ime e parë dhe e fundit. Sigurisht bëja ndonjë gjë për ta, po çfarë për shembull? U çoja prindërve ndonjë lek, interesohesha për bashkëfshatarët e mi t'i shtroja në spital, kur vinin të sëmurë, prisja e përcillja miq nga fshati në shtëpi, u jepja ndonjë mendim atyre të kryesisë së kooperativës, kur më pyesnin... Me kaq e kisha fjetur mendjen se çdo gjë shkonte në rregull. Unë këtu, ata atje; unë në punën time, ata në punën e tyre. S'më kishte shkuar në mendje se, ndonjë ditë, po të qe nevoja,

mund të bëhesha dhe unë pjesëtar i kolektivit të tyre. Bile kujtoja se fshati mburrej me mua, që më kishte në qytet dhe, natyrisht, unë gëzohesha për këtë. Po puna s'paska qenë kështu si mendonim unë e ti. Diçka dukej që nuk ecte. Shumë njerëz të aftë dhe të nevojshëm për fshatin ishin grumbulluar nëpër qytete. Partia e kuptoi këtë mirë dhe bëri Thirrjen, që e dinë të gjithë. Partia po na thotë se fshati, sado që ka ecur përpara, prapë është pas nga qëllimi i lartë, që ka socializmi. Fshati nuk duhet ndihmuar si deri tashti, siç kemi bërë unë e ti, duke çuar lekë e letra, fjalë e përshëndetje, duke pritur e përcjellë në shtëpi farë e fis e miq të ardhur që andej. Partia, me sa kuptoj unë, me thirrjen e saj, don të thotë: po qe se të dhimbset fshati, po qe se nuk e ke harruar baltën, shko atje, në mes të bashkëfshatarëve të tu dhe lufto tok me ta për ta çuar përpara. Fshati kërkon njerëz të aftë, me eksperiencë, me shkollë. Socializmi nuk ndërtohet vetëm duke rregulluar qytetin. Qyteti është vënë në rrugë të mirë, po shiko fshatin! Sa punë ngelen për t'u bërë! Të paktën unë kështu e shikoj.

Gjithë këto ditë e kam menduar mirë këtë punë. E kam menduar si komunist, dhe komunistët nuk dijnë se ç'është rehati dhe interesi personal. E kam vënë veten time tamam në këmbë të atij që ngrihet, me shtëpi e me katandë, dhe shkon andej nga ka ardhur. Do të gënjeja, po të thoja se këtë gjë e kam bërë kollaj. U bënë dhjetë vjet që jetoj në qytet, në mes të shokëve të re-partit. Pra, s'e kam pasur dhe s'e kam të lehtë, po jo të pamundur, siç u tregua këtu para jush kap-

ter Aliu. Ai punon gati njëzet vjet me radhë si magazinier në depot tona. Atë nuk e ka vrarë asnjëherë këpuca, përkundrazi është mykur, duke ndenjur gjithnjë në një vend, duke shkruar fletë-hyrje e fletë-dalje, me «si urdhëron» e me «lepe-peqe». Rroga rrogë, veshja veshje, shtëpia shtëpi. Rreth e qark me bahçe, me shpezë, me lopë... E pse ta prishë rehatin Aliu! Tashti ai thotë: «Më mirë vramë, se sa të më dërgosh në fshat». Jo, shokë, unë nuk jam Aliu. Unë jam gati të mos ndahem nga shokët, të shkoj në fshat dhe të punoj me shpirt, siç punoj këtu. Njeriu nuk rron për veten e tij, apo qoftë dhe për gruan dhe fëmijët. Njeriu është vërtet njeri, kur i përgjigjet Thirrjes së atdheut dhe, tok me shokët, lufton për një qëllim të lartë. Ju kështu më kini mësuar. shoku komandant, kështu na ka mësuar partia dhe unë këtë s'e harroj, sa të jem gjallë...

Ma bëni hallall që u zgjata. Ma bëni hallall dhe ju, shok, që i mbajtët shënim tërë këto, që ju tregova. Po të doni, tregojeni dhe emrin tim. Më quajni Shefqet Dauti...

FLAMUR NË STUHI

Kur horizonti nxihet në perëndim dhe era vjen e shton shpejtësinë, kur deti zë e fryhet e buçet dhe dallgët përplasen me potere të madhe në breg, detarët janë gjithnjë të shqetësuaar për fatin e anijeve. Në këto raste, porti është në alarm. Stuhia që ka shpërthyer thellë në det, vrapon drejt bregut. Detarët vihen të gjithë në lëvizje. Anijet, që gjenden në radhë, hyjnë me të shpejtë në port. Të tjerat, që rrijnë ankoruar pranë bregut, përforcohen me cima të fuqishme. Ngado që të hedhësh sytë, natyra duket e zemëruar. Deti gjëmon parreshtur. Shigjetat e vetëtimave çjerrin qiellin e nxirë. Ushtojnë sirenat e anijeve. Njerëzit thërrasin nga të katër anët. Pulëbardhat e trembura vërtiten, duke këlthitur përreth anijeve. Deti shfryn e dallgëzon me një zemërim të papërmbajtur. Tek rri buzë tij, të duket sikur gjendesh para një humnere, mbushur me ujë që zjen e valon me tërsëllimë. Mbi dallgët e azdisura anijet lëkunden si të ishin kutia shkrepesesh. Deti i egërsuar mund të lozë e të bëjë si të dojë me to. Po në këto çaste, kur natyra e verbër s'di ç'bën,

duket forca dhe madhështia e njerëzve tanë. Ata sulen mbi stuhinë, si të ishin stuhi vetë. Sulen me tërë forcat e mjetet e tyre, për të ruajtur nga rreziqet anijet, që qëndrojnë në mëshirën e dallgëve. Në sfondin e zymtë të detit të egërsuar, kur dhe anijet e mëdha mezi u bëjnë ballë dallgëve të fuqishme, detarët tanë u ngjajnë zgalemëve që luftojnë me stuhinë. U ndodha për disa çaste atje, atë ditë, kur ekuipazhi i guximtarëve të Bigës së madhe po përleshej me detin e përbindshëm. Unë po kaloja rastësisht andej, po njeriu nuk mund të mos qëndronte hapat para asaj pamje. Detarët e bigës po luftonin me heroizëm. Heroizmi në jetën tonë nuk është një fjalë e bukur. Ai është luftë, punë, sakrificë në emër të një qëllimi të madh. Para meje njerëzit tanë po bënin heroizëm, pa menduar fare se po bënin një gjë të tillë. Ata luftonin për të ruajtur bigën, për ta shpëtuar pasurinë e popullit. Këtë ata e quanin detyrën e tyre, një detyrë krejt të natyrshme, paçka se armiku ishte shumë herë më i fuqishëm. Guximi dhe vendosmëria e tyre tregonte se në ato çaste ata nuk e përfillnin as jetën. Po, as jetën. Gjithë ajo pamje e paharruar këtë gjë tregonte: jeta e tyre i ishte blatur një ideali fisnik! Unë nuk i njihja përsëafërmi ata njerëz të guximshëm, po dija se ata ishin njerëzit tanë, detarët tanë, se në mes tyre kishte komunistë, që prinin në ballë. Dhe nuk u gabova. Duke ndjekur me ankth betejën e tyre, për mua u bë i njohur e i shtrenjtë ai grusht trimash të pamposhtur. Ja, si tashti e kam parasye njërin prej tyre, atë që bënte ballë kudo dhe nuk rreshtte një çast. Ai ishte vin-

çieri Adem Reka, që e njihnin të gjithë përçark e që unë nuk e njihja gjer atë çast. Po ç'rëndësi kishte ta njihja më parë! Unë po e njihja tani, në një situatë të jashtëzakonshme, në një provë të madhe që mendja e njeriut mezi e rrok. Ai vërtitej në kuvertën e bigës si në një arenë matedorësh, duke u ndeshur pa pushim me një kundërshtar të mbifuqishëm. Përfytyroni një njeri me trup mezatar, sipër kuvertës së bigës, që lëkundet me forcë sa andej këndeje, një njeri me një shkathhtësi të çuditshme manovron e u shmanget me zotësi goditjeve të erës, të dallgave, të mjeteve përçark... një njeri që nuk di ç'është lodhja e rreziku, po qëndron gjithnjë në këmbë, gjithnjë në lëvizje, gjithnjë atje ku është lufta më e vështirë. Dhe lufta më e vështirë ishte lidhja e cimave. Në këtë punë ishin përqëndruar gjithë forcat e ekui-pazhit dhe në krye të saj gjendej Ademi.

Stuhia në det sa vinte e bëhej më e egër, dallgët e fuqishme përplaseshin mbi bigë dhe ajo masë gjigande përpiquej me ngulm të shkëputej nga bregu. Cimat, litarët e çeliktë, me të cilët e kishin lidhur pas bankinës së betonuar, nuk mjaftonin për ta mbajtur. Sa më shumë tërbohesh stuhija, aq më tepër ato tërhiqeshin e tendoseshin. Biga është mjaft e ndjeshme ndaj dallgëve. Sipaş ligjeve të detit, sa më i rrafshët të jetë fundi i nënujshëm i anijes, aq më të mëdha janë lëkundjet. Dhe kur lëkundjet janë të mëdha, forca tërheqëse e detit është e tmerrshme. Deti bën çmos t'i shkëpusë anijet nga bregu e pastaj di ai si rreket me to. Këtë gjë të tmerrshme e dinin shumë mirë Ademi me shokë. Duhej mposh-

tur me çdo mënyrë kjo forcë ogurzezë. Ja, cimat ishin tendosur në kulm. Ndonjëra prej tyre u këput. Biga vërtitej si e azdisur. Lëkundej gjithë baza e saj, kulla e madhe e vinçit gjigand, dridhej si një ndërtesë shumëkatëshe nën tronditjet e një tërmeti të fortë. Rreziqet ishin të gjithan-shme. Furia e stuhisë dukej sikur po tundte nga themelet çdo gjë. Do të vinte një çast, me ato lëvizje të furishme që bënte biga, të këputej boshti kryesor i saj. Kjo do të ishte katastrofë. Po katastrofa mund të ndodhte edhe ndryshe. Duke u këputur cimat një nga një, ajo do të ishte krejt e lirë dhe, si një kafshë e tërbuar që s'e bëjnë dot zap, do të godiste ku të mundte. Atëhere fati i bigës do të qe fatal. Mund të shembej pas bankinës së betonuar dhe të dëmtohej vetë e të prishte molon, po kishte më tepër mundësi që të përplasej pas anijeve të tjera dhe t'u binte në bark e t'i çante në mes. A mund të lejonte Ademi që biga e tij, ndihmësja e detarëve në punën e tyre të mundimshme, të godiste anijen «Dajti»? Në ato çaste të rënda, komunisti Adem Reka ishte i ndër-gjegjshëm për situatën e ndërlikuar, për pasojat dhe rreziqet e mynxyrshme. Ai që ishte shqetësuar dhe kishte vënë jetën në rrezik për një arkë mallrash të rënë në fund të detit në shkarkim e sipër, ai që ishte zhytur në fund të detit për të shpëtuar armën e një ushtari, ai që ishte hedhur sa herë, pa asnjë ngurim në ujë për të nxjerrë njerëz që po mbyteshin, ai që kishte zbritur në thellësi të mëdha, duke hyrë në labirintin e anijeve të fundosura, ai ishte gati tani të jepte jetën njëqind herë, vetëm që biga të shpëtonte,

që anijet tona të mos pësonin gjë, që pasuria socialiste të mbetej e paprekur. Dhe Ademi do ta bënte këtë, sepse ai ishte komunist, njeri i kalitur në kudhrën e partisë sonë, i rrahur e i çelnikosur në vështirësitë e pengesat e ndërtimit socialist. Ai do ta bënte këtë, se nuk ish hera e parë që tregohej në lartësinë e luftëtarit pararojë. Kush e di sa herë ai kishte treguar ndërgjegjën e madhe prej komunisti, shpirtin e rrallë të sakrificës, duke u gjendur atje ku e kishte dashur puna, ku rreziku ishte më i madh, ku e lypte interesi i popullit, atje ku e kërkonte nderi i partisë.

Ademi kishte ardhur vetë, vullnetarisht, në këtë betejë, ashtu siç shkon luftëtari i ndërgjegjshëm në luftë, pa urdhër e komandë. Atë mëngjez nëntori, kur stuhia kishte filluar të sulmonte portin, ai ishte në shtëpi, me gruan e me fëmijët. Turnin e kishte mbaruar disa orë më parë. Ishte e drejta e tij të pushonte. Ai edhe mund të rrinte në shtëpi dhe luftën me stuhinë ta bënin të tjerët. Po një qëndrim i tillë është i huaj për komunistin revolucionar. Një qëndrim të tillë as që e merrte me mend Adem Reka. Biga është e të gjithëve, po dhe e secilit. Ai kishte vendin e tij, postin e tij luftarak në betejën e pabarabartë me stuhinë. Ademi duhej të gjendej sa më parë në sheshin e luftës. Kjo ishte thirrja e ndërgjegjes revolucionare, thirrja që nuk të lë të rrish në një qoshe të ngrohtë, thirrja që të ngre në këmbë dhe të shtyn të vraposh në luftë kundër çdo armiku. Kjo thirrje e bëri Ademin të ngrihet menjëherë në këmbë, të lejë mënjane interesin personal, të sakrifikojë kohën e pushimit, përkëdheljen e gë-

zimin e fëmijëve e të shkojë atje, ku e thërriste detyra, lufta për mbrojtjen e pasurisë së popullit.

Dhe ja tashti, ai lufton në vijën e parë. Përkrah ka Ramazanin dhe Hakiun. Më tej vepron kapiteni i bigës, Osmani. Gjithë ekuipazhi është përhapur nëpër kuvertë dhe lufton pa rreshtur me stuhinë. Duhet lidhur medoemos cimat. Vetëm ato mund ta bëjnë zap bigën e çmendur, që orvatet me çdo kusht të shkëputet nga bregu. Dhe kjo nuk është një fjalë goje. Njeriu mbi bigë, tani e ka vështirë të qëndrojë në këmbë, pa le pastaj të punojë. Po Ademi nuk do t'ja dijë nga lëkundjet e tërbimshme të bigës. Ai qëndron i fortë, me këmbë të mbërthyer mbi kuvertë, duke u bërë ballë dallgëve që përplasen dhe e godasin papushim, erës e shiut të ftohtë që si një rrjetë e akullt e rrethojnë nga të gjitha anët dhe përpiqen t'i lidhin duart. Po duart e Ademit janë më të forta se çeliku i cimave. Ato janë si dara të fuqishme, që vërtiten sa andej këndeje me një shkathtësi të habitshme. Njeriu i zakonshëm mezi do t'i mbante në duar ata litarë metalikë, kurse detari i sprovuar jo vetëm i mban, po i lëviz, i drejton, ashtu siç ja lyp nevoja. Duart i janë nxirë e gjakosur, veçse Ademi nuk do t'ja dijë. Atë e ka rrëmbyer një ide e madhe, një ide fisnike: të shpëtohet pasurija e popullit me çdo kusht! Një ide e tillë mposht dhembjen, të ftohtit, çdo ndjesi fizike. Duart e Ademit janë bërë si kalune e spila. Nëpër to vërtiten e rrëshqasin cimat, që të çjerrin e të gjakosin, po ai duron në heshtje, pa u kujdesur fare për veten. Ademi edhe

trupin do ta bënte kalunë, një bosht mbështetjeje, vetëm biga të shpëtonte nga rreziku. Po kjo ishte e pamundur. Atëhere gjithë përpjekjet e Ademit ishin përqëndruar në punën e vështirë që ta lidhte bigën me cimat. Në këtë punë ai përdorte tërë përvojën e tij prej detari, tërë forcat, gjithë guximin dhe shkathtësinë e tij. Se aty ishte si në një betejë të vërtetë. Armiku i padukshëm me furinë e tij të verbër nuk dinte ç'të bënte më parë për ta mposhtur atë grusht trimash. Dhe sikur të dinte ku të godiste, goditi më trimin e trimave. Ademi atë kohë po tërhiqte cimën, për ta hedhur në kalune, kur nga një tronditje e fortë e papritur cima doli nga shpila dhe, si një zvaranik i përbindshëm, ra me forcë mbi të dhe e rrëzoi përtokë. Po detari guximtar nuk e dha veten. Duke mposhtur dhembjen e tmerrshme, ai u ngrit përgjysëm nga kuverta dhe u thirri shokëve:

— Shpëtoni bigën! Kapiten, hidh spirancat!

Kjo ndodhi një ditë nëntori, pothuaj një javë pasi ishte mbyllur Kongresi i Partisë. Ademi nuk kishte patur fatin të ishte delegat atje. Po mendimet e mëdha të raportit të shokut Enver Hoxha ai i kishte bërë të mendjes e të zemrës. Këtë e tregojnë ato paragrafe të raportit, që ai kishte nënvizuar me kujdes. Po këtë, e dëshmon mbi të gjitha sakrifica e lartë.

Ajo ndeshje gjigande me dallgët e stuhisë e shndërroi Ademin në një flamur të kuq, që thërret gjithnjë për fitore të reja.

NË DRITËN E PROZHEKTORËVE TË BARDHË

— Ju jeni i vëllai?

— Si urdhëron!

Ai kishte çapëluar sytë dhe vështronte i trembur.

— Gjendja e Selmanit është shumë e rëndë...

I panjohuri i fshehu menjëherë sytë pas qepallave dhe mbeti një çast i shtangur.

Dr. Margarita vazhdoi:

— Ne bëmë çdo gjë që kishim në dorë... —
Ndjeja se zëri i saj mezi e mbante peshën e dhembjes — Si mendoni, do ta merrni në shtëpi?

Ai ngriti qepallat dhe unë vura re shkëlqimin e lotëve të burrit.

— Po sikur ta shihte njëherë edhe ai! — ja bëri i panjohuri me zë të dredhur.

— Cili?!

— ...Doktori!

— Sëmundja e tij tanimë është e qartë — tha e qetë Dr. Rusheni. — E keni kot.

Fytyra e të panjohurit u prish.

— E di, e di — nxitoi të shpjegonte ai —

ju kini bërë shumë për tim vëlla, po sepse nuk gjej karar... Dua ta shohë dhe një doktor!

— Po dhe ne, këtë punë bëjmë.

Ai uli kokën si një fëmijë i zënë në faj dhe nuk u përgjegj. Dr. Rushen vështroi nga unë dhe buzëqeshi hidhur. Në fillim, i prekur nga ngjarja, nuk e vura re fytyrën e mjekes. Po shpejt e marr vehten dhe shoh skenën para meje: I panjohuri që rri kokulur dhe doktoreshën që buzëqesh. Atëhere kujtohem dhe kuptoj se gjendem përpara një rasti, që më interesonte drejt për drejt. Unë kisha shkuar në klinikën e parë të Spitalit kirurgjik të Tiranës që të shkruaja një reportazh për 8 marsin dhe ja, jeta më hapte përpara një skenë të çuditshme: dhe në një çast aq tragjik nxirrte kokë një paragjykim i vjetër. Nga një anë kisha dy kirurget, Dr. Rushenin dhe Dr. Margaritën, që kishin operuar e mjekuar një të sëmurë për disa muaj me radhë, dhe në anë tjetër një qytetar të panjohur, që u ishte vërtetë mirënjohës mjekëve, po prapë besimi i tij përpëlitej në kthetrat e paragjykimeve; ai kërkonte kundër arësyes së shëndoshë që t'ja shihte të vëllanë për të fundit herë dhe një mjek, d.m.th. një burrë! Nuk di sepse e ndjeva veten ngushtë tek qëndroja ashtu dëshmitar i heshtur. M'u duk sikur ai besim instinktiv i atij qytetari të panjohur në superioritetin e aftësive të burrit ishte pa dashje një fyerje, që u bëhej jo vetëm dy kirurgeve, po edhe neve burrave që ndodheshim aty rastësisht. Provova atë çast një ndjenjë aspak të këndëshme, por kjo nuk vazhdoi shumë. Të dyja kirurget bënë sikur nuk i vunë re fjalët e tij, dhe në heshtje, u morën vesh me njëra tjetrën.

— Mirë, shok — dëgjoj zërin e Dr. Margaritës — me që ju paska mbetur merak, do të thërrasim edhe një doktor ta shohë...

I panjohuri nuk shtoi më asnjë fjalë. U dha dorën mjekeve dhe, pa i ngritur sytë, doli jashtë.

Unë mezi e mbaj zemërimin. Them:

— Nuk bëri mirë ai që foli ashtu. Ju fyeu pa të drejtë...

Kirurgët buzëqeshin.

— Nuk ka gjë, — thotë Dr. Margarita — jemi mësuar me këtë mosbesim. Fakti është se këto skena tani janë raste të rralla...

Hapet dera dhe në dhomën e mjekut hyn një infermjere.

— Doktoresha, salla është gati. Ta çojmë të sëmurin?

— Çojeni... — urdhëron Dr. Rusheni dhe pastaj kthehet nga unë:

— Ju do të asistoni?

— Po.

— Kini asistuar ndonjëherë në ndonjë operacion?

— Jo.

— Mos ju bije të fikët?

Unë s'di të përgjigjem dhe vë buzën në gas. Doktoresha vë re gjendjen time dhe më shpjegon:

— Operacioni që do bëjmë sot nuk është nga më të rëndësishmit, megjithatë, ne çdo operacioni i japim rëndësi të madhe. Sot, siç do ta shihni, do të operojmë një fshatar nga **Malësia** e Tiranës. Ai është rrëzuar nga një lartësi e madhe dhe ka thyer keq krahun. Operacioni do të vazhdojë gjatë,

prandaj ju lutem uluni dhe çlodhuni mirë. Unë po shkoj në sallë të shoh gjendjen.

Dr. Rusheni del së bashku me Dr. Margaritën dhe unë mbetëm në dhomë me mjekët e rinj Dr. Xhuvelin dhe Dr. Zogun.

— Kush do të operojë sot? — i pyes.

— Të dyja bashkë — më përgjegjet Dr. Xhuveli duke shikuar nga dera dhe pastaj shton: — Janë nga kirurget e para të shëndetësisë sonë. Dr. Margarita ka dhjetë vjetë që punon në këtë sektor, Dr. Rusheni shtatë. Siç do ta shihni, profesioni i kirurgut është shumë i vështirë. Ai veç forcës fizike, kërkon aftësi e përgatitje të veçanta. Imagjinoni, të rrish disa orë më këmbë, të luftosh me vdekjen për t'i shpëtuar jetën një njeriu... Po të dyja kirurget e klinikës sonë kanë dhënë rezultate shumë të mira...

— Dhe ju këtu punoni — i drejtohem Dr. Zogut.

— Po, të dy jemi stazhierë. Përgatitemi për kirurgji:

— D.m.th. kini ardhur të mësoni zanatin tek gratë? — u them me të qeshur, duke pasur parasysht skenën me qytetarin e panjohur.

— Po, nuk ka asnjë dyshim. — Dr. Zogu përgjigjet me një vendosmëri të tillë sikur don të ndreqë atë padrejtësi, që u bë para disa minutave.

— Ashtu është — hidhet Dr. Xhuveli. — Ato tregohen po aq të zonjat, sa edhe kirurgët e tjerë dhe nuk lënë rast për prapamendime.

Biseda jonë u ndërpre, se hyri një infermiere dhe na ftoi të vinim në sallë. Dolëm të tre dhe, përpara se të hynim në sallë, vumë skufjet dhe maskat. Kur u futëm brenda, kirurget po bënin

pregatitjet e fundit. Kishin larë duart dhe po vishnin petka të stirilizuara. I sëmuri, një meso burrë me mustaqe, trup madh e muskuloz, rrinte shtrirë sa gjatë e gjerë në tryezën e operacionit. Një grup studentësh të kursit të tretë të fakultetit të mjekësisë kishin zënë vend në të dy anët e tij. Në sallë dëgjohen pëshpëritje të lehta. Dr. Rusheni u jep urdhërat e fundit ndihmësve. Pregatiten dhe afrohen tek i sëmuri aparatet dhe instrumentat. Ndizen prozhektorët dhe një dritë e bardhë bie mbi të sëmurin. Ngjan sikur në atë rreth të ngushtë drite u përcaktuan kufijt e be-
tejës. Qetësia sa vjen e bëhet më e plotë. Pregatitjet e kirurgeve marrin fund dhe ato tani i afrohen tryezës së operacionit. Shoh rreth tryezës, veç dy kirurgeve, dhe të tjerë njerëz. Pyes Dr. Xhuvelin që kam pranë me atë profaninë time:

— Këta u bënë shumë! Kush do të operojë më parë?

Ai buzëqeshi nën maskë dhe këtë e shoh nga sytë.

— Do të operojnë Dr. Rusheni, Dr. Margarita, ndërsa të tjerët do të ndihmojnë. Operacioni është gjithnjë punë kolektive.

— Domethënë operacionin do ta drejtojnë kirurget?

— Po, po. Kjo ndodh shpesh në klinikën tonë. Këtu punojnë disa kirurge.

— Bëni inxheksionin — jep urdhër Dr. Rusheni.

Zëri i saj tani është i prerë dhe i vendosur. Unë hedh sytë nga i sëmuri. Ai qëndron serioz dhe i heshtur, me vështrim të tendosur, pa lëvizur asnjë qepallë. Pranë dorës së të sëmurit që-

ndron Dr. Margarita. Te koka rri me aparatën e narkozës Dr. Hilmia. Dr. Rusheni i jep zemër me vështrimin e saj të ngrohtë. Fshatari s'di ç'të bëjë. Ka ngulur sytë në një pikë dhe kushedi se çfarë mendon në atë të tijën. Mua më bëhet sikur thotë me vete: «Heu, më paskan vu gratë poshtë! «Ndofta për një çast atij i është lënduar sedra patriarkale e burrit, që e ka ndjerë veten gjithnjë zot mbi gruan. Po prapë s'dua ta besoj. Shoh fytyrën e tij të qetë dhe mundohem t'i largoj këto mendime. Më vjen mirë të mendoj se ky fshatar, që mund të jetë i mbushur me paragjykime për gruan si shumë shokë të versës së tij, që nga çasti që ja ka lënë në dorë jetën këtyre grave, do të fillojë të besojë më shumë në forcën dhe aftësinë e gruas. Ndërsa jam dhënë pas këtyre mendimeve, i sëmuri dalëngadalë e ka humbur vetëdijen. Inxheksioni ka bërë punën e tij. I japin narkozën dhe marrin masa për të drejtuar frymëmarrjen me anën e një aparati. Tani mund të fillohet fare mirë nga operacioni. Dëgjoj tringëllimin e bisturive e të instrumentave të tjerë. Dr. Rusheni dhe Dr. Margarita, të armatosura, përkulen mbi të sëmurin dhe nisin betejën... Shoh sytë e tyre të tendosur dhe nga kjo kuptoj se ka filluar prerja. Shtrëngoja dhëmbët dhe marr guximin... Hapja është një vijë e gjatë horizontale në llërën e shëndoshë të burrit. Mundohem të mos i ul qepallat. Pamja e gjakut është gjithnjë e rëndë, po veprimet e dy kirurgeve janë aq të përpikta e të shkathta, sa unë tërhiqem më shumë pas mjeshtrisë së tyre, se sa pas plagës. Instrumentet veprojnë në drejtim të fijeve të muskujve dhe pas çdo prerje ato lidhin

me shpejtësi enët e vogla të gjakut për të kufizuar hemoragjinë.

Sipër kokës së të sëmurit qëndron varur filmi i krahut të tij. Në dritën e prozhektorit vërej kokën e thyer të ndarë keq më dysh.

Beteja në tryezën e operacionit vazhdon. Pasi janë mënjanuar shtresat e muskujve dhe është kaluar rreziku i prerjes së arteries brakiale, instrumentët veprojnë në drejtim të kockës. Ka kaluar gati një orë e ca. Tani fillon puna më e rëndë: duhen afruar kockat e ndara. Dy kirurget nuk pushojnë për asnjë çast. Ndërrohen instrumentët, procesi i operacionit vazhdon. Kocka e të sëmurit është e rëndë dhe nuk don t'ja dijë. Instrumentet zëvendësojnë njeri tjetrin. Lëvizjet janë të zgjatura. Tensioni i punës arrin kulmin. Tani çdo luhatje, çdo gabim, sado i vogël, shkakton nervozizëm. Dëgjohen urdhëra të gjymtuara dhe zhurma e instrumentëve në kockë. Infermieret e sallës mezi përballojnë kërkesat e njëpasnjëshme.

Unë filloj të ndjej lodhje dhe e humbas vëmendjen për një çast. Po goditja e një çekiçi më bën ta kthej prapë vështrimin në tryezë. Dr. Margarita i bie me çekiç një shtize çeliku që të hyjë në kockë. Goditja është e fortë dhe e prerë, aq sa më ngjethet mish-të, po i sëmuri nuk ndjen asgjë. Vetëm gjoksi, që i ngrihet e i ulet nën qarçafin e bardhë, e bën të gjallë. Çekiçi hesht dhe Dr. Rusheni drejton shpinën. Shoh sytë e saj të lodhur.

— Të vijë radiollogu!

Kanë kaluar dy orë e gjysëm plot. Puna s'ka mbaruar. Tani duhet mbyllur plaga. Dy kirur-

get nisin të qepin dhe ky është një proces i ngadalshëm, sadoqë më i lehtë se i pari. Tani tonet e ngjyrës së kuqe ndërrojnë, deri sa plaga vjen e mbyllet krejt. Qepja është bërë e plotë dhe e hijshme, sa mua më ngjan si një gjerdan i punuar imtë.

Dy kirurget, tani, sikur i dhanë fund punës së tyre. Ngrejnë kokën dhe shohin nga ne. Pastaj bëhet grafija për të parë rezultatin. Dhe vërtet filmi i vendosur në dritën e bardhë të prozhektorit tregon se dy pjesët e kockës së krahut janë bashkuar plotësisht. Kthehem e vërej dy kirurget. Sytë e tyre, sado të lodhura, shkëlqejnë nga një dritë vezullonjëse. Tani ka mbetur puna për t'u vënë krahun në allçi. Me këtë gjë fillojnë e merren asistentet. Dr. Rusheni dhe Dr. Margarita zenë e çlirohen nga instrumentat dhe «uniforma» e operatorit. Zhveshin dorezat, heqin maskën, zbulojnë kokën, pastrohen. Në sallë tani është prishur qetësia. Të gjithë bisedojnë e komentojnë.

Unë u afrohem mjekeve dhe u shtrëngoj dorën. Ato prapë qëndrojnë pranë të operuarit dhe japin urdhërat e fundit. Dora e të sëmurit ka dalë jashtë çarçafit dhe është e nderur në drejtim tonë. Ajo është e madhe, muskuloze, plot kallo, tamam dorë burri. Ndërkohë, dy kirurget i ngrejnë duart dhe ja lëvizin për t'u çliruar nga dridhjet pas operacionit. Pa dashur, syri im nis e krahason. Duart e kirurgeve janë relativisht të vogla, të holla e delikate. Po megjithatë, ato duar luftuan me vdekjen, shpëtuan nga gjymtimi këtë burrë të fuqishëm.

Nuk do të kalojë shumë kohë dhe fshatari

nga Malësia do ta ndjejë sërish të gjithë krahun të tijin. Me atë krah të fuqishëm ai do të ngasë prapë me parmendë në fushat e kooperativës, do të rrokë e do të ngrejë përpjetë rishtas vajzën apo mbesën, që e pret në shtëpi, me atë krah ai do të shtërngojë edhe pushkën po të jetë nevoja!

Unë jam i sigurtë se ai, fshatari nga Malësia u është mirënjohës për jetë dy kirurgeve dhe si çdo shqiptar dëshëron domosdo t'ua shpërblejë. Ndofta kërkon ndonjë rast dhe nuk kujtohet vërtet nuk e di se më 8 mars është festa e gruas. Atij, si dhe shumë burrave, akoma nuk u është bërë zakon t'i urojnë gratë në këtë ditë. Po pas operacionit, që i bënë dy gra, jam i sigurtë se fshatari do të ketë kuptuar një gjë mirë: gruaja sot në vendin tonë, nuk është më ajo që njeh ndofta ai dhe brezi i tij. Ajo është po aq' e fortë dhe e aftë sa dhe burri!

Dhe duke menduar këtë, pyes:

A nuk është ky ndryshim në mentalitetin e fshatarit të Malësisë urimi më i mirë, që mund t'u bëhej dy kirurgeve me rastin e 8 marsit?

THIRRJA E NDËRGJEGJES

Ai ishte një punëtor i zakonshëm, i kategorisë së katërt. Asnjëherë nuk kishte tërhequr vëmendjen e të tjerëve për ndonjë gjë të veçantë. Normën e plotësonte rregullisht, respektonte orarin e punës, u vinte veshin urdhërave të përgjegjësve të tij. Nuk ishte në radhën e të dalluarve, por as ishte kritikuar, sa të bëhej siç thonë, problem i kolektivit. Punëtorë të tillë gjen plot nëpër kantieret dhe fabrikat tona. Ky ishte punëtori Shefki Rama, anëtar i brigadës së zdrukthtarëve të portit detar të Durrësit. Emri i tij lidhet me një ngjarje, që e bëri të njohur atë në tërë qytetin.

Ishte koha, kur gjithë vendi diskutonte Thirrjen dhe Letrën e hapur. Për këtë bisedohej edhe në qëndrën e punës së Shefkiut. Njerëzit flisnin, propozonin, kritikonin. Ata bisedonin jo vetëm për shifrat e planit të katërt pesëvjeçar, por edhe për mbarëvajtjen e punës së tyre.

Shefkiu rrinte e dëgjonte me kujdes dhe mendja i shkonte tek puna e tij dhe e shokëve të

brigadës. Në repartin e Shefkiut ndërtonin e meremetonin karrocëritë e automjeteve. Ai kishte disa vjet që punonte në këtë repart, bashkë me Lutfiun, Nexhatin, Muharremin, Andonin e të tjerë; të gjithë shokë e pothuaj vërsnikë me të. Në brigadën e tyre bënë pjesë edhe punëtorë veteranë, si Abdullai dhe Beqiri. Në mbledhjen e brigadës Shefkiu bisedoi për Thirrjen e për planin. Diskutimi u zgjerua dhe punëtorët zunë pastaj të flisnin dhe për punën e tyre, për vetë brigadën. Në diskutim e sipër doli çështja e normave. A ishin reale normat me të cilat punonin ata? Shokët e Shefkiut propozuan që koha për ndërtimin e një karrocërie të paksohej. «Sa mirë, — mendoi Shefkiu, — që e ngritën këtë problem!» Por prapë ai nuk foli, siç nuk flet shpesh. Ai nuk është mësuar të diskutojë, aq më tepër të bëjë ndryshe nga kolektivi. Shefkiu vjen nga natyra i mbyllur, ndaj kur është puna për të dhënë ndonjë mendim, ai bashkohet me shumicën, me të drejtën, ndjek vijën e partisë. Po ato ditë, kur u bisedua çështja e normave, ai ndjeu, pa dashur, se nuk ishte dakord me shokët e brigadës. Bile kur doli nga mbledhja e bëri rrugën për në shtëpi me Minellën, brigadierin. Nuk e mbajti dot kundërshtimin që kishte përbrenda dhe ja tregoi atij. I tha se koha e punës për ndërtimin e karrocërive mund të ulej akoma. Brigadieri e dëgjoi, po sikur nuk ja vuri veshin. Ndofta s'ishte dakord me shokun e tij.

Shefkiu vazhdoi ta rrahë me vete idenë që i kishte lindur. Shumë gjëra po diskutoheshin tani. Partia thoshte: «Shokë punëtorë, thuajeni si gjithnjë fjalën tuaj!» Pse të mos e thoshte edhe

Shefkiu fjalën e tij? Mund të gabonte? Mundet. Ai ishte i ri dhe nuk ishte marrë ndonjëherë me diskutime të tilla të rëndësishme. Pastaj, nuk para dinte të fliste mirë. Që të jepje një mendim, duhej të shprehesh qartë, aq më tepër një mendim si ai që kishte Shefkiu në kokë. Ideja ishte e drejtë, por sepse i ngatërrohej kur zinte e arësytonte. A i takonte, bie fjala, atij të fliste, për normat? Ato ishin studiuar nga lart. Për normat kishte rregullore të posaçme, të firmosur nga vetë ministri. Këto rregullore i mbante normistja. Zakonisht, ajo normonte punën, shpërblente ligjërisht mundin e secilit në repart. Pastaj, arësytonte Shefkiu, rregullorja ishte hartuar nga njerëz kompetentë, të cilët kishin patur parasysh jo vetëm repartin e Shefkiut, por gjithë repartet e Republikës. Ata e dinin praktikën e punës, fuqinë e punëtorit, bazën teknike. Sigurisht, punëtorët mund të kërkonin t'i bëheshin ndryshime rregullores dhe për këto ata kishin propozuar. Kishin thënë që karrocëritë mund të pregatiten në 70 orë dhe jo në 75. Ky ishte mendimi i gjithë brigadës, i shtatë shokëve të repartit të zdrukthtarisë. Por Shefkiu nuk ishte tamam i një mendimi me ta. Shumë prej tyre mund të qenë punëtorë më të zot, ishin dalluar në punë më shumë se ai, qenë më të vjetër në profesion, por prapë në çështjen e normave nuk mendonin drejt. Ai e dinte si punohej në repartin e tyre: gjatë orarit të punës punëtorëve u mbetej kohë e lirë, u qëllonte të rrinin orë të tëra kot, të merreshin me muhabete dhe, kur vinte fundi i pesëmbëdhjetëditëshit, të paguheshin rregullisht, bile të paguheshin edhe për mbi normën. Kjo mund të duket e çu-

ditshme, po për anëtarët e brigadës së Shefkiut ishte krejt normale. Rregullorja e normistes e njihte si të drejtë, e përligjte tërthorazi kohën e lirë, të kaluar kot, dhe i shpërblente punëtorët me të holla për muhabetet dhe shakatë që bënin. Kështu ishte shpërblyer shumë herë edhe vetë Shefkiu. Por ç'do të thotë kjo? — pyeste punëtori me vete. Sigurisht, rregullorja është rregullore, por edhe puna është punë. Rregullorja duhet t'i përgjigjet me të vërtetë punës, ndryshe ajo nuk ka si të jetë e vlefshme. Pra, nuk vlen rregullorja e normave që përdoret në repartin tonë. Ajo duhet parë prapë. Le ta gjykojnë vetë punëtorët. Vetë Shefkiu i kishte gjykuar normat me punën e tij dhe shokëve të repartit. Ato nuk ishin reale, s'ishin të drejta. Këtë do t'ua provonte shokëve. Natyrisht, me fjalë mund të mos shprehej bukur, mund edhe ta kundërshtonin, s'ishte lehtë të ngrilheshe para gjithë atyre burrave dhe t'i arësyetoje gjërat fill e për pe, aq më tërër, kur nuk e ke provuar në praktikë. Por Shefkiu prapë ishte i bindur për atë që mendonte dhe, fundi, kryesoren do ta thoshte qartë. Pse të mos ngrilhej e të fliste? Mjaft kishte heshtur.

Në një mbledhje që u bë, ai u ngrit e tha:

— Ne në repartin tonë punojmë me hile. Duam s'duam, ja hedhim shtetit. I marrim shtetit më shumë nga sa na takon. Pse? Mua më duket se normat janë shumë të ulta. Prej kësaj vjen që ne paguhemi edhe për kohën e lirë. Unë propozoj, shokë, që për ndërtimin e karrocërive norma të vihet jo 70 orë sa u propozua, por 35.

Në sallë ishte bërë zhurmë: një pjesë e kishin pritur me lhabi, të tjerë e kishin kundër-

shtuar, disa kishin qeshur, asnjë nga shokët e brigadës nuk ishte ngritur ta përkrahte punëtorin guximtar. Bile edhe ata, që drejtonin mbledhjen, për një çast kishin heshtur. Propozimi i Shefkiut ishte një gjë krejt e papritur... Kish diferencë të madhe nga propozimi i brigadës: 70 me 35 orë! Pastaj Shefkiu, e pse të mos e themi, nuk është ndonjë punëtor i dalluar, as punëtor i vjetër s'është. Por megjithatë besimi dhe guximi i punëtorit ishte aq i madh sa mendimi i tij u mor seriozisht nga komisioni i propozimeve...

Pas kësaj mbledhjeje, atë ditë e të nesërmen Shefkiun e kishin zënë me radhë shokët e brigadës dhe i kishin folur. Dikush i kishte thënë se kish bërë marrëzi, një tjetër e kish qortuar seriozisht: «Mor Shefki, ç'bërë ashtu, na more në qafë!» «Një shok i afërt i kish thënë haptas: «Pse i hap telashe vetes dhe të tjerëve? Rri, ore, shih punën tënde!» Bile një komunist, që rrinte në bisht të situatës, e kish ndaluar dhe i kish folur: «Për shkakun tënd më bërë të zihem me organizatën!».

Po, me organizatën! Përballë mosbesimit, presionit dhe indeferentizmit të shokëve të brigadës së Shefkiut u vu organizata bazë e partisë. Ajo e përkrahu kërkesën e punëtorit të repartit të zdrukthtarisë dhe atij iu dha e drejta që ta eksperimentonte vetë i pari propozimin e bërë. Për këtë u interesuan komiteti i partisë i ndërmarrjes, bashkimet profesionale, dhjetra punëtorë të portit detar... Zakonisht, kjo punë në repartin e zdrukthtarisë kryhet nga një punëtor. Pra, Shefkiut do t'i duhej që çdo gjë ta bënte vetëm. Mendoni t'i hyni një pune, kur shumë nga shokët tuaj

nuk ju kuptojnë, kur tek punoni ju rrethojnë vështrime mospërfillëse apo tallëse, kur mundoheni për një gjë të drejtë dhe prapë shokët tuaj nuk ju japin asnjë ndihmë. Megjithatë, fryma revolucionare, që ngjallën Thirrja dhe Letra e hapur, zgjimi i ndërgjegjes së klasës, e bënë atë punëtor të thjeshtë t'i hyjë punës me vullnet e guxim.

Ekspërimentin e tij Shefkiu e nisi nga dyshe-meja e karrocerisë. Shokët merreshin secili me punët e tyre, por ai e ndjente se tërthorazi ata i ndiqnin veprimet e tij. Këtë ai e vuri re vetëm në fillim, pasi më tej e rrëmbeu puna. Punonte me kujdes, kursente lëvizjet e tepërta, u largohej bisedave të panevojshme. Puna zuri të ecte mbarë. Kur mbaroi dyshe-menë, ai ngriti kokën dhe, i dërsitur e me një gëzim të papërmbajtur, vështroi nga shokët. Ata bënë sikur nuk e vinin re gëzimin e tij. Lutfiu godiste i vrenjtur me çekiç, Abdullahi i kishte kthyer kurrizin, Minella shkante nga një maqinë në tjetrën. Andoni dhe Dhimitri diç bisedonin. Por prapë Shefkiu nuk ua mori për keq. Kur u bë pushimi, ata hëngrën bukë tok, biseduan (sigurisht, jo për karrocerinë), bënë ndonjë shaka, pastaj dolën së bashku nga puna. Dita e parë e eksperimentit kishte shkuar bukuri: ai e kishte kryer punën në gjysmën e kohës që duhej zakonisht.

Shefkiu ndjente se në mes tij dhe shokëve ishte ngritur padrejtësisht një pengesë që duhej kapërcyer. Ai ishte i bindur që ata s'kishin të drejtë, aq më tepër kur, pas ditës së parë, qëndrimi i tyre u bë i çuditshëm. Ditën e dytë Shefkiu filloi të ndërtojë kapakët anësorë të karro-

cerisë. Kjo punë ishte pak e vështirë. Kërkonte mund e forca, s'i bënte ballë dot një njeri. Për të ngritur një kapak duheshin të paktën dy njerëz. Shefkiu u mundua që edhe këtë ta kryente vetë, por e pa që nuk e bënte dot. Shokët e vunë re dhe nuk i vajtën në ndihmë. Shefkiut s'i erdhi mirë. Nuk mendonte se do të arrinin gjer këtu. Ishin shtatë burra, shokë të tij, të shpërndarë nëpër repart, që e shihnin se kërkonte ndihmë dhe nuk lëviznin nga vendi. Por Shefkiu nuk e bëri veten. U ngrit, u kaloi përpara dhe shkoi e thirri një shok nga reparti fqinj. Bashkë me të, ai ngriti kapakun dhe e afroi te dyshemeja. Pastaj erdhën procese të tjera. Përsëri shokët nuk i vajtën në ndihmë; përkundrazi, ndonjë dhe e pengoi. Shefkiut i dëlhej të hapte disa vrima në kapakët dhe këtë do ta bënte me trapë*). U kërkoi shokëve trapën dhe njëri prej tyre i dha një trapë me një metër tel. Teli i shkurtër i hapte telashe Shefkiut. Atij iu desh të rrotullonte gjithë karrocërinë e rimorkios për ta afruar tek priza. Shokët e shikonin dhe prapë nuk i vinin në ndihmë. Shefkiu e shtynte karrocërinë vetë, i lodhur e pak i fyer, me merakun se mos i lumbiste koha, por me vendosmërinë që të shkonte më tej. Puna vazhdoi kështu edhe ditën e tretë. Ditën e katërt, ajo po i afrohej fundit. Çdo gjë po dilte ashtu siç kish parashikuar ai. Karrocëria tani ishte ndërtuar për bukuri. Këtë punë punëtori Shefki Rama e kish kryer normalisht jo në 75 orë, sipas rregullores, as në 70, siç propozonin shokët, bile

*) një lloj tryele elektrike.

as në 35 orë, siç kishte propozuar vetë, por në 34 orë!

Kur e mbaroi karrocerinë, Shefkiu, qetë-netë, kishte kaluar përmes repartit dhe kishte vajtur për të njoftuar drejtorinë. Pastaj kishte ardhur komisioni, e kishte parë dhe kishte vërejtur se çdo gjë ishte bërë në rregull dhe brenda normave të caktuara. Të nesërmen Shefkiu kishte filluar provën e dytë. Kësaj here ai e pati më lehtë. Karrocerinë e dytë e ndërtoi në 30 orë!

Tani brigada e zdruckthtarisë nuk kish asnjë argument që ta kundërshtonte normën e re. Shefkiu nuk kishte bërë asgjë të jashtëzakonshme, përkundrazi, kishte punuar normalisht. Puna e tij e rregullt kish nxjerrë në dukje dobësitë e punës së brigadës, orët që ai kishte shkurtuar, ishin orët e lira që punëtorët kalonin kot, ishin muhabetet dhe shakatë në kohën e punës, ishin shpërblimet e pamerituara. Rregullorja e normave, e hartuar vite të shkuara, nuk merrte parasysh faktin që baza teknike e repartit sot nuk ishte ajo e dikurshmjës.

Në një mbledhje, që bëri pas eksperimentit, brigada diskutoi dhe pranoi sinqerisht propozimin e Shefkiut. Punëtorët dënuan mosbesimin, skepticizmin dhe indiferentizmin që kishin treguar ndaj shokut të tyre. Ata patën burrërinë pastaj të pranojnë dobësitë në punë dhe shqyrtuan normat, jo vetëm për karrocëritë, por edhe për pjesët e tjera të automjeteve.

Tani Shefkiu dhe brigada e tij punojnë me norma të reja. Ai është ngritur në kategorinë e gjashtë. Njerëzit janë bërë më të kujdesshëm në

punë. Punojnë më mirë, lëvizin më pak, bëjnë më pak muhabetë të kota. Koha, siç thonë ata, është bërë më prodhuese. Shpërblimet jepen më vend. Këto janë frutet e mendimit që shfaqti para shokëve punëtori Shefki Rama me rastin e Thirrjes dhe Letrës së hapur. Por megjithëse bëri këtë provë të madhe, ai përsëri ka mbetur një punëtor i thjeshtë: kryen normën rregullisht, nxjerr punë me cilësi të mirë, vjen me orar në punë, u vë veshin urdhërave të përgjegjësve të tij. Shefkiu i takon ushtrisë së madhe të klasës sonë punëtore, gjesti i tij është shprehje e ndërjegjes së saj të lartë revolucionare.

RINIA NË FUSHË

— Ju mund të flini se jeni i lodhur — më tha veterineri. — Unë po shkoj edhe njëherë nga stalla, të shoh një lopë të sëmurë. Natën e mirë!

Ai doli, duke mbyllur derën nga prapa dhe unë mbeta vetëm në atë dhomë të huaj, ulur mbi një krevat prej dërrase. Pa dashur, hodha sytë rreth e qark. Çdo gjë aty të kujtonte një dhomë të zakonshme beqarësh: krevate të pa rregulluar mirë, një dollap gjysëm i hapur, radioja dhe librat të lëna sipër një tavoline të rëndomtë... Këtu do të flija dhe unë, në krevatin e zooteknikut që ishte me shërbim. Gjendesha në një nga sektorët e largët të fermës së Sukthit. Gjithë ditën kisha bredhur fushave, sa në një brigadë të rinisë në tjetrën dhe tashti e ndjeja veten të lodhur. Kish ardhur tamam koha e gjumit, po si zakonisht, para se të bija, mora blokun e shënimeve dhe zura të hedh përshtypjet e fundit.

Kisha kaluar një ditë të bukur, sado të lodhshme, në mes të rinjve të shkollave që prashisnin parcelat e misrit. Isha njohur me njerëz të ndry-

shëm, më kishte prekur hovi dhe këmbëngulja e të rinjve në punë, më kishte mbetur në mend peisazhi i gjallë e plot jetë i fushës: gjelbërimi me variacionet e veta, siluetat e njerëzve dhe të teknikës në sfondin e fushës, vijat e drejta të parcelave që treteshin në horizont. Dita kishte qenë plot mbresa. Po rrija i menduar me blokun në dorë, kur pa prituri u hap dera dhe hyri një njeri i panjohur. Dhoma jehoi nga një zë i kumbueshëm.

— Mirëmbërëma!

Ai më dha dorën dhe u ul në krevatin që kisha në krah. Unë mbylla blokun dhe ai e vuri re këtë gjë.

— Ju kini ardhur për këta të rinisë, apo jo? — pyeti i panjohuri.

— Po, — i thashë dhe pastaj shtova: — Dhe ju këtu punoni?

— Këtu po, jam agronomi i sektorit.

— Kini shumë?

— U bënë, besa, nja pesë vjet!

Kështu dalëngadalë ne filluam të bisedojmë për bujqësinë e për njerëzit e saj. Agronomi ishte i dhënë me mish e me shpirt pas punës së tij. Bir malësori, kishte kryer studimet disa vjet përpara dhe tashti punonte në këtë sektor të largët, pa u ankuar për asgjë.

Si kaloi biseda e parë, agronomi u çua dhe, duke buzëqeshur ja bëri:

— Më falni, unë do të rruhem pak se jam bërë si prift. Kështu e ka kjo puna jonë në këtë kohë. Tashti sa u ktheva nga fusha.

Ai përgatiti veglat e rojës dhe zuri të rruhej.

Unë isha ngritur ndenjurr dhe shihja agronomin. Ai ishte një burrë, afër të dyzetave: i gjatë e fruplidhur si malësorët, me fipare të theksuara, me flokë të prera shkurt, me lëkurë ngjyrë bronxi.

— E gjitha kjo punë — zuri të flasë rishtas agronomi — është menduar bukur: Rinia duhet ta njohë punën dhe të kalitet me kohë. Ju kujtohen shekurudhat: unë atyre u detyrohem shumë. Këtë traditë rinia jonë duhet ta vazhdojë brez pas brezi. Sigurisht, në fillim nuk është kollaj. Unë që jam marrë gjithë këto ditë me brigadat e rinisë, e di mirë këtë gjë. Ata kanë ardhur në fushat tona nga bangat e shkollës. Shumica studjojnë për t'u bërë artista. Njeri i bie pjanos, tjetri violinës. Një palë mësojnë për kanto, të tjerë studjojnë për teatër. Ka qytetarë, po ka dhe fshatarë. Me punën fizike janë marrë rastësisht, kurse tashti u duhet të punojnë një muaj të tërë në fushë të hapët, me shpatë në dorë...

Agronomi kishte kohë që shkumbonte mjekrën, i tërhequr pas bisedës, dhe kur unë ja kujtova këtë, ai tundi kokën dhe vijoi prapë mendimet e tij:

— Vështirë e patën në fillim. As diellin nuk e duronin, sikur të mos ish ai diell që kishin pasur në qytet. Fshiheshin hijeve. Unë i shikoja dhe qeshja me atë timen: «Po ju, mor shokë, do të rrini fetë orë në diell, si s'durokit diçka minuta sa të rrierni dyshekët me kashtë! Prisni sa t'u tregojmë vendin e fjetjes, sa të shkojmë në menci. Rregullohuni njëherë sipas skuadrave dhe brigadave. Rregulli në punë është gjë e madhe. Po hajde, mësoja

atyre të rinjve menjëherë. Më kujtohet mëngjezi i parë: se si rrinin ashtu të ngathët. Mezi u binde-shin shokëve të tyre për t'u futur në rradhë. Iu dukej, ndoshta çudi që në vend të librit apo violinës tashti kishin në dorë shatin. Puna e tyre ishte të prashisnin misrin. Ne jemi fermë e madhe. Tokat tona fillojnë nga vija hekurudhore e mbarojnë në bregdet...

Ai heshti për një çast dhe mori të rruhej, po edhe pse i zënë, vazhdoi të tregojë:

— Ju e patë. Simvjet kemi mbjellë gjithë atë misër. Misri në këtë kohë kërkon të prashitet dhe, të themi të vërtetën, zor do ta kishim pa ndihmën e brigadave të rinisë. Ditën e parë, shumë nga të rinjtë, shikonin si me habi rreshtat e pafund të misrit. Ata duhej t'i binin disa herë tej e tej arës së mbjellë, të kërrusur sipër shatit, me diellin mbi kokë. Po shumica e tyre nuk ishin mësuar me këtë lloj pune. Se si më vinte ashtu. E ç'rëndësi kishte kjo ndjenja ime e çastit, para detyrës së madhe që kisha për t'i organizuar dhe mësuar këta të rinj në një punë jo të zakonshme. Ju mund të habiteni, po t'ju them të drejtën, ditët e para ata s'e realizuan normën. I mblodha dhe u thashë si me të qeshur: «Ju sot duhet të hani gjysmën e ushqimit. Kaq kini punuar, kaq ju takon. I vura re mirë: Disa heshtën, disa u vrenjtën, disa vunë buzën në gaz, po asnjëri nuk guxoi të më kundërshtojë. Më erdhi mirë për këtë dhe u binda që punët do të shkonin mbarë... Po kjo mjekra ime ç'ka sonte që s'po bindet — qeshi agronomi, duke afruar pasqyrën.

— Të është tharë sapuni — i thashë, megjithë-

se mendjen e kisha tek tregimi i tij dhe nuk më vinte mirë që të këputej në mes. Unë kisha gjetur, pa dashur, njeriun që më duhej.

— Në brigadën e studentëve të Konservatorit është një student që mëson për violinë. Thonë se shquhet në mes shokëve të zanatit të tij. Po ta shikosh nga afër, duart i ka delikate e gishtat të hollë e të limuar, po është i shkathët. Të them të vërtetën kur mori shatin ditën e parë më erdhi keq. Gjynah që e kanë dërguar, thashë. Po nuk mendo-va mirë se shiko se ç'ndodhi: s'kaluan disa ditë dhe ai u bë shembull për të tjerët. Dje bile e shpallën sulmues. Ta shohësh kur punon: punon me qejf dhe me një këmbëngulje të çuditshme. E kap shatin me atë lehtësi e kujdes si të kapte violinën. Mirë kanë thënë të diturit: puna është baza e çdo gjëje. Talenti s'ka si ta përbuzë punën! Para dite ai merret me shatin, mbas dite me violinën. Ferma jonë s'ka dëgjuar ndonjëherë aq muzikë sa këto ditët e korrikut, më falni, një minutë.

Agronomi e la bisedën përgjysëm dhe u ngrit të lahej. Unë mora lapsin dhe diç shënova në blok. Nuk dija se ku t'i fusja në reportazhin tim gjithë këto gjëra interesante që po më thoshte miku i panjohur. Ai po ma kthente mendjen: e kisha menduar ndryshe reportazhin.

Agronomi mbaroi punën dhe erdhi u ul në krevatin e tij, përkrah meje.

— Ju lashë pa gjumë sonde — tha ai me një buzëqeshje të çiltër, duke më parë drejt në sy. Ne kemi një rini të mrekullueshme. Ajo mjafton të mësohet e të drejtohet, pa bën çudira. Ditët e para, unë, si njeri i mësuar gjithnjë me punë e që vlerat

e njerëzve i mat me punën që bëjnë, kisha një farë antipatie për disa të rinj dembela. Shumica punonin, realizonin normën, kurse ata qëndronin në bisht, rronin në kurriz të shokëve. Kjo më zemëronte, ndofta dhe gaboja, po s'i duroja dot. E shihje, djalin e botës, plot shëndet; koka në qiell, shpatullat sa të miat dhe të vinte plasje: Ç'ka ky njeri që s'punon si tërë shokët? Kur i flisje, ai s'të shikonte në sy. Duhej shkundur ai dhe ndonjë shok i tij. Po si? Ja, se ç'na ndodhi: Para disa ditëve, aksidentalisht mori flakë pylli, ja ai pylli atje përtej. Vullnetarët atë kohë po punonin nëpër ara. Roja e pyllit me të ndjerë zjarrin dha alarmin. Asnjë nga të rinjtë nuk e kuptoj në fillim se ç'kërkonte ky njeri që bërtiste. Unë e kuptova, po e mbajta veten, për të parë se ç'do të ndodhte me vullnetarët. Ishin punë sekondash këto, po një moment si ky e tregon njeriun. Vullnetarëve s'u shkonte mendja se kishte rënë zjarri në pyll, po kur panë flakën, u turrën të gjithë drejt pyllit, ashtu siç ishin, me një gatishmëri të rrallë. Unë mbeta vetëm për një çast: më preku jashtë mase ajo skenë që shihja. Nuk ma priste mendja të sulleshin ashtu të gjithë. Fusha mbeti e shkretë. Vura re se dhe ata që s'punonin si duhet, kishin shkuar pas shokëve. Nuk dëgjoje asnjë thirrje, asnjë ankim. Ishin të tërë të preokupuar e të tronditur, sikur shkonin në sulm për të mbrojtur diçka të tyre, diçka të shenjtë. E si të mos gëzohesha unë tashti, sado që gjithë ato ditë kisha ndenjtur serioz, i kisha qortuar, kisha pasur (e pse ta fsheh) edhe ndonjë paragjykim! Të gjitha këto i hodha poshtë, kur pashë vullnetarët që përlesheshin me flakën e

i suleshin zjarrit sikur të kishin armikun përpara. Mendoni, ujë s'kishte dhe atyre iu desh të luftojnë me shatë, me dhe, me drurë! Natyrisht, ata u përcëlluan, u skuqën, bile ndonjë dhe u dogj duarsh e këmbësh, po asnjëri s'u ankua e s'u zmbrops. Fytyrat e tyre ishin serioze, tek të gjithë dukej shqetësimi për fatin e pyllit, për pasurinë e popullit. Kjo ndeshje me zjarrin që si të thuash prova e zjarrit për vullnetarët e rinj. Gjesti i tyre i lartë bëri shumë përshtypje në punonjësit e fermës sonë. Po lufta me zjarrin kishte dhe një rëndësi tjetër të madhe. Ajo ngjalli besim në forcat e rinisë, e kaliti për t'i bërë ballë çdo sakrifice. Ata që mundën zjarrin, mund të plotësonin tashti, pa shumë vështirësi, dhe normën ditore. Dhe të më besoni, pas asaj që ndodhi, u ngrit shumë lartë morali i rinisë dhe s'u bë më problem i përgjithshëm çështja e normës. Tashti, sa më shumë kalon koha, aq më kollaj e kanë vullnetarët: i mësuan shprehitë e punës, e kalitën vullnetin, ata po bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për detyrën që u ka ngarkuar atdheu. Atdheu ka nevojë gjithnjë për forcën, talentin dhe gazin e rinisë sonë. Ne, njerëzit e bujqësisë s'kemi ç'të themi, veç fjalë të mira për brigadat e rinisë. Sigurisht, ata do të merren me punë të tjera, kur të ikin që këndeje, po puna që bënë këtu do t'u vlejë pa tjetër. Ata u kalitën me zjarrin dhe me tokën, u bënë më të fortë e më këmbëngulës. Veç kësaj, me punën e tyre ata kontribuan për bukën e popullit.

Agronomi heshti një hop, po kur pa që unë mora rishtaz blokun, më pyeti:

— Shënimet kini aty?

— Po — i thashë.

— Mund t'ju jap dhe unë disa emra që meritojnë të përmenden. Mbajini, ju lutem, shënim.

Unë, si t'isha nxënës i bindur, mora lapsin.

— Shënojeni, — tha agronomi duke u menduar — atë violinistin, se do të më ngelë merak. E quajnë Gjergj Pekmezi, është nga të Konservatorit. Mos harroni nxënësit e teknikumit ekonomik Kazylf Zekën që e realizon normën 200%. As komandanten e brigadës mos e harroni, Dorotea Jançen. Ajo punon shumë mirë. Do t'u vinte keq studentëve të shkollës së teatrit, po të mos i përmendje të rinjtë që punojnë më shumë, siç janë Elpiniqi Bode, Sulejman Dibra, Fitim Makashi...

— Po ju si e keni emrin? — e ndërpreva agronomin.

— S'keni ç'e doni emrin tim për aty, — qeshi ai. — Kësaj here shkruani vetëm për rininë tonë, për rininë në fushë. Ajo e meriton. Ky muaj është muaji i saj. Për ta interesohet gjithë populli.

Kur biseda jonë po i afrohej fundit, mesnata kishte kaluar. Ne kishim filluar të koteshim. S'kishim ç'ë bënë më dhe u shtrimë në shtrat. Agronomi po mbyllte dritën dhe mua sepse m'u kujtua veterineri.

— Po doktori, ç'u bë? — pyeta.

— Aha, do të ketë havaze sonde ai. Si duket lopa s'do ta ketë pasur lindjen të mbarë. Kështu e ka kjo puna e jonë. Flini, ju lutem, se do të zgjoheni shpjet. Çanga bie n'ora katër.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

LIGJI I SHENJTË I PARTISË

Gjyqi që u zhvillua para ca kohësh në katundin Shënavlash të kujtonte gjyqet e popullit që bëheshin në vitin e parë të çlirimit. Qindra kooperativistë, burra e gra, pleq e plaka, të rinj e fëmijë ishin mbledhur në sheshin e fshatit. Trupi gjykues e prokurori humbisnin mes turmës së madhe. Njerëzit rrinin ndërmjet gjyqtarëve, përkrah prokurorit dhe në vështrimin e parë ishte vësh-tirë t'i shquaje nga përfaqësuesit e ligjit. Ata dë-gjonin me vëmendje të madhe, por dhe ndërhyenin dhe thërrisnin lirisht. Populli gjykonte vetë.

Në bankën e akuzës ishin vënë Avdi Berisha dhe Hajredin Sulati, «dhëndrri» dhe «vjehri», dy fytyra tipike të skllavërisë së gruas. Përballë tyre qëndronte një grup i madh grash. Ishin vajza, nuse e plaka, që kishin ardhur aty nga fushat e stallat, nga shkollat e shtëpiat. Vështrimi i tyre ishte mbërthyer mbi të pandehurit. Shumë nga ato shikonin përpara, pa frikë dhe me neveri, po kishite prej tyre që hidhnin dhe vështrime të ndrujtura, e të hutuara. Ndonjëres, ndofta, do t'i

dukej një gjë e çuditshme ajo që po ndodhte përpara syve të saj. Po mua s'më harrohet ajo gruaja që mbante në dorë një shkop të trashë, me të cilin godiste tokën, sa herë që e zemëronin fjalët e të pandehurve. Dëgjoja goditjet e atij shkopi dhe sepse më ngjante se dëgjoja një refren revolte ndaj asaj ngjarje tronditëse që shtjellohej para nesh.

Ç'kishte ndodhur?

Gjashtë vjet më parë Avdi Berisha, nga fshati Gurrës i Krujës, kishte ndarë gruan me tre fëmijë, duke e shtrënguar të shoqen të bënte vetë padi. Gjyqi i Krujës dhe pastaj ai i qarkut të Tiranës, pa u thelluar dhe në mënyrë burokratike, pa diktuar dëshmitarët e rremë të Avdiut matrapaz, kishte dhënë një vendim të padrejtë: e kishte zgjidhur martesën në favor të burrit, gjoja për shkak të grindjeve të vazhdueshme dhe, me gjithë dëshirën këmbëngulëse të nënës për të marrë ligjërisht djalin e madh e për ta patur si përkahës, gjyqi ja kishte dhënë të atit. Pas kësaj, Avdiu i kishte pasur duart të lira: ai mund të kërkonte nuse të re! Për këtë, babai i tre fëmijëve kishte bredhur nëpër miq e shokë dhe e kishte bërë të njohur dëshirën e tij. Dëshirën e Avdiut e kishte marrë vesh dhe Abdulla Berisha, në Tiranë, dhe kishte vendosur të hynte shkues. Kjo ishte një punë me leverdi për Abdullain. Ai, jo vetëm do të forconte miqësinë me familjen e Avdiut, po në këtë rast do të kishte dhe përfitime. Veç gostive, ai do të merrte dhe shpërblime të majme. Pa e çuar gjatë, Abdullai u ngrit nga Tirana dhe shkoi drejt e në Shënavlash, tek Hajredin Sulati. Ai e dinte se Hajredini kishte tri vajza. E dinte se edhe më e

madhja ishte 12 vjeç. Por kjo nuk e pengonte atë që ta lidhte krushqinë. Vërtetë, Avdiu ishte 37 vjeç, po dhe kjo gjë rregullohej. Avdiu mund të priste deri sa të rritej vajza dhe të arrinte moshën ligjore. Pastaj gruan e ndarë e kishte në shtëpi. Mund të englandisej me të, deri sa të «piqej» nusja e vogël. Hajredini, në fillim, bëri sikur kundërshtoi por më pas u shtrua në muhabet dhe zuri të bëjë pazar. Tashti hesapi duhej llogaritur mirë. Ai kishte vajzë të shëndetshme dhe të fuqishme për punë dhe kishte arësye të kërkonte një pazar të lartë. Kështu filluan hesapet prej matrapazi. Njëri ngre, tjetri ul, deri sa më në fund u arrit marrëveshja që Hajredini do t'ja shiste vajzën Avdi Berishës për 80 mijë lekë.

Pas fjalës së dhënë, «vjeherri» dhe «dhëndrrin» u miqësuan shpejt. Hajredini nuk u druajt t'i shprehë Avdiut një dëshirë të vjetër: Po të kishte mundësi t'i gjente edhe atij një nuse nga Gurrëza, pasi gruaja që kishte, nuk i bënte djalë! Avdiu pranoi me qejf. Kështu ata u ndanë për t'u takuar prapë nëpër gostira që erdhën më pas. Nëpër këto gosti u ngritën dolli e u shkrehën pushkë në Shënavlash e në Gurrëz. Gjithë bota mori vesh se ç'po bëhej. E dëgjuan komunistët e fshatit, këshilltarët, organizatat e masave, arësimtarët. Një pjesë shprehën habinë, të tjerë u revoltuan, po asnjë nuk u ngrit ta ndalojë këtë tregëti që bëhej në kurriz të vajzës së mitur.

Atë ditë kur krushqit vajtën në shtëpi, Mejremja e fejuar nuk shkoi në shkollë. Nuk shkoi as të nesërmen. Mësueses, kur e mori vesh, i erdhi keq,

po u mjaftua vetëm me kaq. Kurse atë ditë, kur krushqit vajtën në shtëpinë e dhëndrrit, Nurijen, gruan e tij të parë, Avdiu e hoqi nga shtëpia dhe e çoi në stan, sipër në mal.

Kështu kalonte koha. Mejremja vazhdonte shkollën në Shënnavlash. Shkollën vazhdonte dhe bashkëmoshatare i saj, Mani, djali i Avdiut në Gurrëz. Avdiu gëzohej që nusja po rritej. Ai nuk mërziqej së prituri, fundi një grua e kishte në shtëpi. Ajo i shërbente ashtu si më parë. Bile, gjatë kësaj kohe, Nurija lindi edhe dy fëmijë të tjerë me Avdiun. Kjo e gëzoi babanë, po prapë babai e kishte mendjen tek nusja tjetër. Herë pas here, ai shkonte fshehurazi dhe e shihte. Ajo rritej dhe zbukurohej çdo ditë. Lakmia e pangopur e bënte Avdiun ta kërkonte nusen sa më parë në shtëpi. Po Hajredini donte të përfitonte sa më shumë nga «dhëndrri». Ai merrte herë pas here prej tij të holla, plaçka, pinin dhe bënin qejf së bashku.

Dalëngadalë kaluan gjashtë vjet dhe po vinte koha e martesës. Mejremja i qante hallin nënës, po e ëma ishte e pafuqishme ta ndihmonte. Hajredini sillej si tiran në shtëpi. Kush guxonte të ngrihej kundër tij! Ai i kishte dhënë fjalën «dhëndrri» që në tetor nusen e kishte gati. Në shtëpinë e Avdiut kishin filluar përgatitjet. Po bënin pajën e nuses. Nurija qepte, qëndiste, rregullonte veshjen e mbathjen e shemrës së ardhëshme. Ajo palosi kush e di sa rroba të nuses me duartë e saj. Tek bënte këtë gjë, Nurija qante fshehurazi. Qante fatin e saj, po dhe fatin e asaj që do të vinte. Ato kishin një fat, ishin viktimat të një zakoni feudal, të huaj për jetën e popullit. Avdiu sillej nëpër shtëpi,

duke mbajtur qeleshen mbi sy e duke fërkuar mustaqet e ndera. Po ndonjëherë bëhej edhe nervoz, nuk donte t'i shikonte fëmijët, sidomos kur rrinin të pesë tok. Nuk i pëlqente ai vështrim i dyshimtë i djalit të madh. Po më shumë e zemëronte Nurija, me heshtjen e saj. I vinte ta dëbonte një orë e më parë. Po ç't'u bënte pesë fëmijëve? Kush do t'i kryente punët e shtëpisë? Nurija punonte sa për dy burra bashkë. Megjithatë, kur po afrohej koha e martesës, Avdiu e urdhëroi Nurijen të ngjitej përfundimisht në mal e të jetonte atje në stan, në një kasolle të keqe, në mes të bagëtive. Dhe ajo kokulur u ngjit në mal. Duke ndenjtur atje vetëm, ajo kishte humbur çdo shpresë se mund të dënohej ndonjë herë i shoqi zëmër-pleh. Po një ditë, pa prituri, i erdhi i biri, Mani, dhe me një frymë i dha lajmin e gëzuar:

— Babën e futën në burg. Nuk e lënë të marrë nuse të re!

Në burg po atë ditë futën edhe Hajredinin, babën matrapaz të nuses.

Tashti populli po i gjykonte. I gjykonte i gjithë fshati. Vajza gjykonte të atin. Gruaja e fyer gjykonte të shoqin. Të gjithë flisnin me urrejtje të papërmbajtur për krimin e tyre. Populli dënonte rreptë për skllavërimin e gruas. Thirrja e partisë i kishte ngritur njerëzit në këmbë! Kjo është lufta finale që bëhet tek ne, kundër mbeturinave të botës së vjetër, lufta për pastrimin e ndërgjegjes së njerëzve tanë, për triumfin e moralit komunist, për lartësimin e personalitetit të gruas.

VJESHTA E GJELBËR E MALEVË

Akoma ndjej kënaqësi, tek sjell para syve gjithë atë rrugë që bëra nëpër luginat dhe malet e Matit e të Martaneshit. Rruga kalonte përmes grykash e gërxhesh të egra, merrte përpjetë majave, buzë honeve të pafund, zbriste poshtë, nëpër rrëpira të thata e lugina të gjelbra, pastaj sërish ngjitej lart, duke kaluar në mes pyjesh shekullore, ku gurgullonin buronja të panumërta, shkelte nëpër lëndina e korijsë, që vjeshta akoma s'i kishte prekur. Gjithë rruga ishte një ngjitje e zbritje e pandërprerë, me një bukuri të pashoqe, me pamje e ngjyra plot variacione. Po nuk është vetëm natyra piktoreske që i bën të dashura e tërheqëse këto vise të atdheut tonë. Pas çdo këthese, udhëtimi ndeshet me qyteza të lashta, me rrënoja kalash historike, me buste e lapidare të rinj. Këtu sheh qytezën ilire të Xibrit, më poshtë zbardhon lapidari i Zonja Çurres, në Gura-Bardhë buzë rruge qëndron mbi pjestal Pjetër Budi. Diku aty për-qark është Petralba, kështjella e Skënderbeut. Më thellë, të zë syri që larg një obelisk të ngritur, në kujtim të krijimit të Brigadës II-të.

Çdo pëllëmbë toke këndeje është një histori e gjallë dhe njeriu s'di ku ta përqëndrojë vëmendjen më parë. Po megjithatë, tek shikon gjurmat e historisë të gërshetuara aq bukur, të shoqëron kudo po një mendim: malësia gjithnjë ka qenë trevë e lirisë, malet tona përherë janë shndërruar në kështjella lufte. Nëpër këto male të thata, përmes këtyre pyjeve shekullore, përpjetë majave e tatëpjetë luginave, duke u ngjitur rrezomave, nëpër gërxhe e gryka kaluan luftëtarët e lirisë. Këndeje luftuan ushtarët e Ilirisë së moçme, nëpër këto vende u ndeshën trimat e Skënderbeut; këtyre anëve është ndjerë e fuqishme pushka partizane. Këto mendime të ndjekin pas kudo, këndeje tek udhëton.

Maqina, pasi ngjiti me vështirësi një të përpjetë të madhe, lhyri në pyll. Gazi ynë tani kalonte nëpër një ahishte shekullore, ku mezi përshkonin rrezet e diellit. Rrotat e maqinës shkelnin fletët dhe vijat e pastra të burimeve. Pylli oshëtinte nga buria. Kur gazi po dilte që andej, papritur shoferi frenoi. Buzë rrugës kishin ngritur dorën dy vajza të reja. Ato përshëndetën me përzemërsi dhe hypën pastaj në maqinë. Pamja e tyre, veshja, ajo sjellje gazmore dhe e çiltër, të bënte të mendoje se ato ishin mësuese.

— Mësuese jeni? — i pyeta.

— Jo, — u përgjegjën ato njëherazi.

Unë hapa sytë. Nuk po kuptoja se ç'mund të ishin ato dy të reja, që kishin dalë ashtu papritur nga pylli dhe endeshin atyre anëve të pandruajtura. Njëra nga ato, ajo që i qeshte fytyra orë e ças, zuri të shpjegonte:

— Ne jemi luftëtare të së resë. Kemi ardhur

nga Tirana për të ndihmuar shoqet tona të malësisë.

Gjithë sa ishim në makinë, kthyem sytë nga vajzat:

— Në çfarë fshati keni shkuar? — pyeti dikush.

— Në Zallmner — foli vajza tjetër, që mbante vazhdimisht sytë ulur. — Kemi gati një muaj atje. Tani duam të shkojmë në shtëpi për dy ditë. e pastaj do të kthehemi prapë në fshat.

— Ju ka marrë malli si duket? — ngacmova unë.

— Na ka marrë, posi — ja priti e para — pse të gënjejmë? Po më shumë na ka marrë për shoqet e punës.

— Ku punonit ju? — ja bëri shoferi, që e ndiqte me vëmendje bisedën që bëhej prapa tij.

Vajzat qeshën dhe shikonin njëra tjetrën në sy.

— Thuaja ti, Bardha — tha vajza, që mbante qepallat lëshuar.

— Jo, jo — tregoja ti, Dushi — ja priti ajo që quhej Bardha, duke ngritur me dorë një tufë flokësh që i binte vazhdimisht në ballë. Ne të tjerët, pa dashur u bëmë kureshtarë dhe rrinim e prisnim. Pas pak, Dushi me një pamje serioze, tha:

— Ne jemi orëndreqëse. Kemi qenë nga të parat vajza që i hymë këtij zanati.

Bardha qeshi mbyturazi, ndërsa sytë i mbante jashtë dritares.

— Pse qesh, ti Bardha? — ja pat Dushi.

— Kot — iu përgjegj ajo dhe menjëherë mori një pamje të menduar.

— E di si është puna — zuri të shpjegojë

ajo. — Në fillim, kur hymë në këtë punë, pasi kishim mbaruar shkollën e mesme, na vinte turp. Njerëzit ishin mësuar t'i shihnin orëndreqësit burra, bile pleq me syza. Ditët e para, kur shkuam, rrinim si zogj të trembur dhe u ruheshim njerëzve që kalonin përpara vitrinës së dyqanit.

— Kjo ndodhi vetëm në fillim — e mori fjalën Dushi — se pastaj s'patëm gjale. Tashti jemi një brigadë e tërë me vajza orëndreqëse.

— Kjo është punë tamam për vajza — tha një nga shokët tanë.

— Po, po, kjo është shumë e vërtetë — u hodh e tha Bardha e qetë.

Pas kësaj, të gjithë heshtën. Maqina zbriste një të tatëpjetë të keqe. Ne shikonim nga dritarja me një ndjenjë shqetësimi. Se kush tha:

— Rrugë të këqija këto.

— Këto s'janë gjë hiç — u hodh prapë Bardha. Ajo bisedonte aq lirshëm e ngrohtë, sikur të udhëtonte me njerëz të njohur. — Pa hajdeni njëherë nga fshati ynë. Edhe dhija s'e ka kollaj të ngjitet gjer atje.

— Po ju, a e keni vështirë? — e pyeta, duke ndjekur me vëmendje mendimin e saj të pa shprehur.

— Sigurisht, — shpjegoi vajza — megjithatë, rruga është vështirësia më e vogël. Po ç'tu bësh të tjerave. Nuk e merrni dot me mend se sa e tmerrshme ka qenë e kaluara këndeje. Akoma duken gjurmat e injorancës, fanatizmit, varfërisë. Po njerëzit kanë filluar të lëvizin që nga fjalimi i shokut Enver. Po dënohen zakonet e vjetra, po luftohen bestytnitë e feja. Të rinjtë e të rejat janë ngritur në këmbë.

— Nuk e kini idenë — vazhdoi shoqja e saj — se sa e dëshiruar është rinia këndeje për të renë. Përpara, në fshat, drejtonin vetëm burrat, kurse gruaja ishte lënë fare mënjanë. Tashti kanë ndryshuar punët. Fanatikët janë detyruar të zmbropsen.

Ato flisnin me pasion e me një ndjenjë krenarie për punën e tyre. Donin të na shpjegonin gjithshka, sikur të kërkonin miratimin tonë për ato që kishin bërë.

— Në fillim burrat e fshatit, kur vajtëm ne, kush e di se ç'kujtonin! — zuri të tregojë Bardha me buzë në gaz — Po kur panë që gratë e të rejat zunë të mësojnë gjëra të mira prej nesh, ju hapen sytë, opinioni ndryshoi pak, por prapë lufta vazhdon.

Rruga ishte e gjatë dhe ne u miqësua me vajzat; na dukej se kishim takuar shoqet tona të njohura. Kur ato zbritën dhe u ndanë prej nesh, ne na erdhi keq. Ato ishin vajza të zgjuara e të gjalla, plot optimizëm e energji, tamam luftëtare të së resë. Bardha dhe Dushi të kujtonin me të vërtetë partizanet, që shkonin kasolle më kasolle, maleve e luginave për të çuar në çdo skaj fjalën e partisë.

TRYEZA E LËNDËS

TREGIME

Shoku	5
Pejsazhi	15
Kush është?	23
Bredhi i bardhë	40
Hapat e tij	55
Në mes të të gjallëve	71

SKICA

Ndërlidhësi	85
Në pozicion	90
Në mes flakëve	71
Krisma	97
Mbi kreshtat e dallgëve	101
Djali i komandantit	104
Portreti i një detari	107

PËRSHKRIME

Në det, nëpër furtunë	115
«Betejë» në det	124

Monologu i një luftëtari	130
Flamur në stuhi	139
Në dritën e prozhektorëve të bardhë	146
Thirrja e ndërgjegjes	155
Rinia në fushë	164
Ligji i shenjtë i partisë	172
Vjeshta e gjelbër e maleve	177